Save the Children

Republika e Shqipërisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

# Manual
# Inspektimi i plotë i shkollës

*Për inspektorët, drejtuesit e shkollave dhe mësuesit në arsimin parauniversitar*

Tiranë, 2005

Save the Children

Republika e Shqipërisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

# MANUAL

# INSPEKTIMI I PLOTË I SHKOLLËS

## Për inspektorët, drejtuesit e shkollave dhe mësuesit në arsimin parauniversitar

Tiranë 2005

**Manual- Inspektimi i plotë i shkollës.**

Bashkëpunim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe
organizatës "Save the Children", Programi për Shqipërinë.

Përgatitur në kuadrin e projektit
"Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin bazë 9-vjeçar"


**Autorë**

Vladimir PASKU, Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Mira PESHKATARI, Drejtoria Arsimore e qytetit Tiranë
Shemsi MUÇA, Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Udhëhoqi grupin: Refik ÇELA, Save the Children, Programi për Shqipërinë.

Redaktoi materialin: Tatjana CENKO


Ky libër nuk mund të shitet ose të përdoret për qëllime përfitimi.

Tiranë, 2005

# Përmbajtja

**Dy fjalë për projektin** ... 5

**Pjesa 1: Inspektimi i plotë i shkollës** ... 9

1. Vlerësimi i cilësisë së shërbimit që ofron shkolla ... 11
   - 1.1 Tabloja e Vlerësimit ... 12
   - 1.2 Legjislacioni ... 13
   - 1.3 Konteksti ... 14
   - 1.4 Menaxhimi dhe organizimi ... 14
   - 1.5 Procesi i mësimdhënies dhe i të nxënit ... 14
   - 1.6 Kujdesi për nxënësit ... 15
   - 1.7 Rezultatet e nxënësve ... 15
   - 1.8 Gjendja bazë e shkollës ... 15
2. Tablo e përmirësuar e vlerësimit ... 17
   - 2.1 Menaxhimi dhe organizimi i shkollës ... 17
   - 2.2 Procesi i mësimdhënies dhe të të nxënit ... 27
   - 2.3 Kujdesi për nxënësit ... 35
   - 2.4 Rezultatet e nxënësve ... 38
3. Dy fjalë për shtojcat ... 41
   - Tabloja e përmirësuar e vlerësimit ... 42
   - Formati 1: Të dhëna për shkollën ... 47
   - Formati 2: Të dhëna të mëtejshme për shkollën ... 50
   - Formati 3: Pyetsor për nxënësit ... 53
   - Foramti 4: Vëzhgimi i mësimit ... 54

**Pjesa 2: Si të formulojmë pyetje për vlerësimin e shkollës** ... 55

**Pjesa 3: Inspektimi i plotë i Ciklit Fillor** ... 107

**Pjesa 4: Plani vjetor i punës së shkollës** ... 145

# Dy fjalë për projektin

Ka më shumë se një vit që inspektimi i sistemit arsimor parauniversitar (publik dhe jopublik) kryhet sipas disa standardeve që formojnë Tablojnë e Vlerësimit të cilësisë së shkollës. Duke u përpjekur për të qenë sa më afër inspektoriateve moderne europiane, inspektoriati shqiptar synon të vlerësojë cilësinë e shkollës nëpërmjet një sistemi të organizuar treguesish duke përdorur një shkalle vlerësimi me katër nivele sipas disa normativave plotësisht të përcaktuara. Në këtë mënyrë, janë krijuar kushtet që, nëpërmjet vëzhgimit të dokumentacionit dhe veprimtarisë së shkollës, të ndërtohet një profil i plotë i cilësisë së shërbimit që ofrohet prej saj. Nga ana tjetër, sistemi i ofruar i inspektimit realizon idenë se, duke vlerësuar një grup të caktuar shkollash, mund të jepen vlerësime për cilësinë e sistemit në tërësi. Këtij procesi i ka shërbyer Manuali i Inspektimit i botuar në verën e vitit 2004.

Inspektimet e shkollave të ndryshme gjatë viteve 2004 dhe 2005 treguan vlerat e këtij sistemi të ri treguesish. Veçanërisht e vlefshme ka qenë mbështetja që organizata Save the Children po i bën ketij procesi nëpërmjet programit të edukimit.

Nëpërmjet vlerësimeve të herëpashershme që i janë bërë programit të edukimit bazë të organizatës Save the Children ka dalë në pah vlera e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si dhe vlera e pjesëmarrjes së fëmijëve në përmirësimin e cilësisë së shkollimit që ofrohet për ta. Bazuar në rezultatet e vlerësimeve si dhe duke u mbështetur në objektivat e MASH pasqyruar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2004-2015, Save the Children mori parasysh nevojën për bashkëpunim më të ngushtë me institucionet shtetërore me qëllim forcimin e sistemit shtetëror të trajnimeve dhe shtrirjen e punës së tij në nivel kombëtar, duke e përpunuar idenë në një projekt të ri, i cili u emërtua si **"Projekti i përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies në arsimin bazë 9-vjeçar"**

**Projekti ka si synim:**

- Të rrisë kapacitetin e inspektorëve,specialistëve të Drejtorive Arsimore Rajonale dhe grupit të trajnerëve rajonale për të planifikuar dhe kryer trajnime me drejtorët dhe mësuesit, si dhe të monitorojë dhe të përkrahë mësuesit gjatë procesit mësimor;
- Të përmirësojë mësimnxënien e nxënësve nëpërmjet trajnimit cilësor të drejtorëve dhe mësuesve të shkollave;
- Të rrisë pjesëmarrjen e fëmijëve duke formuar dhe vënë në përdorim rrjetin e Qeverive të nxënësve.

Duke e shtrirë në të 13 rajonet e vendit, Save the Children po bashkëpunon ngushtësisht me institucionet arsimore në qendër dhe në rreth, me MASh, Institutin e Zhvillimit të Kurrikulës, Qendrën e Trajnimit dhe Kualifikimi për Arsimin, DRA dhe ZA. Struktura të caktuara të këtyre institucioneve do të jenë të përfshira në ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe në vëzhgimin e ndryshimit që do të sjellë puna jonë në cilësinë e shkollimit për fëmijët.

**Projekti bazohet në tri shtylla bazë:**

- **Trajnimi kaskadë** duke filluar nga inspektorët e Sektorit të Inspektimit, specialistët e sektorit të Trajnim-Kualifikimit në DAR dhe ZA e deri te mësuesit në shkolla.
  Trajnimi do të mbështetet vit pas viti te prioritetet që do të shpallin dy institucionet e krijuara nga ndarja e ISP, bazuar mbi vlerësimin vjetor të nevojave për trajnim. Mbi këto përparësi do të hartohen module trajnimi për tema të veçanta të lidhura ngushtësisht me mësimdhënien dhe mësimnxënien, të cilat do të përdoren për të shpërndarë trajnime në formën e kaskadës.
- **Monitorimi** i zbatimit të trajnimit gjatë mësimdhënies prej inspektorëve të DAR, për të vënë re nivelin e përmirësimit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.
  Përfituesit përfundimtarë të projektit synohet të jenë nxënësit. Masën e përmirësimit të mësimdhënies e mësimnxënies, si pasojë e trajnimeve të dhëna mësuesve të tyre, do ta përcaktojë në vazhdimësi monitorimi i punës në klasë. Në procesin e monitorimit Save the Children do të bashkëpunojë ngushtësisht me MASH-in dhe institucionet e krijuara nga ndarja e ISP, por kryesisht me sektorin e inspektimit në çdo DAR. Këtij qëllimi i shërben edhe hartimi i këtij manuali.
- **Forcimi i nivelit të pjesëmarrjes** së fëmijëve në marrjen e vendimeve që përmirësojnë jetën e tyre brenda në shkollë, duke mbështetur qeveritë e nxënësve në 55 shkolla.

Gjatë zbatimit të projektit u krijuan kushtet që niveli qendror dhe sektorët e inspektimit pranë DAR të njiheshin me sistemin e ri të treguesve të vlerësimit të cilësisë së shkollës dhe të fillonin ta përdorin atë gjatë procesit të inspektimit. Pas kësaj, kjo përvojë u përcoll në një grup shkollash për secilin qark duke i ftuar të fillonin procesin e vetvlerësimit me po këtë sistem treguesish. U kryen një sërë trajnimesh me drejtues shkollash, u inspektua një numër i konsiderueshëm shkollash dhe disa prej tyre filluan të ndërtojnë planet e punës sipas kërkesave të këtyre treguesve. Ky çast përbën një hap të madh në historinë e arsimit shqiptar. Për herë të parë ndeshim në praktikë shkolla të cilat vetvlerësohen me po ata tregues me të cilët ato vlerësohen nga inspektimi i jashtëm.

Natyrisht që problemet janë të shumta. Ato kanë të bëjnë me cilësinë e inspektorëve të rekrutuar, me reminishencat e së shkuarës, me vështirësitë e të punuarit me standarde etj. Por, procesi është në përmirësim të vazhdueshëm. Pjesë e këtij përmirësimi është edhe nevoja për një përshtatje më të mirë të sistemit të treguesve të vlerësimit të cilësisë së shkollës me kontekstin shqiptar. Kjo kërkesë është e përgjithshme, si nga sektorët e inspektimit ashtu dhe nga shkollat. Ky manual i përmirësuar i inspektimit të plotë të sistemit arsimor parauniversitar (publik dhe jopublik) është frut i sugjerimeve dhe kërkesave që kanë buruar nga praktika e përditshme e vlerësimit të cilësisë së shkollës.

Reflektimi i menjëhershëm ndaj kërkesave të mësipërme ka qenë vendosja në këtë botim e fletëve të punës. Ato janë hartuar në mënyrë të tillë që t'i shërbejnë inspektorit gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm të shkollës. Por, ato i shërbejnë edhe drejtorit të shkollës si dhe mësuesve gjatë procesit të vetvlerësimit. Ndërkaq, ajo që ka më shumë rëndësi është fakti se të dy formatet kanë të njëjtën gjuhë vlerësuese. Në këtë mënyrë janë krijuar kushtet që të dy aktorët: vlerësimi i jashtëm dhe vetvlerësimi të diskutojnë të njëjtat probleme të cilësisë së shërbimit që ofron shkolla gjatë procesit të vlerësimit të saj.

Një zhvillim i mëtejshëm në sektorin e inspektimit është edhe përpjekja për të vlerësuar

Ciklin Fillor me një grup specifik treguesish. Ky grup është duke u pilotuar nga Drejtoria e Inspektimit me synimin per një përmirësim të mëtejshëm të tij.

Përvoja e deritanishme flet për efiçiencën e sistesmit të ri të inspektimit. Ai mundëson vlerësimin e të gjitha aspekteve të cilësisë së shkollës sipas standardeve të njëjta për secilin inspektor. Duke qënë publik, kërkesat e tij njihen nga shkolla dhe të interesuarit e tjerë. Pra, shkolla di se çfarë do të vlerësohet, përgatitet për ta pritur këtë vlerësim dhe i nënshtrohet procesit të inspektimit duke dialoguar me të njëjtën gjuhë vlerësuese me atë të inspektoriatit.

Ky manual i shërben këtij procesi. Ai është përmirësuar dhe lehtësuar duke u mbështetur në sugjerimet e kryeinspektorëve, inspektorëve dhe drejtuesve e mësuesve të shkollave, të cilët i falënderojmë për këtë kontribut të jashtëzakonshëm.

Mirënjohje të veçanta i drejtojmë organizatës "Save the Children" për realizimin dhe mbështretjen e gjithë procesit të institucionalizimit të sistemit të ri të inspektimit duke bërë të mundur përdorimin masiv të standarteve të inspektimit në vlerësimin e shkollave në nivel kombëtar.

**Autorët**

# PJESA 1

# INSPEKTIMI I PLOTË I SHKOLLËS

# 1. VLERËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMIT QË OFRON SHKOLLA

Cilësia e shkollave përfaqëson një koncept të gjerë. Cilësia është më shumë se rezultatet e nxënësve në vitet e shkollës, më shumë se arritjet e tyre në provime. Lidhjet midis mësimdhënies dhe të nxënit, sjelljes së nxënësve dhe njohurive të fituara, qëndrimeve apo shprehive dhe kushteve në klasë janë shumë komplekse. Prandaj, nëse duam të vlerësojmë cilësinë e një shkolle, duhet të shikojmë jo vetëm rezultatet e nxënësve të saj, por edhe çështje të tilla si: mësimdhënia, menaxhimi i klasës, veprimet me nxënësit që kanë vështirësi në të mësuar, menaxhimi dhe drejtimi i shkollës, pesëmarrja aktive e nxënësve etj. Një gjë e tillë realizohet me anë të Tablosë së Vlerësimit gjatë inspektimit të plotë të shkollës.

Në pikën 5 "Procesi i inspektimit" të Rregullores së MASh-it Nr. 224, datë 16.01.2004 theksohet se inspektoriati arsimor organizon këto inspektime:

- **Inspektim i plotë:** përfshin 15% - 20% të të gjitha shkollave të inspektuara në vit; shërben për të përftuar një tablo të përgjithshme të cilësisë së shkollave në sistem dhe për të raportuar te Ministri për cilësinë e sistemit; jep material për ushtrimin e funksionit të përhapjes së përvojave të suksesshme si dhe për verifikimin e vazhdueshëm të vlefshmërisë së strukturës që përdoret në inspektim.
- **Inspektim i orientuar:** kryen vlerësim të aspekteve të veçanta të veprimtarisë së shkollës;
- **Inspektim tematik:** organizohet nga Drejtoria e Inspektimit me kërkesa nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Tabloja e vlerësimit është pikënisja e çdo procesi inspektues të shkollave. Hapi themelor i zbatimit të saj është inspektimi i plotë i shkollës. Gjatë këtij inspektimi, grupi inspektues harton një tabllo të cilësisë së shkollës nëpërmjet vlerësimit të të gjitha fushave të veprimtarisë së saj sipas Tablosë së Vlerësimit, paraqitur në shtojcën A të këtij Manuali.

Mesatarisht, inspektimi i plotë i shkollës zgjat 5 ditë. Natyrisht, kjo kohë si dhe përbërja e grupit inspektues varen nga madhësia dhe kompleksiteti i shkollës.

Sipas Rregullores së Inspektimit, procesi inspektues kalon nëpër disa faza.

Gjatë fazës së parë, *përgatitjes për inspektim*, grupi inspektues kërkon të dhëna nga shkolla me anë të pyetsorëve të përgatitur për drejtorinë e shkollës si dhe për lëndët mësimore dhe analizon informacionin e ardhur nga shkolla. Grupi inspektues përgatit një informacion rreth planit të punës së shkollës dhe të dokumentave të tjerë, në varësi të gjendjes së saj. Gjatë kësaj faze përcaktohen edhe drejtimet ku do të fokusohet inspektimi.

Gjatë fazës së dytë, *vizitës* në shkollë, kryhen këto aktivitete:

- Bisedë me drejtorinë e shkollës, të cilës i krijohen kushtet të paraqes një tabllo të gjendjes në shkollë;
- Bisedë me mësuesët;
- Bisedë me nxënësit, stafin ndihmës dhe prindërit;
- Vizita në orët e mësimit sipas klasave dhe mësuesve;

- Grumbullimi dhe studimi i të dhënave të tjera, të cilat nuk janë mbledhur gjatë fazës përgatitore të inspektimit;
- Raport gojor në drejtorinë e shkollës dhe të ftuar të tjerë rreth rezultateve të përgjithshme të inspektimit.

## 1.1 Tabloja e Vlerësimit

Bazën e Tablosë së Vlerësimit (Shtojca A) e përbëjnë katër fushat e cilësisë së shkollës. Fushat e cilësisë janë:

(1) Menaxhimi dhe organizimi i shkollës;
(2) Procesi i mësimdhënies dhe të nxënit;
(3) Kujdesi për nxënësit;
(4) Rezultatet e nxënësve.

Secila fushë përshkruhet me anë të disa karakteristikave të cilësisë, të cilat në total janë 13. Kështu, fusha e menaxhimit dhe administrimit përshkruhet me anë të 5 karakteristikave të cilësisë. Secila karakteristika vlerësohet me anë të numrit përkatës të treguesve sipas normave të përcaktuara.

*Fushat dhe karakteristikat e cilësisë, treguesit për secilën karakteristikë, shkalla e vlerësimit dhe normat përkatëse të vlerësimit përbëjnë sistemin që përdoret nga inspektimi gjatë vlerësimit të cilësisë në kushtet reale të shkollës.*

Gjatë vlerësimit të shkollës, inspektimi përdor një shkallë vlerësuese me katër nivele. Nivelet janë:

| Niveli | | Cilësia e vlerësimit |
|---|---|---|
| *4* | *Shumë mirë* | Kryesisht suksese |
| *3* | *Mirë* | Suksese më shumë se dobësi |
| *2* | *Mjaftueshëm* | Disa dobësi të rëndësishme |
| *1* | *Dobët* | Kryesisht dobësi |

Më poshtë janë paraqitur përshkrime të përgjithshme të këtyre vlerësimeve, të cilat mund të përdoren gjatë inspektimit apo interpretimit të dukurive të ndryshme në shkollë.

### Shumë mirë

Vlerësimi ***shumë mirë*** jepet kur, në përgjithësi, karakteristikat e cilësisë janë identifikuar si të suksesshme. Ka shumë pak dobësi dhe, kur ato ekzistojnë, nuk kanë ndikim të dukshëm në efektivitetin e karakteristikës që vlerësohet. Por, vlerësimi ***shumë mirë*** nuk përfaqëson një nivel të jashtëzakonshëm pune. Ai duhet të karakterizojë atë nivel pune, i cili përfaqëson një realitet që mund të arrihet në të gjitha shkollat.

### Mirë

Vlerësimi ***mirë*** jepet kur puna e shkollës karakterizohet nga shumë suksese. Ka dobësi por ato, veç e veç apo të marra së bashku, nuk shkaktojnë probleme të mëdha në efektivitetin e

karakteristikës që vlerësohet. Në përgjithësi, duke analizuar të gjitha sukseset dhe dobësitë si dhe peshën e secilës prej tyre në punën e shkollës, arrihet në konkluzionin se sukseset mbizotërojnë ndaj dobësive.

**Mjaftueshëm**

Vlerësimi **Mjaftueshëm** jepet kur puna ka disa suksese por, dobësitë, për pasojat që kanë sjellë, mbizotërojnë ndaj sukseseve. Një gjë e tillë mund të vijë nga fakti që rezultatet, megjithëse janë të pranueshme në disa drejtime, janë të pamjaftueshme në një numër të konsiderueshëm drejtimesh të tjera. Po kështu, kjo gjendje mund të vijë edhe nga fakti që, megjithëse rezultatet janë të mira në disa drejtime, vërehen dobësi esenciale në disa fusha të rëndësishme.

**Dobët**

Vlerësimi ***Dobët*** jepet kur në punë vërehen dobësi të mëdha. Megjithë përvojat pozitive të shkollës në disa drejtime të izoluara të punës së saj, pamja e përgjithshme e shkollës dëshmon shumë dobësi në shumicën e drejtimeve të fushave dhe të karakteristikave të cilësië.

## 1.2 Legjislacioni

Pajtueshmëria e veprimtarisë së shkollës me kërkesat e legjislacionit shtetëror përfaqëson një kërkesë kostante të inspektimit arsimor. Shteti, nëpërmjet ligjeve dhe akteve nënligjore, përcakton kërkesat që ka shoqëria ndaj sistemit arsimor. Por, krahas vlerësimit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së shkollave me ligjin, inspektorët e përdorin legjislacionin arsimor si një burim të rëndësishëm për formulimin e kërkesave të shoqërisë për një shkollim sa më të mirë të fëmijëve. Psh. platformat e inspektimit për probleme specifike të zyrave të DAR dhe ZA e kanë burimin nga aktet ligjore përkatëse.

Aktet kryesore ligjore dhe nënligjore që përdoren nga inspektimi janë:

Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar".

Ligji Nr.8387, datë 30.07.1998 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar".

Dispozitat Normative (Për Arsimin Paraunuversitar).

Ligji i Arsimit dhe Formimit Profesional Nr. 8872, datë 29.03.2002.

Urdhër i Ministrit Nr. 213, datë 19.08.2002 "Për disa ndryshime në rregulloren Nr. 1266, datë 16.4.1999 "Për pranimet e reja në shkollat e mesme artistike, të gjuhëve të huaja, pedagogjike, sportive, teknike dhe profesionale".

Udhëzimin Nr. 11, datë 02. 11. 1994 "Për ngarkesën mësimore".

Udhëzimi Nr. 19, datë 16.10.1995 "Për shkollat e nivelit kombëtar".

Udhëzim Nr. 1, datë 30.01.1999 "Për ekuivalentimin e shkollave profesionale me shkollat e mesme të përgjithshme".

Urdhri Nr. 350,datë 02.12.2002 "Për shkollat e nivelit kombëtar".

Udhëzimi Nr. 13, datë 16.10.1995 "Për organizimin, drejtimin dhe financimin e bazave të didaktikave profesionale".

Udhëzimi Nr. 6, datë 17.02.2004 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejës së funksionimit për institucionet arsimore jopublike dhe institucionet arsimore plotësuese jopublike parauniversitare".

Udhëzimet e MASh-it për fillimin e vitit shkollor, etj.

Rregullore e MASH Nr, 224, datë 16.01.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e

inspektimit në sistemin arsimor parauniversitar".

Udhëzimi i MASH Nr. 23, datë 26.08.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e sektorëve të inspektimit në drejtoritë arsimore rajonale".

## 1.3 Konteksti

MASh përcakton detyrat që ka shkolla për arsimimin e brezit të ri. Ndërkaq, mjedisi i shkollës përfaqëson një faktor, të cilin shkolla duhet ta ketë parasysh gjatë veprimtarisë së saj. Një shkollë mund të ndodhet në një zonë, e cila ka ose nuk ka probleme specifike. Psh. shkollat nuk mund të shmangin popullatën e nxënësve dhe prindërit e tyre. Po kështu, shkollat duhet të bashkëpunojnë me pushtetin vendor, i cili mund të jetë ose jo i interesuar për problemet e tyre. Këta dhe aktorë të tjerë mund të ndihmojnë ose jo në cilësinë e punës dhe të organizimit të shkollës. Në këto kushte, shkolla duhet të përcaktojë detyra dhe objektiva, të cilat janë të realizueshme për të. Pra, faktorët e kontekstit të shkollës, të cilët kanë ndikuar në formulimin e objektivave të shkollës, mund të shërbejnë edhe si shpjegime për gjendjen e shkollës gjatë inspektimit. Inspektimi kërkon që faktorët e kontekstit të jenë pjesë e planit të saj të punës vjetore.

## 1.4 Menaxhimi dhe organizimi

Tabloja e Vlerësimit krijon kushtet për të përcaktuar se kur një shkollë është e mirë nga pikëpamja e fushës së menaxhimit dhe organizimit të saj. Kështu, një shkollë e mirë monitoron dhe rrit cilësinë e arsimimit të nxënësve të saj. Ajo analizon e vlerëson rregullisht rezultatet e nxënësve dhe mënyrën e saj të funksionimit. Mbi këtë bazë, shkolla ndërmerr veprime për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së saj. Organizimi i saj i punës është efiçient dhe efektiv. Plani i punës për realizimin e programit mësimor dhe punën që zhvillohet në klasë është i qartë. Njerëzit punojnë në grup dhe shkolla ka krijuar mundësitë për kualifikimin profesional të secilit antar të stafit mësimor. Stafi dhe burimet materiale, financiare etj. përdoren me përgjegjësi. Shkolla vendos lidhje të ngushta me ciklet paraardhëse dhe me kategoritë e shkollave ku shkojnë nxënësit e saj.

## 1.5 Procesi i mësimdhënies dhe i të nxënit

Cilësia e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit, përcaktohet nga *kurrikula*, k*oha mësimimore* dhe *puna në klasë e mësuesve.*

Një shkollë e mirë duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme për plotësimin e kërkesave të standardeve të përmbajtjes dhe atyre të arritjes në lëndët mësimore dhe në testimet e provimet e programuara, të cilat përbëjnë bazën e kurrikulës. MASh përgatit udhëzimet përkatëse për zbatimin e programit mësimor dhe shkolla duhet të sigurojë kohën e nevojshme për realizimin e tij.

Koha mësimore përfaqëson elementin që lidh lëndën mësimore me rezultat e nxënësit. Në pjesën më të madhe, ajo konsumohet në klasë. Prandaj, një atmosferë e organizuar dhe e qetë e klasës nxit të nxënit dhe zhvillimin e nxënësve. Nga ana tjetër, një atmosferë e tillë ka nevojë për një shkollë ku çdo klasë është një mjedis të nxëni i sigurtë, mbështetës dhe kërkues.

Procesi mësimor në një shkollë të mirë karakterizohet nga veprimet specifike të mësuesve. Nëse mësuesit kanë shprehi të mjaftueshme profesionale, ata mund të krijojnë situata mësimore me qendër mësuesin ose nxënësin. Ata i kushtojnë vemendje përgatitjes së mësimit dhe organizimit

të tij në klasë. Këta mësuesë nxitin pjesëmarrjen aktive të nxënëve në mësim dhe i kushtojnë vemendje strategjive të ndryshme të të nxënit. Ata i marrin parasysh ndryshimet midis nxënësve duke i nxitur të pranojnë përgjegjësi për progresin e tyre, në përputhje me potencialin e tyre vetiak.

## 1.6 Kujdesi për nxënësit

Natyrsisht, cilësia e *kujdesit për nxënësit* luan rol të rëndësishëm në shkollimin e tyre. Një shkollë e mirë ka një sistem të plotë të kujdesit për nxënësit. Kjo shprehet në kujdesin që tregohet për ta gjatë shkollës si dhe në kujdesin për zhvillimin e nxënësve me nevoja speciale.

## 1.7 Rezultatet e nxënësve

Rezultatet e nxënësve në fund të vitit shkollor/ciklit/shkollës përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të cilësisë së shkollës. Shkolla, krahas njohurive, dijeve dhe shprehive që fitojnë nëxënësit në lëndë të ndryshme mësimore, i kushton vemendje edhe shprehive të përgjithshme të nxënësit. Ruajtja e rezultateve të ciklit të mëparshëm përbën një aspekt të punës së shkollës. Shkolla duhet të analizojë rezultatet me të cilët vijnë nxënësit dhe, mbi këtë bazë, duhet të marrë masat për një kalim sa më të butë të tyre në shkollën ku vijnë. Po kështu, numri i nxënësve që e mbarojnë shkollën pa përsëritur klasën është një aspekt i rëndësishëm i rezultateve të shkollës.

## 1.8 Gjendja bazë e shkollës

Çdo shkollë përballet me faktorë, të cilët nuk mund të ndryshohen brenda një kohe të shkurtër. Të tillë faktorë mund të jenë të lidhur me zonën ku gjendet shkolla ose me probleme brenda saj. Prandaj, problemi themelor është përcaktimi *i faktorëve në gjendjen bazë të shkollës, të cilët influencojnë në mësimdhënie, të nxënit dhe rezultatet e nxënësve të shkollës.*

Karakteristikat e gjendjes bazë të shkollës nuk përbëjnë ndonjë fushë të vlerësimit të shkollës nga ana e inspektimit. Megjithatë, ato janë të rëndësishme për analizën e cilësisë së arsimimit nga pikpamja e kushteve të shkollës.

Gjatë inspektimit të plotë të shkollës trajtohen faktorët e mëposhtëm:

- Përbërja e popullatës shkollore;
- Përbërja e stafit;
- Gjendja fizike e shkollës;
- Pozicioni i shkollës në lidhje me shkollat e tjera të zonës/rajonit/vendit.

Krahas këtyre faktorëve, inspektimi përshkruan edhe tendencat që vihen re në gjendjen bazë të shkollës, politikën arsimore të pushtetit vendor, historikun e shkollës etj.

### 1.8.1 Përbërjë e popullatës shkollore

Përfaqëson faktorin e parë të gjendjes bazë të shkollës. Rezultatet që mund të arrijë një shkollë, në një masë të konsiderueshme, varen nga kjo përbërje. Natyrisht, shkollat kanë mundësi të kufizuara për të ndryshuar përbërjen e popullatës shkollore, pavarësisht nga përpjekjet e tyre në

këtë drejtim. Për këtë arësye, inspektimi mbledh informacion për:

- Numrin e nxënësve të shkollës;
- Rekomandimet e ciklit paraardhës të shkollës;
- Numrin e nxënësve minoritarë, romë, etj.;
- Numrin e nxënësve me probleme sociale, ekonomike, etj.

### 1.8.2 Përbërja e stafit

Përfaqëson faktorin e dytë të gjendjes bazë të shkollës. Edhe në këtë rast, një shkollë mund të influencojë në cilësinë e stafit të vet deri në një farë mase. Kjo mund të arrihet nëpërmjet trainimit dhe mundësisisë së përfshirjes së shkollës në punësimin e mësuesve të saj. Por, për shumicën e shkollave, stafi që ato kanë është një fakt i dhënë. Ai caktohet nga zyrat arsimore përkatëse. Për këtë arësye, inspektimi mbledh informacion për:

- Moshën e stafit mësimor;
- Kualifikimet e tij;
- Raportin e numrit të mësuesve me normë të plotë me numrin e përgjithshëm të stafit;
- Përvojën personale të mësuesve;
- Stabilitetin e stafit mësimor;
- Stabilitetin e drejtorisë së shkollës.

### 1.8.3 Gjendja fizike e shkollës

Përfaqëson faktorin e tretë të gjendjes bazë të shkollës. Një gjendje fizike e keqe e shkollës nuk mund të përmirësohet në pak ditë. Kurse një godinë shkollore e bukur ka një efekt nxitës për njerëzit që mësojnë dhe punojnë në të. Duke qenë një faktor që ndikon pjesërisht në kushtet e punës së nxënësve dhe mësuesve, inspektorët mbledhin të dhëna për:

- Moshën, gjendjen e mirëmbajtjes dhe pamjes së godinës shkollore;
- Shkollat vartëse, gjendjen e tyre fizike dhe distancat midis tyre.

### 1.8.4 Pozicioni i shkollës në lidhje me shkollat e tjera të zonës / rajonit / vendit

Një shkollë nuk është një ishull i vetmuar. Çdo shkollë është e rrethuar nga shkollat rreth saj dhe është në garë me to. Por, pavarësisht nga planet e punës që hartojnë dhe zbatojnë, shpesh, mundësitë e shkollave janë të kufizuara. Prandaj inspektimi mbledh të dhëna për:

- Madhësinë e zonës nga vijnë nxënësit (shumë afër apo nga zona më të largëta);
- Numri i nxënësve "të mirë" që është duke humbur ose fituar shkolla;
- Përqindja e braktisjes shkollore, krahasuar me shkollat e zonës dhe me treguesit në nivel vendi.

# 2. TABLOJA E PËRMIRËSUAR E VLERËSIMIT

Pyetja qendrore e inspektimit të plotë të shkollës është: **Cila është cilësia e arsimimit që ofron shkolla nga pikpamja e gjendjes bazë të saj?**

Inspektimi i përgjigjet kësaj pyetje nëpërmjet vlerësimit të 13 karakteristikave të cilësisë, të cilat shoqërohen me *treguesit* dhe *normat* përkatëse *të vlerësimit*. Siç theksuam më sipër, këto karakteristika janë të grupuara në katër fusha themelore:

- Menaxhimi dhe organizimi i shkollës (5 karakteristika).
- Procesi i mësimdhënies dhe të të nxënit (5 karakteristika).
- Kujdesi për nxënësit (2 karakteristika).
- Rezultatet e nxënësve (1 karakteristikë).

Më poshtë janë përshkruar fushat, karakteristikat përkatëse të cilësisë, treguesit dhe normat e vlerësimit. Ato i shërbejnë grupit inspektues për vlerësimin e shkollës sipas platformave të inspektimit. Por, ato mund të përdoren edhe nga drejtoritë e shkollave dhe mësuesët sepse paraqesin drejtimet e inspektimit shtetëror në shkollën e tyre. Fjala është për veçanërsiht për çështje ku shkolla ka probleme dhe ndjehet nevoja për përmirësim. Tabloja e Vlerësimit ndihmon në identifikimin e tyre dhe vendosjen e objektivave për ndryshimin e gjendjes. Si të tilla ato duhet të vendosen në planin vjetor të punës punës së shkollës.

## 2.1 Menaxhimi dhe organizimi i shkollës

### Rëndësia e Fushës "Menaxhimi dhe Organizimi i Shkollës"

Nëpërmjet kësaj fushe, vlerësohet se si plani i punës i shkollës i shërben cilësisë së arsimimit të fëmijëve. Shkolla ka përgjegjësinë për cilësinë e shërbimit që ofron dhe për përmirësimet e nevojshme që duhet të relizojë për ruajtjen e cilësisë. Pra, shkolla duhet të zhvillohet. Kjo do të thotë që zhvillimi i saj duhet të kryhet sipas një plani pune, duke ruajtur një lloj autonomie të zbatimit të këtij plani nga influencat jashtë saj. Shkolla duhet të përcaktojë kursin e vet të veprimtarive ditore, të krijojë bashkërendim midis aspekteve të ndryshme të punës së saj dhe t'i kushtojë vemendje kujdesit për stafin dhe nxënësit. Në planin e punës së shkollës duhet të dallohet qartë përfshirja e stafit në hartimin e tij dhe puna në grup që kryhet për ruajtjen e cilësisë. Po kështu, vlerësohet edhe vemendja e shkollës në krijimin e një atmosfere që siguron bashkëveprim aktiv midis nxënësve dhe mësuesve për t'i motivuar të mësojnë sa më mirë. Pjesë e kësaj fushe është edhe komunikimi i shkollës me institucione dhe specialistë të nevojshëm për punën e saj.

Në këtë kontekst, fusha "Menaxhimi dhe organizimi i shkollës" vlerësohet/vetvlerësohet me anë të pesë karakteristikave të mëposhtme të cilësisë:

- Shkolla monitoron cilësinë e shkollimit që ofron dhe merr masa për ruajtjen dhe përmirësimin e saj (karakteristika e cilësisë 1);

- Procesi mësimor dhe zhvillimi i punës në grup synojnë përmirësimin e cilësisë së shkollimit (karakteristika e cilësisë 2);
- Shkolla përdor stafin dhe burimet materiale me efektivitet (karakteristika e cilësisë 3);
- Shkolla kujdeset për një klimë shkollore të sigurtë dhe motivuese (karakteristika e cilësisë 4);
- Shkolla ruan kontakte të jashtme funksionale (karakteristika e cilësisë 5).

Më poshtë janë trajtuar treguesit që përdoren gjatë procesit të inspektimit të fushës "Menaxhimi dhe organizimi i shkollës".

## Karakteristika e cilësisë 1

## Shkolla monitoron cilësinë e shkollimit që ofron dhe merr masa për ruajtjen dhe përmirësimin e saj.

Monitorimi dhe përmirësimi i cilësisë përbëjnë thelbin e procesit të ruajtjes së saj. Cilësia e shkollimit ka të bëjë me proceset që sigurojnë rezultatet e pritshme të nxënësve (karakteristikat 1 deri 7) dhe me vetë këto rezultate (karakteristika 13).

Për vëzhgimin e ruajtjes së cilësisë, Inspektimi përqëndrohet në këto tri çështje:

- Niveli me të cilin shkolla përcakton cilësinë e shkollimit që ofron dhe përmirësimet që ndërmerr në bazë të këtyre përcaktimeve.
- Plani i punës që harton shkolla dhe zbatimi i tij.
- Kujdesi me të cilin shkolla vlerëson punën e saj dhe përmirësimet e nevojshme që bën mbi këtë bazë.

Drejtoria e shkollës, nëse kërkon të jetë e aftë për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë, duhet *të ketë njohuri për cilësinë e shkollimit që ofron* (Treguesi 1.2). Shkolla përcakton prioritetet e veta. Pas kësaj, drejtoria e shkollës duhet të kontrollojë vazhdimisht për të përcaktuar pikat e forta dhe pikat e dobëta që shfaqen në organizimin e punës, procesin mësimor dhe mënyrën se si punojnë mësuesit brenda këtij procesi. Pra, drejtoria e shkollës duhet të kontrollojë pikat e rrezikut të punës në shkollë, pikat ku përmirësimet janë të domosdoshme dhe pikat ku mundësitë e saj janë të kufizuara. Rezultatet e kësaj analize duhet të çojnë në formulimin e objektivave për përmirësim (Treguesi 1.1). *Shkolla duhet t'i pasqyrojë këto objektiva në planin e saj të punës.*

Natyrisht, shkolla nuk është tërësisht e lirë në zgjedhjen e objektivave të saj. Shkolla përmbush funksione sociale, të cilat, në pjesën më të madhe përcaktohen nga shteti nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore. Në shoqëri ndodhin ndryshime, të cilët pasqyrohen në konceptet mbi të cilat ngrihen nivelet e ndryshme të arsimit (psh,. sistemi arsimor i detyruar 9vjeçar), rrugët e të nxënit, futja e teknologjisë së informacionit etj. Shkolla duhet t'i përfshijë këto zhvillime në planin e saj të punës (Treguesi 1.3). Nga ana tjetër, ka edhe faktorë të tjerë, të cilët janë të lidhur direkt me shkollën. Kërkesat në rritje të prindërve, ndryshimet në mënyrën e sjelljes së nxënësve, përbërjen demografike të zonës që ushqen shkollën me fëmijë, cilësia e mësuesve të shkollës etj., të gjithë këta janë faktorë që duhet të shërbejnë si arësye për ndryshime në organizimin dhe metodat e punës së shkollës. Si të tillë, ata *duhet të pasqyrohen si objektiva në planin e saj të punës.*

Shkolla ka detyrime që rrjedhin nga kërkesat e objektivave kombëtare dhe lokale në fushën

e arsimit. Prandaj, ajo duhet t'i formulojë këto detyrime në *formën e objektivave përkatës* bashkë me masat për realizimin e tyre (Treguesi 1.4). Është e rëndësishme që masat të koordinohen me analizën e gjendjes bazë të shkollës dhe objektivat e përgjithshme të saj. Por, shkolla mund të deklarojë se ka realizuar përmirësimet e planifikuara vetëm nëse është kontrolluar efektiviteti i masave që ajo ka marrë.

Më poshtë janë paraqitur kërkesat e secilit tregues për vlerësimin e karakteristikës 1 si dhe normat përkatëse që shkolla të vlerësohet me nivelin "***Mirë***".

## Treguesit

1.1 *Shkolla analizon sistematikisht cilësinë e shkollimit që është duke ofruar.*

Inspektimi vëzhgon nëse shkolla ka:
- Plan vjetor të punës ku janë parashikuar objektivat si dhe procedurat e instrumentat me anë të të cilëve përcakton cilësinë e shkollimit që është duke ofruar;
- Realizuar vlerësimin vjetor të rezultateve në lëndë mësimore e klasa;
- Rregullsi në vlerësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies/të nxënit dhe të kujdesit për nxënësit;
- Dokumentacion të drejtorisë së shkollës, i cili dëshmon se janë kryer analiza të sukseseve dhe të dobësive të shkollës.

1.2 *Shkolla ka pasqyruar ndryshimet e dokumentacionit shtetëror në planin e saj të punës.*

Inspektimi vëzhgon nëse drejtoria e shkollës ka zbërthyer:
- Udhëzimin për fillimin e vitit të ri shkollor;
- Udhëzimet e ndryshme për lëndë, cikle, profile etj.;
- Dokumentacionin shtetëror sipas situatave të zhvillimeve në sistemin arsimor.

1.3 *Shkolla funksionon në përputhje me zhvillimin e zonës ku ndodhet dhe e pasqyron atë në planin e saj të punës.*

Inspektimi vëzhgon nëse në planin e punës janë përfshirë:
- Imazhi që ka shkolla në sytë e prindërve, ishnxënësve të saj, shkollave dhe cikleve pasardhëse, shkollave pasardhëse, punëdhënësve etj.;
- Përbërja demografike e zonës ku funksionon shkolla.
- Rezultatet e shkollës, të krahasuara me shkollat e tjera të zonës/qarkut/vendit.

1.4 *Shkolla organizon inspektime sistematike për të parë efektin e masave të marra për përmirësimin e punës.*

Inspektimi vëzhgon nëse shkolla ka realizuar:
- Monitorimin e rregullt të aktiviteteve të planifikuara në planin e punës;
- Vlerësimin e efektivitetit të tyre;
- Përfshirjen e bordit të shkollës në këtë proces.

***Norma*** ***Karakteristika vlerësohet me nivelin "Mirë" nëse vlerësohen pozitivisht të gjithë treguesit.***

## Karakteristika e cilësisë 2

## Procesi mësimor dhe zhvillimi i punës në grup synojnë përmirësimin e shkollimit.

Inpektimi vëzhgon zhvillimin e punës në grup në tre nivelet që vijojnë:

- Kujdesi i shkollës për bashkërendim organizativ midis aktorëve të ndryshëm që veprojnë brenda saj. (*treguesit 2.1 dhe 2.2*);
- Përfshirja e stafit në punën në grup (*treguesit 2.3 - 2.4*);
- Zhvillimi i kompetencave individuale të mësuesve *(treguesi 2.5*).

Le t'i shohim më konkretisht këta tregues.

Shkolla, përveç stafit drejtues, ka edhe elementa të tjerë organizativë si mësuesit e lëndëve, mësuesit kujdestarë, drejtuesit e departamenteve, Qeveria e nxënësve etj. Nga pikëpamja organizative, këto elementë veprojnë pak a shumë në mënyrë autonome. Prandaj drejtoria e shkollës duhet të vendosë ura lidhjeje midis tyre, duke nxitur konsultime dhe bashkëpunim brenda secilit element si dhe midis elementeve të ndryshëm. ( treguesi 2.1)

Niveli i mesëm i menaxhimit, (personeli pa fuqi administruese psh. mësuesit me detyra specifike si shefat e departamenteve, mësuesët kujdestarë, mësuesët e përfshirë në projekte, aktivitete zonale e kombëtare) përfaqëson një grup të rëndësishëm brenda shkollës. Ky nivel duhet të punojë me efiçiencë dhe efektivitet për zbërthimin e programit mësimor, hartimin e materialeve mësimore, të testeve si dhe në përcaktimin e natyrës dhe sasisë së detyrave të shtëpisë (*Treguesi 2.2*).

Drejtoria e shkollës duhet të sigurojë përfshirjen e stafit në hartimin e planit të punës. Në këtë mënyrë sigurohet mbështetja e atyre që duhet ta zbatojnë këtë plan. Nga ana tjetër, ajo duhet të sigurojë mbështetjen e mjaftueshme pë këtë përfshirje (*Treguesi 2.3*). Koherenca në organizimin e punës dhe realizimi i ndryshimeve presupozon se mësuesit punojnë bashkërisht. Prandaj, drejtoria e shkollës duhet të jetë e qartë në nxitjen e kooperimit psh. me anë të formave organizative, që kërkojnë punë në grup të mësuesve (*Treguesi 2.4*).

Mjaft i rëndësishëm është edhe kontrolli i stafit mësimor. Në këtë rast, drejtoria e shkollës përdor orët e kontrollit, analizat vlerësuese si dhe planet personale të kualifikimit duke u kujdesur për shmangien e mbingarkesës apo të presionit ndaj mësuesve.

Drejtoria e shkollës duhet të ketë një tabllo të plotë dhe sistematike të nivelit të formimit të mësuesve, të nevojave specifike që ata kanë (*Treguesi 2.5*) si dhe të objektivave të shkollës (karakteristika e cilësisë 1). Ajo duhet të sigurojë gatishmërinë e mësuesve për t'u përfshirë në trajnime të mëtejshme brenda dhe jashtë shkkollës. Brenda shkollës, vemendja përqëndrohet në trajnimet individuale dhe ato në grup nëpërmjet formave të tilla si konsulta, vizita të ndërsjellta në orë mësimi si dhe trajnim midis kolegësh. Jashtë saj, shkolla duhet të përfshihet në veprimtaritë trajnuese të ofruara nga ZA, institucione të specializuara dhe OJF të ndryshme duke zgjedhur modulet e trajnimit sipas nevojave të stafit të saj.

Një aspekt tjetër i zhvillimit profesional është puna me mësuesit e rinj. Gjithmonë, duke kërkuar që ata të jenë "të mirë" qysh në ditën e tyre të parë të punës në shkollë, ngarkohen me një sërë detyrash që nuk mund të realizohen nga askush. Prandaj, shkolla duhet të kujdeset për trajnimin e mësuesve të rinj. Në planin e saj të punës, duhet të jetë e qartë se kush kryen kontrollin e mësuesve të rinj dhe si është organizuar mbështetja dhe vlerësimi i tyre.

Më poshtë janë paraqitur treguesit për vlerësimin e karakteristikës 2.

## Treguesit

2.1 *Drejtoria kujdeset për bashkërendimin e aspekteve të ndryshme të punës së shkollës.*
Inspektimi vëzhgon nëse në çdo rast, drejtoria e shkollës:

- Eshtë e mirëinformuar për punën që kryhet në shkollë dhe konsultohet rregullisht me mësuesit e lëndëve dhe mësuesit kujdestarë; mësuesit kordinator të Qeverive të nxënësve, bordin e prinderve, Qeverine e nxenesve etj.
- Nxit dhe organizon konsulta midis mësuesve në shkollë;
- Përfshin nxënësit në konsultime nëpëmjet Qeverisë së nxënësve.
- Ndan detyrat sipas lëndëve mësimore, klasave, cikleve, mësuesve kujdestarë etj.

---

2.2 *Drejtoria kujdeset për përfshirjen e përgjegjësve të departamenteve lëndore, mësuesve kujdestarë etj. në hartimin dhe zbatimin e planit të punës së shkollës.*
Meqë ky grup realizon lidhjen midis punës në klasë dhe drejtorisë së shkollës, inspektimi vëzhgon nëse ai është përfshirë në:

- Hartimin e planit të punës së shkollës;
- Zbatimin e tij;
- Raportimin e rregullt për detyrat dhe aktivitetet që kryejnë si dhe për rezultatet e tyre.

*Ky tregues nuk vlerësohet në shkollat e vogla.*

---

2.3 *Stafi ka mbështetjen e mjaftueshme të drejtorisë për realizimin e planit të punës së shkollës.*
Për këtë, inspektimi vlerëson nëse drejtoria:

- Informon shkollën në kohën e duhur për zhvillimet që kanë ndodhur dhe vendimet që janë marrë;
- Mban lidhje me këshillin e prindërve, qeverinë e nxënësve etj.;
- Dëgjon me vemendje mësuesit e shkollës;
- Eshtë e hapur me të gjithë stafin.

---

2.4 *Drejtoria nxit punën në grup gjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të planit të punës së shkollës.*
Në këtë rast, nga inspektimi vlerësohen:

- Grupet e punës dhe grupet në nivel departamenti apo cikli në të cilët mësuesit punojnë bashkë për probleme të ndryshme të shkollës;
- Vizitat reciproke të mësuesve në orët mësimore;
- Veprimtari mësimore për shkëmbimin e përvojës së secilit mësues.

---

2.5 *Shkolla kujdeset që kualifikimi i brendshëm të nxit rritjen e profesionalizmit të antarëve të stafit të shkollës.*
Në këtë rast, vëzhgohet nëse drejtoria e shkollës ka:

- Identifikuar nevojat që ka stafit i shkollës për kualifikim.
- Hartuar një plan trajnimi, të specifikuar për individë apo grupe mësuesish si dhe me personat që do të bëjnë supervizionin e tyre.
- Përcaktuar mësuesit e shkollës që do të përfshihen në trajnim.
- Përcaktuar specialistët dhe institucionet jashtë saj që do të realizojnë trajnimin e stafit në probleme të specializuara.

- Evidentuar aftësinë e mësuesve për të përdorur kompjuterin në mësim ( nëse shkolla ka kompjuter).

---

2.6 *Shkolla siguron mbështetjen dhe udhëheqjen e mësuesve të rinj.*
Inspektimi vlerëson nëse:
- Shkolla kujdeset që mësuesit e rinj të udhëhiqen nga antarë të drejtorisë, mësues me përvojë.

Natyrisht, kjo udhëheqje vlerësohet veças nga vlerësimi i punës së tyre.

**Norma** ***Karakteristika vlerësohet me nivelin "Mirë" nëse vlerësohen pozitivisht treguesit 2.1, 2.3 dhe dy nga treguesit e tjerë.***

## Karakteristika e cilësisë 3

## Shkolla përdor me efektivitet stafin dhe burimet materiale.

Funksioni i shkollës është të aftësojë nxënësit për të mësuar. Por, për arritjen e këtij objektivi duhen siguruar burimet e nevojshme. Në kontekstin e burimeve që kanë, shkollat duhet të përcaktojnë mundësitë dhe prioritetet e tyre në këtë fushë. Inspektimi vëzhgon nëse në shkollë ka tregues të dukshëm, të cilët dëshmojnë se ajo është duke e përdorur stafin dhe burimet materiale jo me efiçiencë. Nëse këta tregues nuk gjenden, atëhere kjo karakteristikë vlerësohet pozitivisht.

Para së gjithash, efiçienca e organizimit shihet në procedurat e realizimit ditor të mësimit (*Treguesi 3.1*). Mënyra se si përdoren stafi dhe burimet materiale në shkollë duhet të jetë shumë e qartë për të gjithë komunitetin e shkollës.

Shkolla jonë akoma nuk ka shumë liri në zgjedhjen dhe punësimin e stafit të saj. Sidoqoftë, shkolla duhet të përcaktojë një minimum kërkesash për mësuesit që i duhen asaj, në mënyrë që të bëjë presionin e duhur ndaj zyrave arsimore kur ato bëjnë emërimet e mësuesve (*Treguesi 3.2*). Në këtë kontekst duhen trajtuar edhe burimet materiale për realizimin e procesit mësimor. Kjo do të thotë që klasat të kenë hapësirat e nevojshme, me kushte dhe pajisje shkollore të përshtatshme (*Treguesi 3.3*) si dhe pajisje mësimore të përshtatshme (*Treguesi 3.4*). *Këta treguesë kanë shumë peshë në vlerësimin e shkollave me godina dhe bazë materiale të përshtatshme.*

Shkolla duhet të krijojë kushtet e nevojshme që mësuesit të punojnë gjatë kohës që nuk kanë mësim. Fjala është për sallën e mësuesve dhe kushte të tjera si anekse laboratorësh etj, të pajisura në mënyrën e duhur (*Treguesi 3.5*).

Më poshtë janë paraqitur treguesit për vlerësimin e karakteristikës 3.

### Treguesit

3.1 *Shkolla siguron një ritm normal të veprimtarisë mësimore ditore.*
Në këtë rast inspektimi vëzhgon nëse:
- Ritmi i jetës në shkollë të krijon përshtypjen e rregullit dhe të një organizimi të mire;
- Informacioni i grumbulluar tregon se procesi mësimor ecën mire;
- Rregullat dhe procedurat e punës janë të qarta dhe të dukshme për të gjithë.

3.2 *Shkolla merr masa për parandalimin e humbjeve të mësimit nëpërmjet plotësimit në kohë të stafit mësimor të organikës së saj.*
Inspektimi kontrollon nëse ka pasur:
- Mungesa të stafit dhe janë marrë masa për zgjidhjen e rasteve kur mungojnë mësuesit;
- Bashkëpunim të shkollës me DAR/Z dhe pushtetin vendor për mësuesit provizorë;
- Ndryshime në orar për plotësimin e orëve bosh.

---

3.3 *Klasat janë të përshtatshme për mësim.*
Në këtë rast vëzhgohet nëse:
- Klasat janë me hapësirë dhe laboratorët kanë pajisjet e nevojshme;
- Pajisjet si bangat, dërrasa e zezë etj janë të sistemuara, të pastra dhe të mirëmbajtura;
- Shkolla ka bibliotekë, mjedise për të mësuar (psh. salla studimi) ose mjedise të qeta (psh. lulishte); salla e kompjuterave nuk përfshihet sepse i korespondon treguesit 3.6

***Tregues negativë*** janë rastet kur punët e laboratorit në klasë ose mësimet zhvillohen në laborator (kur shkolla ka laboratorë).

---

3.4 *Shkolla ka pajisje mësimore të mjaftueshme dhe ato përdoren në mënyrën e duhur.*
Inspektimi vëzhgon nëse:
- Pajisjet mësimore janë sipas kërkesave të programit mësimor dhe përdoren në mënyrën e duhur;
- Mësuesit përdorin bazë materiale mësimore të realizuar nga ata vetë;
- Ka kërkesa të përcaktuara ndaj bibliotekës së shkollës, sallës së kompjuterave etj.

---

3.5 *Shkolla ka sallë mësuesish dhe mjedise të tjera pune për mësuesit dhe stafin ndihmës, të pajisura në mënyrë të përshtatshme.*
Inspektimi vëzhgon:
- Sallën e mësuesve, mjediset e tjera të punës së mësuesve dhe pajisjet e tyre;
- Bibliotekën, kompjuterat, printerat, fotokopjet në ndihmë të mësuesve për hartimin e testeve (nëse ka);
- Salla/mjedise për konsultimin e nxënësve (nëse ka).

---

**Norma** ***Karakteristika vlerësohet me nivelin "Mirë" nëse janë vlerësuar pozitivisht treguesit 3.1, 3.4 dhe dy treguesë të tjerë.***

## Karakteristika e cilësisë 4

## Shkolla kujdeset për një klimë shkollore të sigurtë dhe motivuese.

Një klimë shkolle pozitive mund të ndikojë shumë në rritjen e rezultateve, veçanërisht në zvogëlimin e mungesave, braktisjes shkollore, vandalizmit dhe krimeve në rradhët e të rinjve. Shkollat duhet të bëjnë maksimumin për të krijuar një klimë të tillë ku nxënësit të ndjehen si në shtëpi, që favorizon të mësuarit dhe edukimin e tyre. Shkollat duhet t'i njohin prindërit për klimën që u ofrojnë fëmijve të tyre në shkolë.

Një klimë e mirë shkollore shihet në marrëdhëniet e mira midis mësuesve dhe nxënësve gjatë situatave mësimore si dhe midis stafit të shkollës dhe nxënësve jashtë mësimit (*Treguesi 4.1*). Nxënësit, si klientë të shkollës, duhet të vlerësojnë atë që u ofron shkolla (*Treguesi 4.2*).

Aspekti i tretë ka lidhje me mjedisin fizik të shkollës, pra, me çështje të tilla, si: meremetimi i shkollës, kushtet higjienike etj. Megjithëse shkolla ka pak ndikim ndaj këtyre kushteve, ajo duhet të marr të gjitha masat për mbajtjen pastër të mjediseve brenda dhe jashtë saj (*Treguesi 4.3*).

Nxënësit duhet të ndjejnë se janë pjesë e komunitetit. Prandaj shkolla duhet të organizojë veprimtari ku ata të marrin pjesë (*Treguesi 4.4*). Të tilla mund të jenë festa të shkollës, pushimet shkollore dhe aktivitetet të tjera të shpërndara gjatë gjithë vitit shkollor.

Siguria dhe rregulli janë shumë të rëndësishëm. Shkollat duhet të organizojnë supervizionin e nxënësve dhe të garantojnë sigurinë për pajisjet e tyre personale (*Treguesi 4.5*). Shkollat duhet të kenë rregulla të qarta të sjelljes (*Treguesi 4.6*) dhe të garantojnë zbatimin e tyre korrekt (*Treguesi 4.7*).

Më poshtë janë paraqitur treguesit për vlerësimin e karakteristikës 4.

## Treguesit

*4.1* *Ka një klimë bashkëveprimi midis antarëve të stafit dhe nxënësve të shkollës.*

Inspektimi vëzhgon:

- Mënyrën se si bashkëveprojnë antarët e stafit me nxënësit jashtë mësimit; mënyrën si bashkëveprojnë anëtarët e stafit me Qeverinë e nxënësve;
- Mënyrën se si flasin për nxënësit;
- Qetësinë dhe maturinë me të cilin veprojnë antarët e stafit kur nxënësit shfaqin sjellje të gabuara;
- Vënien e theksit në sjelljen pozitive, por duke mos toleroruar sjelljen negative;
- Trajtimin me seriozitet të nxënësve.

---

*4.2* *Nxënësit vlerësojnë atë që u ofron shkolla.*

Inspektimi vëzhgon:

- Mënyrën se si flasin nxënësit për shkollën;
- Mendimet e prindërve të tyre për shkollën;
- Pjesëmarrjen e nxënësve në veprimtaritë jashtëshkollore.
- Opinionin e Qeverisë së nxënësve për shkollën.

---

*4.3* *Shkolla kujdeset dhe përgatit një mjedis mikpritës për nxënësit.*

Vëzhgohet:

- Vemendja që i është kushtuar dëshirave dhe nevojave të nxënësve për rregull, kujdes dhe pastërti të klasave, koridoreve dhe mjediseve të tjera;
- Paraqitja e freskët dhe e bukur e mjediseve të shkollës.

---

*4.4* *Shkolla organizon veprimtari për rritjen e përfshirjes së nxënësve në shkollë.*

Vëzhgohen:

- Veprimtaritë që planifikohen dhe organizohen nga vetë nxënësit nëpërmjet strukturave të tyre që kanë lidhje me kurrikulën ose identitetin e shkollës;
- Veprimtaritë jashtëshkollore si: mbrëmjet e shkollës, botimi i gazetës së shkollës nga nxënësit, aktivitetet sportive, kurse kompjuteri, etj.

---

4.5 *Shkolla mer masa që nxënësit të jenë të sigurtë.*
Inspektimi vëzhgon nëse:
- Në shkollë eshtë organizuar supervizioni i nxënësve dhe ata ndjehen të sigurtë;
- Shkolla zbaton një plan edukimi me tema rreth sjelljes së rrezikshme dhe violencës me përdorimin e armëve.

4.6 *Shkolla ka një rregullore të qartë të sjelljes dhe disiplinës.*
Vëzhgohet nëse shkolla ka:
1. Rregulla të qarta se si duhet të sillen nxënësit dhe mësuesët me njëri tjetrin;
2. Respekt ndaj njeri tjetrit dhe për kulturat e tjera;
3. Parandalim të keqtrajtimeve;
4. Parandalimin e përdorimit të drogës, ofendimeve dhe akteve të violencës.

4.7 *Stafi zbaton rregullat e sjelljes në mënyrë të ndërgjegjshme.*
Vëzhgohet nëse:
- Stafi vepron nëse thyhen rregullat e vendosura.

**Norma** ***Karakteristika merr vlerësimin "Mirë" nëse pesë nga shtatë treguesit marrin vlerësim pozitiv.***

## Karakteristika e cilësisë 5

## Shkolla ruan kontakte të jashtme funksionale.

Shkolla bashkëvepron me grupe të ndryshëm, të interesuar për arsimin dhe me të cilat ajo ka kontakte. Është përdorur termi "funksionale" sepse këto kontakte janë veçanërisht të rëndësishme për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë.

Natyrisht, shkolla ruan kontakte me ciklet apo shkollat paraardhëse nga vijnë nxënësit e tyre (*Treguesi 5.1*) dhe ciklet apo shkollat ku ata shkojnë pas përfundimit të ciklit apo shkollës (*Treguesi 5.2*). Në këtë mënyrë, shkolla orientohet më mirë në trajtimin e nxënësve që vijnë dhe në këshillimin e nxënësve që e mbarojnë.

Shkollat duhet të mbajnë kontakte funksionale me prindërit (*Treguesi 5.3*). duke u dhënë mundësinë për të diskutuar idetë që kanë dhe t'i ndihmojë të marrin vendime. Po kështu, shkollat i informojnë prindërit rregullisht lidhur me problemet e shkollës (me anë të letrave, tabelave të rezultateve, gazetës së shkollës, etj.).

Është në interesin e shkollës që prindërit të kenë një përshtypje sa më të mirë për të dhe të ndjehen të përfshirë në jetën e shkollës. Pra, shkolla duhet të bëjë maksimumin për përfshirjen e prindërve në shkollë psh. nëpërmjet informacionit që u jep në takimet e prindërve. Veç kësaj, prindërit duhet të ftohen të japin idetë dhe mendimet e tyre rreth organizimit të mësimit nëpërmjet këshillit të prindërve, bordit dhe pjesëmarrjes në to.

Në rastin e shkollave profesionale, ato duhet të mbajnë kontakte me institucionet që mund të ndihmojnë për sigurimin dhe pajisjen me bazë materiale mësimore e mjediseve ku zhvillohet praktika e nxënësve (*Treguesi 5.5*).

Pushteti vendor është duke u bërë shumë i rëndësishëm për zbatimin e politikës arsimore.

Që t'i përgjigjet sa më mirë kësaj politike, shkolla duhet të jetë e informuar dhe të mbajë kontakte të mira në nivel vendor (*Treguesi 5.6*).

Shkollat përfaqësojnë institucione që kanë përgjegjësinë e zbatimit të novacioneve të ndërmarra nga shteti (profilizimi i shkollës së mesme, arsimi 9-vjeçar i detyruar etj.). Prandaj, shkollat duhe të mbajnë kontakte funksionale me autoritetet lokale, organizatat e të rinjve dhe institucione të tjera të interesuara për arsimin. Kërkohet që shkollat të jenë aktive në këtë drejtim dhe të përdorin mirë përvojën e fituar për përmirësimin e cilësisë (*Treguesi 5.7*).

Më poshtë janë paraqitur treguesit për vlerësimin e kësaj karakteristike.

## Treguesit

5.1 *Shkolla ruan kontakte me shkollat nga vijnë nxënësit për zbutjen e problemeve të kalimit të tyre nga një shkollë në tjetrën.*

Vëzhgohen:

- Konsultimet e shkollës me shkollat nga vijnë nxënësit për tërheqjen e nxënësve të tyre;
- Konsultimin me informacionin përkatës (psh deftesat), i cili shoqëron kalimin e nxënësve nga një shkollë në tjetrën;
- Konsultimet specifike për nxënësit që kanë nevojë për vemendje të veçantë;
- Konsultimet për nxënësit që kanë qenë pjesëmarrës në Qeverinë e nxënësve.
- Informimi i shkollës nga vijnë nxënësit për rezultatet dhe cilësinë e nxënësve që ajo ka dërguar.

---

5.2 *Shkolla mban kontakte me shkollat ku shkojnë nxënësit e saj për t'i këshilluar dhe për të zbutur kalimin e tyre në to.*

Inspektimi vëzhgon nëse shkolla interesohet për:

- Rezultatet e nxënësve të saj në shkollat ku shkojnë;
- Shkollat/Vendet ku shkojnë nxënësit e saj pas përfundimit të shkollës.

---

5.3 *Prindërit janë të informuar në mënyrë të qartë për shkollën dhe zhvillimet e saj.*

- Vëzhgohen materialet dhe rrugët që përdor shkolla për të informuar prindërit.

---

5.4 *Shkolla organizon veprimtari për rritjen e përfshirjës së përgjithshme të prindërve në problemet e shkollës.*

Vëzhgohen:

- Takimet me prindërit dhe vizitat e prindërve në shkollë;
- Funksionimi i këshillit të prindërve.

---

5.5 *Shkolla mban kontakte me institucionet që ofrojnë vende pune për një orientim të përshtatshëm të nxënësve në tregun e punës (për shkollat e mesme profesionale).*

Ky tregues vëzhgohet për shkollat profesionale.

---

5.6 *Shkolla merr pjesë në forma të ndryshme kooperimesh.*

Vëzhgohen kooperimet e shkollës me autoritetet vendore, organizatat e të rinjve dhe institucione të tjera të interesuara për arsimin.

**Norma** ***Karakteristika merr vlerësimin "Mirë" kur vlerësohen pozitivisht Treguesit 5.2 dhe 5.3 dhe dy Treguesë të tjerë.***

## 2.2 Procesi i mësimdhënies dhe të të nxënit

Cilësia e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënit përcaktohet nga **kurrikula mësimore** (karakteristika e cilësisë 6), **koha mësimore** (karakteristika e cilësisë 7), **puna në klasë** (karakteristika e cilësisë 8), **strategjia mësimdhënëse** e mësuesit (karakteristika e cilësisë 9) dhe **veprimtaritë mësimore të nxënësve** (karakteristika e cilësisë 10).

Më poshtë janë trajtuar karakteristikat e fushës së mësimdhënies/të nxënit.

### Karakteristika e cilësisë 6

### Shkolla ofron garanci për arritjen e objektivave mësmore dhe realizimin me sukses të provimeve.

Nxënësit mësojnë nëpërmjet përvehtësimit të lëndëve mësimore. Për shtetin, hartimi i kurrikulës me standardet përkatëse, përbën një instrument të rëndësishëm të sigurimit të një baze të përbashkët arsimimi për të gjithë nxënëësit dhe për të garantuar efektin e nevojshëm të provimeve. Shkolla ka për detyrë të organizojë mësimin në mënyrë që nxënësit të familjarizohen me objektivat e lëndëve mësimore dhe me kërkesat e provimeve.

Kurrikula është e organizuar në lëndë mësimore. Shteti, nëpërmjet programeve mësimore, përcakton objektivat që duhet të arrijnë nxënësit në fund të secilit nivel arsimimi. Rrjedhimisht, shkolla duhet të ofrojë garancitë e nevojshme që kurrikula të zbatohet në përputhje me udhëzimet shtetërore (*Treguesit 6.1 dhe 6.2*). Përgatitja për provimet duhet të përputhet me kërkesat e kurrikulës (*Treguesit 6.3 dhe 6.4*). Nga ana tjetër, shkolla duhet të fokusohet edhe në formimin e shprehive të përgjithshme tek nxënësit (*Treguesi 6.5*) në mënyrë që ata të jenë të aftë të mësojnë se si të veprojnë, të mësojnë, të komunikojnë dhe të reflektojnë.

Nxënësit përvetësojnë kurrikulën nëse realizohet koherenca brenda secilës lëndë mësimore si dhe midis atyre pjesëve të lëndëve të ndryshme mësimore, të cilat kanë lidhje me njera tjetrën. Metodat e punës, me të cilat nxënësi integron dije dhe njohuri nga lëndë të ndryshme mësimore, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e një trupi koherent njohurish, dijesh dhe shprehish (*Treguesi 6.7*). Nxënësit ndryshojnë nga njeri tjetri. Ky fakt kërkon koordinimin e arsimimit sipas njohurive të nxënësve. Një gjë e tillë realizohet nëpërmjet ndarjes së nxënësve në grupe të ndryshme (*Treguesi 6.8*). Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit përbën një aspekt të arsimimit të nxënësve. Inspektimi kontrollon përpjekjet që bën shkolla në këtë drejtim dhe mënyrën se si ajo e përdor atë në lëndë të ndryshme mësimore.

Më poshtë janë paraqitur treguesit për vlerësimin e karakteristikës.

### Treguesit

*6.1* *Shkolla ofron garanci për realizimin e programit të lëndëve mësimore.*

Gjatë inspektimit shkolla duhet të tregojë:

- Masat që janë marrë për realizimin e lëndëve mësimore;
- Përputhjen midis numrit të planifikuar të orëve të mësimit për secilën lëndë dhe numrit të realizuar në praktikë. Nëse ka mospërputhje, shkolla duhet të justifikojë këto devijime;
- Lëndët me zgjedhje apo kurset që organizon shkolla.

6.2 *Shkolla ofron garanci për realizimin e programit të lëndëve mësimore që shoqërohen me provime.*
Gjatë inspektimit shkolla duhet të tregojë:
- Aktivitetet që janë planifikuar sipas specifikave të lëndëvë që shoqërohen me provime;
- Koordinimin e punës për realizimin e kërkesave të provimeve.

---

6.3 *Shkolla ofron garanci se provimet e lirimit / pjekurisë janë me cilësi të mjaftueshme.*
Inspektimi vëzhgon:
- Mospërputhjen midis rezultateve të provimit të lirimit / pjekurisë dhe vlerësimeve përfundimtare të shkollës;
- Vlerësimet përfundimtare të shkollës, të cilët duhet të jenë brenda kufijve të pranueshëm;
- Masat për zhvillimin korrekt të provimeve.

---

6.4 *Nxënësit fitojnë shprehi të përgjithshme gjatë procesit të realizimit të programit të të gjitha lëndëve mësimore.*
Inspektimi vëzhgon masat që ka marrë shkolla për:
- Organizimin e aktiviteteve kros-kurrikulare;
- Zhvillimin e shprehive të nxënësve për të marre informacion dhe komunikuar.

---

6.5 *Kalimi i nxënësve nga një cikël në tjetrin brenda secilës lëndë mësimore është i natyrshëm.*
Inspektimi verfikon:
- Problemet që kanë shoqëruar kalimin e nxënësve nga një cikël në tjetrin, analizat e kryera dhe rezultatet e arritura;
- Materialet që dëshmojnë se mësuesit e njerit cikël janë të familiarizuar me lëndët mësimore të cikleve para dhe pasardhëse;
- Rezultatet e nxënësve në ciklet më të larta;
- Numrin e nxënësve përsëritës në vitin e parë të secilit cikël.

---

6.6 *Shkolla bën përpjekje të ndërgjegjshme për realizimin e lidhjes ndërlëndore midis lëndëve të ndryshme mësimore.*
Treguesi vlerësohet pozitivisht nëse shkolla ka:
- Plane dhe dokumenta të cilat provojnë se janë identifikuar temat e përafërta në lëndë të ndryshme mësimore;
- Forma të integrimit lëndor si veprimtari kroskurrikulare, projekte që përfshijnë disa lëndë mësimore etj.

---

6.7 *Klasa e kompjuterve përdoret sipas lëndëve mësimore dhe klasave. (Për shkollat që e zotërojnë këtë teknologji).*
Treguesit pozitivë të punës së shkollës në këtë rast janë:
- Plani i punës për përdorimin e teknologjisë;
- Përdorimi i teknologjisë sipas karakteristikave të popullatës shkollore;
- Përdorimi i teknologjisë si mjet për ndryshimin e strategjisë së mësimdhënies;
- Koha në dispozicion të nxënësve për përdorimin e teknologjisë gjatë viteve të shkollimit.

---

***Norma:*** ***Karakteristika merr vlerësimin "Mirë – më shumë suksese se dobësi" nëse janë vlerësuar pozitivisht treguesit 6.2, 6.3, 6.4 dhe një nga treguesit e tjerë.***

## Karakteristika e cilësisë 7

## Shkolla siguron kohën e mjaftueshme për arsimimin e nxënësve.

Përdorimi efiçient i kohës së nevojshme për realizimin e programit mësimor luan rol të rëndësishëm në tre drejtime. Drejtimi i parë është planifikimi i mësimit dhe parandalimi i ndërprerjeve të mësimeve. Drejtimi i dytë është mësimi dhe përdorimi i kujdesshëm i kohës mësimore. Drejtimi i tretë është nxënësi, shpërndarja e drejtë e ngarkesës mësimore në mënyrë që ai të ndjek mësimet me dëshirë.

Secili program mësimor ka të përcaktuar numrin e orëve mësimore për realizimin e tij. Dispozitat Normative dhe një sërë udhëzimesh të MASH kanë përcaktuar normat e frekuentimit të mësimeve nga nxënësi, të cilat, nëse nuk respektohen, e përjashtojnë nxënësin nga vazhdimi i mëtejshëm i mësimit. Prandaj, shkolla ka përgjegjësinë e realizimit të programit mësimor në përputhje me aktet normative përkatëse (*Treguesi7.1*).

Shkolla duhet të sigurojë përdorimin efektiv të kohës mësimore të planifikuar nëpërmjet minimizimit të humbjes së orëve të mësimit, veçanërisht në fillim dhe në mbyllje të vitit shkollor, apo për shkak të kryerjes së provimeve (*indiaktori 7.2*). Po kështu, shkolla duhet të marrë masa për realizimin e programit mësimor në raste sëmundjesh (*Treguesi 7.3*).

Nga ana tjetër, shkolla nuk duhet të humbasë orë mësimore për shkak të problemeve organizative apo administrative që mund të ketë (*Treguesi 7.4*).

Shkolla duhet të përpiqet që koha mësimore të jetë e vlefshme për nxënësit. Kështu, ajo duhet të organizojë sa më mirë punën që bën nxënësi në shtëpi. Puna në shtëpi është pjesë e kohës mësimore, prandaj shkolla duhet të përpiqet që ajo të përdoret në mënyrën e duhur (*Treguesi 7.5*). Shkolla duhet të hartojë një politikë efektive për minimizimin e mungesave të nxënësve në mësime dhe humbjen e kohës së nevojshme për përvetësimin e programit mësimor (*Treguesi 7.6*).

Më poshtë janë paraqitur treguesit për vlerësimin e karakteristikës 7.

### Treguesit

*7.1* *Shkolla ka planifikuar realizimin e programit mësimor sipas kërkesave të udhëzimeve shtetërore.*

Burimi kryesor i vlerësimit të këtij treguesi janë udhëzimet dhe rregulloret shtetërore. Konkretisht, inspektimi kontrollon:

- Numrin e orëve mësimore të realizuara në raport me numrin e planifikuar në program;
- Numrin e mungesave të nxënësve në lëndë të veçanta dhe në të gjitha lëndët në raport me kërkesat e Dispozitave Normative për kufirin e pranueshëm të kalimit të klasës.

---

*7.2* *Shkolla punon për zvogëlimin më të mirë të mundshëm të humbjes së orëve mësimore.*

Inspektimi harton një tablo të plotë për:

- Orët mësimore të humbura në fillim të vitit shkollor;
- Orët mësimore të humbura në fund të vitit shkollor;
- Orët mësimore të humbura për shkak të testimeve, hartimeve, seminareve, provimeve, analizave etj.;
- Masat që ka marrë shkolla për parandalimin e humbjes së orëve mësimore.Treguesi vlerësohet negativisht nëse të gjitha orët e humbura janë ekuivalente me **10-12 ditë mësimore**.

7.3 *Shkolla di si të parandalojë humbjet e rastit të orëve mësimore.*

Ky tregues ka të bëjë me humbjen e orëve mësimore për shkak të sëmundjeve, pushimeve, pjesëmarrjes së mësuesve në trajnime apo seminare. Për vlerësimin e treguesit vëzhgohen:

- Politika e shkollës për parandalimin e humbjeve të këtij lloji;
- Programi i shkollës për zëvëndësimin e orëve të humbura;
- Angazhimi i nxënësve në punë të pavarura për plotësimin e boshllëqeve për shkak të orëve të humbura.

---

7.4 *Mësuesët përdorin plotësisht orën e mësimit.*

Vëzhgohet nëse koha e orës së mësimit humbet për shkak të:

- Përgatitjes së bazës materiale gjatë orës së mësimit dhe nxënësit presin mësuesin;
- Hyrjes vonë dhe daljes shpejt të mësuesit në klasë;
- Humbjes së kohës për shkak të lëvizjes së nxënësve nga një klasë në klasën tjetër.

---

7.5 *Shkolla ka një politikë që balancon ngarkesën mësimore të nxënësve në shtëpi dhe kohën e nevojshme për t'u përgatitur.*

Inspektimi vëzhgon:

- Masat që ka marr shkolla për shpërndarje të drejtë në kohë të ngarkesës sipas lëndëve mësimore;
- Sasinë e detyrave të shtëpisë që jepet nga lëndët e ndryshme mësimore;
- Testet me shkrim që organizohen nga lëndët e ndryshme mësimore;
- Konsultimet e organizuara për zvogëlimin e ngarkesës në shtëpi.

---

7.6 *Shkolla merr masa për zvogëlimin më të mirë të mundshëm të mungesave të nxënësve.*

Meqë mungesat janë një problem për shkollën, vëzhgohet puna që ajo bën për zvogëlimin e tyre. Konkretisht:

- Si dhe sa shpesh verifikohet prezenca e nxënësve në shkollë;
- Masat që merr shkolla për parandalimin e mungesave dhe masat që merren pas një mungese ose pas mungesave të përsëritura;
- Si komunikohet me prindërit për mungesat.

**Norma** ***Karakteristika merr vlerësimin "Mirë – më shumë suksese se dobësi" nëse janë vlerësuar pozitivisht Treguesit 7.1, 7.4, 7.6 dhe një nga Treguesit e tjerë.***

## Karakteristika e cilësisë 8

## Puna në klasë e mësuesve shërben si bazë për të krijuar një klimë mbështetëse dhe pune.

Puna në klasë e mësuesve varet shumë nga fakti nëse nxënësit ndjehen aty si në shtëpi. Që të arrihet një gjë e tillë, mësuesit duhet të përpiqen që nxënësi të ndjehet mire në klasë (*Treguesi 8.1*). Po kështu, kanë shumë rëndësi mënyrat e sjelljes së mësuesit me nxënësit (*Treguesi 8.2*). Parandalimi i diskriminimit është një aspekt tjetër i rëndësishëm i punës në klasë. Nxënësit duhet të pranohen ashtu si janë. Pra, krahas vemendjes që i duhet kushtuar karakterit të tyre të veçantë,

ata duhen trajtuar në mënyrë të njëjtë në procesin e vlerësimit të arritjeve si dhe në masat disiplinore që jepen në shkollë (*Treguesi 8.3*). Natyrisht, displina në klasë është një faktor shumë i rëndësishëm (*Treguesi 8.4*). Një klasë aktive kërkon zbatimin e rregullores së brendshme të shkollës, të rregullave dhe të kodit të sjelljes, tërheqjen e vemendjes nëse nxënësit shmangen nga rregullat e pranuara si dhe korrigjimin e të metave kur ato shfaqen.

Që klasa të ketë karakter nxitës duhet që mësuesi të tregojë besim në aftësitë e nxënësit (*Treguesi 8.5*), duke vendosur kërkesa reale ndaj përpjekjeve që ata bëjnë (*Treguesi 8.6*).

## Treguesit

*8.1* *Mësuesit janë të vemendshëm ndaj nxënësve.*

Inspektimi vëzhgon nëse mësuesit:
- I thërresin nxënësit me emër;
- Krijojnë kushtet që nxënësit të dëgjohen gjatë orës së mësimit;
- Dëgjojnë atë që thonë nxënësit;
- Respektojnë kontributin e tyre;
- Nuk bëjnë komente për pamjen apo karakterin e nxënësit;
- Shmangin të qënit cinik dhe sarkastik.

*8.2* *Mësuesit i nxitin nxënësit të respektojnë njeri tjetrin.*

Inspektimi vëzhgon nëse për mësuesët është e rëndësishme që:
- Nxënësit të respektojnë njeri tjetrin, pavarësisht nga dallimet nga kushtet sociale apo pikpamjet e tyre për jetën;
- Nxënësit të mësojnë të kontrollojnë sjelljen e tyre dhe të punojnë me njeri tjetrin sipas potencialit dhe mundësive që kanë;
- Të *nxitin* shpirtin e garës tek nxënësit;
- Të tregojnë kujdes të menjëhershëm për mungesat e nxënësve.

*8.3* *Mësuesit i trajtojnë nxënësit në mënyrë të barabartë.*

Inspektimi vëzhgon nëse mësuesit:
- Nuk bëjnë dallime të panevojshme midis nxësësve;
- Nuk tregojnë shenja antipatie ndaj disa nxënësve;
- Nuk tregojnë simpati ndaj disa nxënësve në mënyrë që nxënësit e tjerë të ndjehen të trajtuar negativisht;
- Përdorin të njëjtat kritere për vlerësimin e nxënësve.

*8.4* *Mësuesit krijojnë klimë të përshtatshme pune në klasë.*

Vrojtohen rregullat e sjelljes së mësuesit për mbajtjen e rregullit në klasë dhe për krijimin e një atmosfere pune.

*8.5* *Mësuesit tregojnë se presin rezultate të mira nga nxënësit.*

Vëzhgohet nëse mësuesit:
- Mbajnë qëndrim pozitiv ndaj pyetjeve, komenteve dhe përgjigjeve të nxënësve;
- Nuk bëjnë komente që dekurajojnë nxënësit;
- Mbajnë qëndrim pozitiv ndaj punëve që kryejnë nxënësit;
- Tregojnë vlerësim për përpjekjet dhe kontributet e nxënësve në mësim.

*8.6* *Mësuesit kanë kërkesa reale ndaj rezultateve të nxënësve.*
Vëzhgohet nëse mësuesit:
- Nxitin nxënësit për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota;
- Japin detyra me kërkesa reale (nxënësit i kryejnë me dëshirë ose nuk bëjnë shumë pyetje);
- U krijojnë nxënësve mundësi të reja për t'u përgjigjur dhe i lejojnë të korigjojnë gabimet që bëjnë;
- Japin detyra në përputhje me nivelin e nxënësve.

**Norma** ***Vlerësimi bëhet për çdo orë mësimi të vëzhguar: Jepet vlerësimi "Mirë – më shumë suksese se dobësi" nëse vlerësohen pozitivisht 4 nga 6 treguesit e mësipërm. Për shkollën në tërësi, vlerësimi konsiderohet i kënaqshëm nëse 75% e mësimeve vlerësohet "mire".***

## Karakteristika e cilësisë 9

## Strategjia mësimdhënëse e mësuesve shërben si bazë për të mësuarit me objektiva.

Mësuesi vazhdimisht duhet të dijë ta vlerësojë situatën që krijohet në klasë duke përdorur modele e strategji që i përshtaten më mirë asaj. Kjo veçori e kësaj karakteristike paraqitet me 3 grupet e mposhtme të treguesve:
1. Struktura dhe qartësia e mësimit (9.1 – 9.3);
2. Përshtatja e mësimit sipas ndryshimeve midis nxënësve (9.4 – 9.6);
3. Përdorimi i llojeve të ndryshme të strategjive të mësimdhënies (9.7).

Mësuesi duhet të përcaktojë se çfarë duhet të mësojnë nxënësit dhe si duhet ta mësojnë atë (*Treguesi 9.1*). Shpjegimi i mësimit dhe detyrat duhet të jenë të qarta, në mënyrë që të mundësojnë lidhjen midis njohurive ekzistuese dhe njohurive të reja që do t'i jepen nxënësit (*Treguesi 9.2*). Mësuesit duhet ta kontrollojnë orën e mësimit për të shmangur moskuptimin apo përvetësimin e gabuar të njohurive të reja (*Treguesi 9.3*). Nxënësit kanë mënyrat e tyre të mësuarit. Prandaj, mësuesit duhet të kenë parasysh grupin e nxënësve me të cilin punojnë si dhe dallimet individuale brenda grupit. Mësuesit duhet ta kenë si një princip kryesor njohjen dhe marrjen parasysh të mjedisit social në të cilin jetojnë nxënësit e tyre (*Treguesi 9.4*). Ata duhet të kenë parasysh edhe dallimet midis nxënësve të secilës klasë (*Treguesi 9.5*). Natyrisht, strategjitë e mësimdhënies janë një faktor i rëndësishëm (*Treguesi 9.6*).

### Treguesit

*9.1* *Mësuesit kanë ndërtuar mësime me strukturë të qartë.*
Inspektimi vëzhgon nëse mësuesit janë të qartë në atë që shpjegojnë, veçanërisht në fillim dhe në fund të mësimit, për të siguruar lidhjen me njohuritë e mëparshme dhe qëndrueshmërinë e tyre.

*9.2* *Mësuesit janë të qartë në shpjegimin dhe/ose në dhënien e detyrave.*
Inspektimi vëzhgon këto elementa:

- Shpjegimi gradual i mësimit.
- Përdorimi i pyetjeve dhe udhëzimeve të qarta për nxënësit;
- Shembuj të qartë dhe përdorim i materialeve illustrative;

---

*9.3* *Mësuesit kontrollojnë rregullisht nëse nxënësit kanë kuptuar lëndën mësimore dhe detyrat që jepen.*
Inspektimi vëzhgon në mësuesit:
- Bëjnë pyetje për të parë nëse është kuptuar mësimi;
- Lejojnë nxënësit të përgjithësojnë ose justifikojnë përgjigjet e tyre;
- Ofrojnë mbështetje aktive gjatë gjithë këtij procesi.

---

*9.4* *Mësuesit përshtatin metodën e tyre sipas mjedisit social në të cilin jetojnë nxënësit.*
Fjala është nëse mësuesi:
- Vepron sipas moshës, mjedisit, kulturës së nxënësve;
- Përdor shembuj që burojnë nga mjedisi social i nxënësve.

---

*9.5* *Gjatë mësimdhënies, mësuesit kanë parasysh nivelet e ndryshme ë nxënësve.*
Inspektimi vëzhgon nëse mësuesi:
- Kontrollon nxënësit e dobët për të parë nëse kanë kuptuar mësimin;
- Përqëndrohet dukshëm tek nxënësit e dobët dhe nxënësit e mirë (jo vetëm tek nxënësit mesatar) nëpërmjet detyrave apo materialeve suplementare;
- Organizon konsultime me nxënësit që nuk kanë kuptuar mësimin.

---

9.6 *Mësuesit përdorin lloje të ndryshme të metodave të mësimdhënies.*
Ky tregues ka lidhje me format e ndryshme të organizimit të mësimit të tilla si: forma klasike me mësuesin përballë klasës, të punuarit në grupe, të punuarit individual (nën drejtimin e mësuesit). Brenda këtyre formave organizative duhet të ketë varietet të arsyeshëm të metodave dhe aktiviteteve mësimore. Psh. në një situatë mësimore të formës klasike, mësimi nuk duhet të jetë një monolog i mësuesit por të ketë diskutime, paraqitje idesh etj.

---

**Norma** ***Secili mësim vlerësohet me notë pozitive nëse vlerësohen pozitivisht treguesit 9.1 – 9.6.Shkolla vlerësohet me notë pozitive nëse vlerësohen pozitivisht 75% e mësimeve si dhe treguesi 9.6***

---

## Karakteristika e cilësisë 10

## Mësuesit i nxitin nxënësit të marrin pjesë aktive në procesin e të nxënit.

Treguesit e kësaj karakteristike, me përjashtim të treguesit 10.1, ***nuk mund të vlerësohen për çdo situatë mësimore***. Por, ata duhet të jenë të dukshëm në një sërë situatash mësimore në nivel shkolle. Për këtë, inspektimi i kushton vemendje natyrës së klasave që vizitohen, përparimit të nxënësve nga viti i parë deri në vitin e fundit të ciklit / në fund të provimeve, karakteristikave të popullatës shkollore si dhe natyrës së orëve mësimore të vëzhguara.

Nëse duam që nxënësit të mësojnë, atëhere ata duhet të përfshihen aktivisht në situatat mësimore që krijohen në klasë (*Treguesi 10.1*).

*Treguesi 10.2* (nxënësit punojnë në grup dhe mbështetin njeri tjetrin gjatë të mësuarit) buron nga idea se puna në grup është shprehje e përfshirjes aktive në mësim. Prandaj, të mësuarit duke punuar në grup përfaqëson një objektiv të punës së mësuesit. Në këtë mënyrë, nxënësve, si individë, u krijohen mundësitë të përshtatin njohuritë e fituara, duke i përballur ato me interpretimet e këtyre njohurive nga ana e nxënësve të tjerë.

Rritja e përgjegjësisë personale të nxënësve gjatë procesit të mësuarit është shumë e rëndësishme. Në këtë kontekst, mësuesi duhet të jetë i vemëndshëm ndaj potencialit të nxënësit dhe fazës së zhvillimit që ai/ajo janë duke kaluar. Një kusht për t'i dhënë formë përgjegjësisë individuale të nxënësit është njohja e tyre për progresin në mësim (*Treguesi 10.3*), në mënyrë që t'u jepet përgjegjësia për të planifikuar (*Treguesi 10.4*) dhe mësuesit të inkurajojnë me ndërgjegje proceset e të menduarit për një stil individual të mësuari (*Treguesi 10.5*).

## Treguesit

10.1 *Mësuesit sigurojnë pjesëmarrje aktivie të nxënësve në mësim.*

Inspektorët vëzhgojnë nëse nxënësit:

- Bëjnë pyetje;
- Dëgjojnë mësuesin me vemendje;
- Bashkëveprojnë pozitivisht në kryerjen e detyrave.

Inspektorët vëzhgojnë nëse mësuesit nga ana e tyre:

- Krijojnë mundësi që të përgjigjen nxënës të ndryshëm.
- Formulojnë pyetje që nxitin të menduarit dhe pjesëmarrjen aktive të tyre në mësim.
- Krijojnë një klimë që nxënësit dhe mësuesi nuk gjykojnë negativisht mendimet e të tjerëve
- Kërkojnë ide dhe sugjerime nga grupe nxënësish.
- U kërkojnë nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve të shokëve të tyre.

Ky Tregues vlerësohet **negativisht** nëse mësuesi nuk është i suksesshëm në përfshirjen e shumicës së nxënësve në mësim.

Treguesi vlerësohet **pozitivisht** nëse nxënësit mund të vetpërfshihen në mësim pa ndonjë sforcim të mësuesit.

---

10.2 *Mësuesit i inkurajojnë nxënësit të punojnë në grup dhe të mbështetin njeri tjetrin gjatë të mësuarit.*

Ky tregues nuk mund të përdoret në ato situata mësimore, të cilat nuk kanë kushte fizike dhe kohore pë punë në grupe.

---

10.3 *Mësuesit i informojnë rregullisht nxënësit për progresin e tyre në mësim.*

Inspektorët vëzhgojnë nëse mësuesit u japin rregullisht informacion nxënësve për progresin dhe rezultatet e tyre, duke mos pritur rradhën (psh. pritjen e prindërve, fundin e semestrit/vitit shkollor). Konkretisht, informimi i rregullt i nxënësve realizohet me anë të:

- Testeve.
- Kontrollit të detyrave të shtëpisë.
- Korigjimit të shpejtë të detyrave të kontrollit dhe komunikimit të notave që janë marrë.

---

**Norma** ***<u>Vlerësimi bëhet për çdo mësim.</u> Vlerësimi pozitiv "Më shumë suksese se dobësi" jepet nëse treguesi 10.1 vlerësohet pozitivisht. <u>Shkolla</u> merr vlerësimin pozitiv "Më shumë suksese se dobësi" nëse 75% e mësimeve vlerësohet pozitivisht dhe ka tregues pozitivë për treguesit 10.1 – 10.3***

## 2.3 Kujdesi për nxënësit

Kujdesi për nxënësit lidhet me dy faktorë:

- Në progresin e nxënësit ndihmojnë vendosja e nxënësve në klasë, kalimi nga një klasë në tjetrën dhe këshillimi i tyre (karakteristika 11);
- Ndihma për të cilën kanë nevojë nxënës të veçantë mund të jepet nëse njihet dhe organizohet puna për dhënien e saj.

Shkolla duhet të marrë një sërë masash për vendosjen e nxënësve në klasë, kalimin nga një klasë në tjetrën dhe këshillimin e tyre. Në përgjithësi, puna fillon me regjistrimin e nxënësve në shkollë. Shkolla merr vendime për shpërndarjen e nxënësve në klasa, krijon mundësi që nxënësit të zgjedhin klasat, kurset, lëndët me zgjedhje apo edhe profilin (në shkollat e mesme). Transparenca e procedurave në këtë proces ka rëndësi të jashtëzakonshme sepse vendimet që merren kanë ndikim të madh tek e ardhmja e nxënësve. Në gjithë këtë proces, shkolla duhet të marr në konsideratë interesat e nxënësve dhe të prindërve të tyre.

Shpesh nxënësit mbeten prapa në mësime, psh. për shkak të vështirësive në të mësuar apo të problemeve të natyrës sociale e emotive. Shkolla duhet të ketë një sistem pune të përshtatshëm për trajtimin e këtij problemi.

Themelor në kujdesin ndaj nxënësve është identifikimi i problemeve në kohë dhe ndërtimi i një metodë pune të tillë, që i ndihmon nxënësit të vazhdojnë shkollën pa probleme. Inspektmi, nëpërmjet treguesit 11.2, vlerëson sistemin ose punën që bën shkolla për monitorimin e nxënësit. Ky sistem lejon marrjen dhe interpretimin e sinjaleve që vijnë nga mësuesit dhe nxënësit.

### Karakteristika e cilësisë 11

### Shkolla ka organizuar në mënyrë të përshtatshme ndarjen e nxënësve në klasa, kalimin nga një klasë në tjetrën dhe këshillimin e tyre.

Karriera e nxënësve fillon me regjistrimin e nxënësit shkollë dhe me kalimin e tij nga një klasë në tjetrën. Shkolla duhet të sigurojë një fillim të mbarë të shkollës nga ana e nxënësit. Ajo nuk duhet të jetë shumë e ngurtë ndaj potencialit të nxënësit gjatë kalimit të tij nga një klasë në tjetrën (*Treguesi 11.1*). Prandaj, shkolla duhet t'i kushtojë vemendje të veçantë rregullave për formimin e klasave si dhe sqarimit të nxënësit dhe prindit për zgjidhjen që ka bërë.

Vendimet e shkollës lidhur me përparimin e nxënësve duhet të bëhen mbi bazën e informacionit për rezultatet e tyre. Një gjë e tillë arrihet nëse shkolla ka një sistem të përshtatshëm pune për njohjen dhe regjistrimin e rezultateve të nxënësve (*Treguesi 11.2*). Ky sistem pune përmban rezultatet më të rëndësishme të të gjithë nxënësve. Shkolla i freskon këto të dhëna në mënyrë sistematike, i përdor si burim për analiza e përgjithësime dhe lejon përdorimin e tij nga palët e interesuara.

Nxënësit dhe prindët duhet të informohen sistematikisht për përparimin në mësime si dhe për problemet që kanë lidhje me të (*Treguesi 11.3*). Pra, ata duhet të ndjehen si palë që vlerësohet seriozisht nga shkolla. Burimet më të mira që përdor inspektimi në këtë fushë janë raportet, takimet dhe analizat që ka kryer shkolla me prindët. Është mirë që këta të informohen sa herë ka probleme. Pra, shkolla duhet të krijojë bindjen se mësuesit e dinë kur duhen informuar prindërit dhe këta të

fundit e dinë se shkolla do t'i informojë në kohën e duhur (*Treguesi 11.3*).

Përparimi i nxënësve në shkollë varet nga nxitja e tyre për të kaluar klasën. Veçanërisht, në përfundim të shkollës 9vjeçare dhe asaj të mesme, shkolla duhet të jetë e aftë të bëjë rekomandimet e duhura për shkollimin e mëtejshëm të nxënësve të saj. Shkolla, duke ofruar hollësi për potencialin e nxënësve, mund t'i ndihmojë ata dhe prindërit e tyre për të marrë vendime sa më të drejta (*Treguesi 11.4*).

Në rastin e shkollave me disa profile, zgjedhja e profilit nga ana e nxënësit përbën një vendim shumë të rëndësishëm, marrja e të cilit duhet marrë në konsultim me palët e interesuara (*Treguesi 11.5*). Natyrisht, nxënësit dhe prindërit nuk mund të jenë të ndërgjegjshëm për pasojat e këtij vendimi. Prandaj, shkollat duhet të kenë informacionin e duhur për kategoritë e shkollave apo të kërkesave tëe tregut të punës etj. ku mund të drejtohen nxënësit e saj (*Treguesi 11.6*).

## Treguesit

11.1 *Shkolla mbështetet në potencialin e nxënësve gjatë formimit të klasave.*

Inspektimi vëzhgon nëse:

- Shkolla është mbështetur në rezultatet e nxënësve në klasën e mëparshme/ provimeve për ndarjen e tyre në klasa.
- Shkolla ka dhe është mbështetur në rekomandimet e cikleve apo shkollave nga kanë ardhur nxënësit e saj.
- Shkolla njeh dhe merr parasysh preferencat e nxënësve dhe të prindërve për për ndarjen e tyre në klasa.
- Nxënësit dhe prindërit njohin rregullat që janë zbatuar për formimin e klasave.

11.2 *Shkolla ndjek në mënyrë sistematike përparimin në mësime dhe formimin e nxënësve.*

Inspektimi vëzhgon nëse:

- Mësuesit i ndjekin rezultatet e nxënësve nëpërmjet vlerësimeve të rregullta me gojë dhe me shkrim.
- Ka një sistem regjistrimi të përparimit të të gjithë nxënësve, i cili është transparent dhe i përshtatshëm për analizën e problemeve të përparimit.

11.3 *Nxënësit dhe prindërit marrin informacion të rregullt për progresin e nxënësve.*

Inspektimi vëzhgon:

- Informacionin e ofruar nga shkolla në raportimet dhe takimet me prindërit.
- Njohjen e prindit me rënien në mësime të fëmijës së tij.
- Njohjen e prindit me mundësinë e ngeljes së fëmijës së tij në klasë.

11.4 *Rregullat e kalimit të klasës dhe udhëzimet për klasat e mëtejshme janë të organizuara dhe prindërit e nxënësit janë të ndërgjegjshëm për to.*

Inspektimi vëzhgon nëse shkolla ka të afishuara rregulloret përkatëse, të cilat njihen nga nxënësit dhe prindërit.

11.5 *Shkolla përfshin nxënësit dhe prindërit në vendimet që kanë lidhje me lëvizjen e nxënësve nga klasa në klasë.*

Inspektimi vëzhgon nëse:

- Shkolla ka një proces konsultimi cilësor.
- Mësuesit kanë informacionin e nevojshëm për të diskutuar zgjedhjen e klasës/

profilit/kursit në shkollë.
- Shkolla ka procedura për zgjidhjen e ankesave të nxënësve dhe prindërve për regjistrimin e nxënësve në këtë apo atë klasë/profil/kurs.
- Nxënëst janë pjesë e konsultimeve nëpërmjet Qeverisë së nxënësve.

11.6 *Shkolla konsulton nxënësit dhe prindërit lidhur me llojin e shkollës që mund të ndjekin dhe rrugët për kalim në tregun e punës.*

Inspektimi vëzhgon nëse shkolla ka:
- Material këshillimor për kurse / profile / shkolla që mund t'u ofrohen nxënësve dhe prindërve.
- Material për interesat që kanë nxënësit për shkollim / punësim.

***Norma*** ***Vlerësimi "Mirë" jepet nëse të gjashtë treguesit marrin vlerësim pozitiv.***

## Karakteristika e cilësisë 11

## Shkolla ofron këshilla specifike për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje speciale.

Disa nxënës kanë nevojë për një mbështetje më të madhe për ta mbaruar shkollën me sukses. Pra, shkolla duhet të ketë një sistem, i cili e lejon të identifikojë në kohë nxënësit që kanë nevojë për këtë ndihmë plotësuese (*Treguesi 12.1*).

Njohja e nevojës që ata kanë është vetëm hapi i parë. Shkolla duhet të qartësojë natyrën e problemit që ka ky apo ai nxënës në mënyrë që të dihet si të veprohet më tej (*Treguesi 12.2*). Ndihma duhet të jetë e pasqyruar në një plan pune me objektiva dhe burimet e nevojshme për realizimin e tyre (*Treguesi 12.3*).

Ndërkaq, shkolla duhet të mbajë lidhje me institucione të specializuara, psikologë, punonjës socialë, mjekun e shkollës etj., të cilët janë burime të ndihmës së kualifikuar në këtë fushë (*Treguesi 12.4*). Natyrisht, për shumicën e shkollave, kjo mbështetje nuk është e mundur. Prandaj, shkolla duhet të ketë të qartë kufirin deri tek i cili stafi i saj mund të ofrojë ndihmën plotësuese.

Shkolla duhet të kontrollojë efektivitetin e mbështetjes së ofruar (*Treguesi 12.5*) nëpërmjet rezultateve të kësaj kategorie nxënësish në procesin mësimor (*Treguesi 12.6*).

### Treguesit

12.1 *Shkolla ka një sistem pune për evidentimin e nevojave speciale të nxënësve.*

Inspektimi vëzhgon nëse në shkollë:
- Janë identifikuar fëmijët me nevoja speciale.
- Të gjithë nxënësit testohen me kujdes në njohuritë bazë të lëndëve mësimore.
- Kryhet evidentimi sistematik i të dhënave që kanë mësuesi i lëndës, mësuesi kujdestar dhe drejtoria e shkollës në dokumentat për secilin nxënës.
- Ka një sistem pune të mësuesve të lëndës/kujdestarë për njohjen e problemeve të nxënësve.
- Kryhen analiza të rregullta të përparimit të nxënësve sipas problemeve që shfaqen.

12.2 *Shkolla ka analizuar nevojat e nxënësve me nevoja speciale sa herë që ka qenë e nevojshme.*
Inspektimi vëzhgon nëse:

- Përparimi dhe formimi i nxënësve me nevoja speciale diskutohet në mënyrë sistematike.
  Analiza shoqërohet me:
  - Një material ku përshkruhet data e evidentimit dhe e përshkrimit të problemit.- Konsultimet midis mësuesve të lëndëve mësimore.
  - Zhvillimin e testeve diagnostikues, të dhëna nga prindërit dhe, nëse është e mundur, nga ekspertë të jashtëm.

---

12.3 *Shkolla kryen mbështetjen e saj sipas një plani pune.*
Inspektim vëzhgon nëse:

- Plani i shkollës përmban: qëllimin, burimet njerëzore, materiale etj. si dhe afatet.
- Plani njihet nga prindërit.
- Plani freskohet duke ndjekur ndryshimet e nxënësve dhe shërben si udhëzim për konsultimin e tyre.

---

12.4 *Shkolla, sipas mundësive që ka, organizon konsulta specifike me nxënësit.*
Fjala është për punonjësin social, procedurat, pajisjet (një qendër burimore ose programe kompjuteristike specifike), që mund të jenë në shkollë.Në çdo rast, shkolla duhet të ketë qartë kufirin midis asistencës që ajo mund të ofrojë dhe ndihmës së specializuar.

---

12.5 *Mësuesit bashkëpunojnë me punonjësit social (nëse shkolla ka të tillë) gjatë konsultimit të nxënësve me nevoja speciale.*
Për përfshirjen e të gjithë nxënësit me nevoja speciale në procesin e arsimimit inspektimi vëzhgon:

- Bashkëpunim midis mësuesve dhe këshilluesve.
- Shkëmbim informacioni midis tyre.
- Marrëveshje të shkruara midis mësuesve dhe punonjësit social.

**Norma** ***Vlerësimi "mirë" merret nëse dy nga treguesit 12.1, 12.4 ose 12.5 dhe një nga treguesit e tjerë marrin vlerësim pozitiv.***

## 2.4 Rezultatet e nxënësve

Kjo fushë shërben për vlerësimin e rezultateve të shkollës në bazë të rezultateve dhe kalueshmërisë së popullatës shkollore si e tërë. Por, vlerësimi i rezultateve të nxënësve ka lidhje me tre probleme të rëndësishëm: *efektivitetin*, *nivelin e rezultateve* dhe *efiçiencën*. Për kalueshmërinë e nxënësve të veçantë shërben karakteristika 11.

*Efektiviteti* ka të bëjë me njohuritë, dijet dhe shprehitë që kanë fituar nxënësit. Në këtë rast, inspektimi i kushton vemendje kryesisht kontributit që jep shkolla për arritjen e rezultateve, pra, vlerës që ajo shton në formimin e nxënësve. Kjo është arsyeja përse merren parasysh karakteristikat e grupit të nxënësve si i tërë.

*Niveli i rezultateve* është niveli që arrijnë nxënësit nga pikpamja e përfundimit të shkollës. Në këtë rast, rezultatet e nxënësve në ciklin paraardhës përbëjnë një bazë të mirë për të përcaktuar

nivelin fillestar të grupit të nxënësve si i tërë. Këto rezultate duhen krahasuar me numrin e nxënësve që kanë përfunduar shkollën. Por, niveli i rezultateve mund të përcaktohet edhe brenda një cikli nëpërmjet rezultateve që kanë arritur nxënësit në klasën ku janë, krahasuar me rezultatet në klasën e mëparshme. Shpesh, inspektimi krahason nivelin e rezultateve të një klase në momentin e inspektimit me ato të semestrit të mëparshëm.

*Efiçienca* ka lidhje me kohën që u duhet nxënësve të përfundojnë një nivel të caktuar shkollimi. Fjala është për nxënësit mbetës. Nxënësit mbetës ulin efiçiencën e shkollës.

## Karakteristika e cilësisë 13

## Nxënësit, mbështetur në potencialin e tyre, arrijnë rezultatet që priten.

*Niveli i rezultateve* në shkollën 9vjeçare tregon numrin e nxënësve që kanë mbaruar ciklin fillor dhe kanë arritur në klasën e nëntë. Sa më i madh të jetë ky numër aq më i madh është niveli i rezultateve. Për shkollën e mesme, *niveli i nxënësve* tregon numrin e nxënësve që kanë filluar klasën e parë dhe kanë arritur në klasën e fundit (*Treguesi 13.1*).

*Efiçienca* ka të bëjë me parandalimin e nxënësve përsëritës (*Treguesi 13.2*). Ajo matet me numrin e nxënësve që kalojnë nga shkolla fillore në klasën e nëntë dhe numrin të nxënësve të klasës së nëntë që marrin deftesën e lirimit. Për shkollën e mesme, matet me numrin e nxënësve që kalojnë nga klasa e parë në klasën e fundit dhe numrin e nxënësve që marrin deftesën e pjekurisë.

*Efektiviteti* i shkollës vlerësohet me anë të notave që kanë marrë nxënësit në provimet e lirimit/shtetit (Treguesi 13.3), sepse provimet përfaqësojnë të njëjtat standarde për të gjithë nxënësit. Shpesh, inspektimi krahason notat që marrin nxënësit në momentin e inspektimit me vlerësimin që ka bërë mësuesi ose me perfundimet e semestrit të mëparshëm.

Në raportin e inspektimit këta tre treguesë trajtohen bashkë.

### Treguesit

13.1 *Pas 3 vjetësh, nxënësit janë në klasën që i korespondon rezultateve të ciklit/klasës paraardhëse.*

- Ky tregues vlerësohet në bazë të rezultateve të nxënësve në tre klasat e para të ciklit të lartë të shkollës 9vjeçare/të mesme.

13.2 *Nxënësit përparojnë pa mbetur në klasë.*

- Ky tregues vlerësohet për secilën klasë në bazë të numrit të nxënësve që kalojnë nga shkolla fillore në klasën e nëntë dhe numrit të nxënësve të klasës së nëntë që marrin deftesën e lirimit.
- Për shkollën e mesme vlerësohet në bazë të numrit të nxënësve që kalojnë nga klasa e parë e shkollës së mesme në klasën e katërt dhe numrin e nxënësve të klasës së katërt që marrin dëftesën e lirimit. Treguesi i dytë ka peshë më të madhe në nivelin e rezultateve të shkollës.

13.3 *Nxënësit marrin në provim notat që priten prej tyre.*

- Ky Tregues vlerësohet për secilën klasë dhe për të gjithë provimet, duke u krahasuar me notat mesatare të nxënësve të marra gjatë vitit shkollor.

| | |
|---|---|
| **Norma 13.1** | ***Për të marr vlerësimin "Mirë – më shumë suksese se dobësi", rezultatet e nxënësve që përcakton treguesi 13.1 duhet të jetë sa niveli mesatar ose më i lartë se niveli mesatar i tre viteve të fundit.*** |
| **Norma 13.2** | ***Vlerësohet çdo klasë: Për të marr vlerësimin "Mirë – më shumë suksese se dobësi", kalimet nga një cikël në tjetrin shoqërohen me një nivel mesatar ose më të lartë se niveli mesatar i tre viteve të fundit.*** |
| **Norma 13.3** | ***Vlerësohet çdo klasë: Për të marr vlerësimin "Mirë – më shumë suksese se dobësi", nota mesatare në provime duhet të jetë sa nota mesatare e dy viteve të fundit ose më e lartë.*** |

# 3. SHTOJCAT

Në këtë pjesë janë përfshirë disa nga formatet që përdor inspektim në faza të ndryshme të procesit të inspektimit të shkollës. Këto formate mund t'i grupojmë në disa grupe.

1. Shtojca A paraqet strukturën e plotë të Tablosë së Vlerësimit. Në këtë mënyrë, krijohet një përfytyrim më konkret i fushave, karakteristikave, treguesëve dhe normave përkatëse të vlerësimit.
2. Formatet 1 – 2 përdoren para fillimit të procesit të inspektimit për grumbullimin e të dhënave për gjendjen bazë të shkollës. Ato i nënështrohen një analize të hollësishme nga grupi i inspektorëve që do të vlerësojë shkollën.
3. Inspektimi i kushton kujdes të veçantë vëzhgimit të punës së gjallë të mësuesit në orën e mësimit. Inspektimi përdor formatin përkatës. Duke vështruar çështjet që përmban ky format, mund të krijohet përshtypja sikur inspektori nuk vlerëson gjithanshmërinë e veprimtarisë së mësuesit gjatë zhvillimit të orës së mësimit. Përvoja tregon se ndjekja e një numri më të madh aspektesh që karakterizojnë këtë veprimtari të mësuesit ëstë mjaft i vështrë dhe do të shoqërohej me pasaktësi. Sidoqoftë, formati, ashtu si dhe Manuali, është i hapur për ndryshime dhe përmirësime.
4. Grupi i tretë përfshin disa nga platformat e inspektimit të përdorura nga Drejtoria e Inspektimit të MASh-it gjatë inspektimeve të kryera në periudhën shkurt-prill 2004. E përbashkët për këto platforma është se ato kanë buruar nga Tabloja e Vlerësimit. Me anë ta pasqyrimit të tyre në këtë botim konkretizohen dy ide: (i) evoluimi i përmbajtjes së tyre dhe (ii) përdorimi i tyre nga ana e sektorëve të inspektimit të DAR-ve si modele të ndërtimit të platformave të inspektimeve që ato do të kryejnë.

Së fundi, theksojmë se Tabloja e Vlerësimit mund dhe duhet të përdoret edhe nga vetë shkollat gjatë organizimit të vlerësimit të tyre të brendshëm për dy arësye:

- Tashmë shkolla e di se si dhe çfarë vlerëson inspektimi;
- Nëse inspektimi e gjen të vlefshëm vlerësimin e brendshëm të shkollës, ai e pajtohet me gjetjet dhe detyrat e këtij vlerësimi duke e ndërprerë procesin inspektues. Fjala është për atë që quhet *metavlerësim*, i praktikuar për herë të parë gjatë inspektimit të ZA Krujë.

| TABLOJA E PËRMIRËSUAR E VLERESIMIT | |
|---|---|
| **FUSHAT** | **KARAKTERISTIKAT E CILËSISË DHE TREGUESIT** |
| **A**<br><br>**MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI I SHKOLLËS** | **KARAKTERISTIKA 1**<br>**Monitorimi i cilësisë së shkollimit dhe masat për ruajtjen dhe përmirësimin e saj.** |
| | 1.1 Shkolla analizon sistematikisht cilësinë e shkollimit që është duke ofruar. |
| | 1.2 Shkolla ka pasqyruar ndryshimet e dokumentacionit shtetëror në planin e saj të punës. |
| | 1.3 Shkolla funksionon në përputhje me zhvillimin e zonës ku ndodhet dhe e pasqyron atë në planin e saj të punës. |
| | 1.4 Shkolla ka organizuar kontrolle sistematike për të parë efektin e masave të marra për përmirësimin e punës së saj. |
| | **NORMA: Vlerësimi "Mirë" kur janë vlerësuar "Mirë" të gjithë treguesit.** |
| | **KARAKTERISTIKA 2**<br>**Procesi mësimor dhe zhvillimi i punës në grup synojnë përmirësimin e shkollimit.** |
| | 2.1 Drejtoria kujdeset për bashkërendimin e aspekteve të ndryshme të punës së shkollës. |
| | 2.2 Drejtoria kujdeset për përfshirjen e departamenteve lëndore, mësuesve kujdestarë etj në hartimin dhe zbatimin e politikës së shkollës. |
| | 2.3 Stafi ka mbështetjen e mjaftueshme të drejtorisë për realizimin e planit të zhvillimit të shkollës. |
| | 2.4 Drejtoria nxit punën në grup gjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të planit të punës së shkollës. |
| | 2.5 Shkolla kujdeset që kualifikimi i brendshëm të nxit rritjen e profesionalizmit të antarëve të stafit të shkollës. |
| | 2.6 Shkolla siguron mbështetjen dhe udhëheqjen e mësuesve të rinj. |
| | **NORMA: Vlerësimi "Mirë" kur janë vlerësuar "Mirë" treguesit 2.1, 2.3 dhe dy treguesë të tjerë.** |
| | **KARAKTERISTIKA 3**<br>**Shkolla përdor me efektivitet stafin dhe burimet materiale.** |
| | 3.1 Shkolla siguron një ritm normal të aktiviteti mësimor ditor. |
| | 3.2 Shkolla merr masa për parandalimin e humbjeve të orëve të mësimit nëpërmjet plotësimit në kohë të mungesave të stafit mësimor në organikë. |

| | |
|---|---|
| | 3.3 Klasat janë të përshtatshme për mësim. |
| | 3.4 Shkolla ka pajisje mësimore të mjaftueshme dhe ato përdoren në mënyrën e duhur. |
| | 3.5 Shkolla ka sallë mësuesësh dhe mjedise të tjera pune për mësuesit dhe stafin ndihmës, të pajisura në mënyrë të përshtatshme. |
| | 3.6 Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit ndihmon në realizimin e objektivave të rezultateve, kërkesave të provimeve dhe metodave të mësimdhënies. |
| | **NORMA: Vlerësimi "Mirë" kur janë vlerësuar "Mirë" treguesit 3.1, 3.4 dhe dy nga treguesit e tjerë.** |
| | **KARAKTERISTIKA 4**<br>**Shkolla siguron një klimë shkollore të sigurtë dhe motivuese.** |
| | 4.1 Ka një klimë bashkëveprimi midis antarëve të stafit dhe nxënësve të shkollës. |
| | 4.2 Nxënësit vlerësojnë atë që u ofron shkolla. |
| | 4.3 Shkolla kujdeset dhe përgatit një mjedis mikpritës për nxënësit. |
| | 4.4 Shkolla organizon veprimtari për rritjen e përfshirjes së nxënësve në shkollë. |
| | 4.5 Shkolla merr masa që nxënësit të jenë të sigurtë. |
| | 4.6 Shkolla ka një rregullore të qartë të sjelljes dhe disiplinës. |
| | 4.7 Stafi zbaton rregullat e sjelljes në mënyrë të ndërgjegjshme. |
| | **NORMA: Vlerësimi "Mirë" kur janë vlerësuar "Mirë" pesë nga shtatë treguesë.** |
| | **KARAKTERISTIKA 5**<br>**Shkolla ruan kontakte të jashtme funksionale.** |
| | 5.1 Shkolla ruan kontakte me shkollat nga vijnë nxënësit për zbutjen e problemeve të kalimit të tyre nga një shkollë në tjetrën. |
| | 5.2 Shkolla mban kontakte me shkollat ku shkojnë nxënësit e saj për t'i këshilluar dhe për të zbutur kalimin e tyre në to. |
| | 5.3 Prindërit janë të informuar në mënyrë të qartë për shkollën dhe zhvillimet e saj. |
| | 5.4 Shkolla mban kontakte me institucionet që ofrojnë vende pune për të inkurajuar një orientim të përshtatshëm të nxënësve në tregun e punës (për shkollat profesionale). |
| | 5.5 Shkolla mban kontakte me pushtetin vendor për të përmirësuar cilësinë e edukimit. |
| | 5.6 Shkolla merr pjesë në forma të ndryshme kooperimesh. |
| | **NORMA: Vlerësimi "Mirë" kur janë vlerësuar "Mirë" treguesit 5.2, 5.3 dhe dy treguesë të tjerë.** |

| | |
|---|---|
| **B**<br><br>**PROCESI I MËSIMDHËNIES DHE TË NXËNIT** | **KARAKTERISTIKA 6**<br>**Shkolla ofron garanci për arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të provimeve.** |
| | 6.1 Shkolla ofron garanci për realizimin e programi të lëndëve mësimore. |
| | 6.2 Shkolla ofron garanci për realizimin e programi të lëndëve mësimore që shoqërohen me provime. |
| | 6.3 Shkolla ofron garanci se provimet e lirimit / pjekurisë zhvillohen me cilësi të mjaftueshme. |
| | 6.4 Nxënësit fitojnë shprehi të përgjithshme gjatë realizimit të proramit të të gjitha lëndëve mësimore. |
*Inspektimi i plotë i shkollës mund të përkufizohet si vlerësim i veprimtarisë së shkollës në përputhje me kërkesat e ligjit. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet grumbullimit sistematik të informacionit me synimin për të realizuar një vlerësim sistematik të ciklit fillor të shkollës dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimit arsimor në këtë cikël.*

## Inspektimi i plotë synon të arrijë dy objektiva:

- *Të kontrollohet nëse shërbimi arsimor në ciklin fillor zhvillohet në përputhje me ligjet. Në këtë kontekst, Inspektoriati kërkon që shkolla të bëjë një prezantim të vetvetes dhe të cilësive të saj, të cilin ai e përdor si bazë për vlerësimin e cilësisë së ofruar nga shkolla. Vlerësimi kryhet në bazë të standardeve të paraqitur në kapitullin 3. Në këtë mënyrë, inspektoriati identifikon pikat e forta dhe problemet e arsimimit në shkollë, të cilat diskutohen me të për mundësitë dhe planin e përmirësimit të mëtejshëm.*

- *Nëpërmjet analizave të gjetjeve në të gjitha shkollat e inspektuara krijon mundësinë që çdo vit të hartohet një tablo e përgjithshme për cilësinë e shërbimit arsimor në ciklin fillor dhe të raportohet te Ministri.*

## 1.1 Shkolla e mirë

Inspektoriati ka përcaktuar karakteristikat e cilësisë së shkollës, të cilat pasqyrojnë kërkesat e ligjit ndaj shërbimit arsimor. Në disa raste ligji është i qartë dhe nuk është vështirë për të përcaktuar, nëse shkolla vepron në përputhje me kërkesat e tij. Në raste të tjera, ligji tregon vetëm drejtimin, i cili ka nevojë për më shumë interpretim në praktikë. Pikërisht këto janë rastet, kur inspektoriati përdor karakteristikat e cilësisë së shkollës për vlerësimin e saj.

Në rastin më të përgjithshëm, një shkollë e mirë e ciklit fillor është ajo ku mësuesit realizojnë *mësim të mirë në kushte të favorshme shkollore, në mënyrë që të gjithë nxënësit të arijnë rezultate optimale.*

Por, sa e mirë është cilësia e shërbimit që ofron një shkollë? Ajo provohet në rradhë të parë me anë të cilësisë së **procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit** në lidhje me rezultatet e nxënësve gjatë vitit shkollor dhe në fund të tij. Por realizimi dhe përmirësimi i procesit mësimor dhe i të nxënit kërkon që shkolla të sigurojë **kushte shkollore** të përshtatshme.

Procesi i mësimdhënies dhe i të nxënit përcaktohet nga kurrikula shkollore, koha mësimore, klima e shkollës, strategjitë mësimdhënëse të mësuesve dhe sistemi i monitorimit të nxënësve. Nuk po ndalemi në përshkrimin e këtyre veçorive, sepse ato janë trajtuar hollësisht në Manualin e

Inspektimit. Shkurt, theksojmë se pjesë e profilit të një shkolle të mirë janë kushtet e shkollës, konteksti i saj, kualifikimi i stafit, përdorimi i burimeve njerëzore, materiale, financiare etj., si dhe administrimi i saj.

Standardet e paraqitura në këtë Manual synojnë vlerësimin e ciklit fillor të shkollave individuale dhe të stafit të tyre. Ato i referohen aspekteve kryesore të cilësisë sipas viteve të shkollimit. Kjo nënkupton se për shkollat e inspektuara është hartuar një tablo e aspekteve të suksesshme dhe të dobta që ato kanë, pra një profil të cilësisë së tyre. Nga ana tjetër, këto standarde shërbejnë për nxitjen e shkollës për të reflektuar dhe vendosur objektivat e nevojshëm për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofrojnë.

# 2. STANDARDET E INSPEKTIMIT TË CIKLIT FILLOR

Në kontekstin e inspektimit të plotë, inspektoriati vlerëson shkallën e:

1. *Cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe të nxënit;*
2. *Rezultateve të nxënësve;*
3. *Kushteve shkollore për të siguruar cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit dhe për arritjen e rezultateve të mjaftueshme.*

Ky kapitull përshkruan standardet që përdoren nga inspektoriati gjatë inspektimit të plotë të ciklit fillor.

## A PROCESI I MËSIMDHËNIES DHE I TË NXËNIT

### A.1 Kurrikula

**Standardi**: *Kurrikula është zbatuar në përputhje me aktet ligjore/nënligjore.*

Inspektoriati kontrollon nëse metodat e mësimdhënies që përdoren në shkollë janë në shërbim të standardeve të përmbajtjes së saj. Theksi vihet në gjuhë, lexim dhe matematikë. Në rastin e lëndëve të tjera inspektoriati kontrollon nëse shkolla ofron veprimtari që kanë synim zhvillimin social dhe emocional të nxënësve të saj.

Inspektoriati kontrollon, nëse kurrikula shkollore zbatohet në përputhje me karakteristikat e popullatës shkollore dhe nëse merren parasysh diferencat midis nxënësve.

Inspektoriati e vlerëson cilësinë e kurrikulës me anë të këtyre treguesve:

1. Janë arritur standardet e përmbajtjes për secilën lëndë mësimore.
2. Ka dhe janë realizuar objektivat kros-kurrikulare.
3. Kurrikula zbatohet në përputhje me nevojat mësimore, aftësitë dhe kulturën e nxënësve.
4. Zbatimi i kurrikulës merr parasysh diferencat midis nxënësve.
5. Zbatimi i kurrikulës bëhet në përputhje me metodat bashkëkohore të mësimdhënies.

### A.2 Koha mësimore

**Standardi:** *Nxënësit kanë kohën e mjaftueshme për të zotëruar lëndën mësimore.*

Inspektoriati kontrollon realizimin e programit mësimor. Vëzhgohet nëse shkolla ka marrë masa për parandalimin e humbjeve të orëve të mësimit.

Inspektoriati e vlerëson cilësinë e kohës mësimore mbi bazën e treguesve që vijojnë:
1. Shkolla ka planifikuar realizimin sasior të programit mësimor.
2. Shkolla synon të parandalojë humbjet e orëve të mësimit.
3. Shkolla kujdeset që realizimi i programit të gjuhës shqipe dhe të matematikës të kryhet në përputhje me nevojat mësimore të popullatës shkollore.
4. Mësuesit realizojnë kohën e planifikuar mësimore.
5. Mësuesit e përdorin kohën e mësimit në varësi të nevojave mësimore të nxënësve.

## A.3 Klima e shkollës

**Standardi:** *Mësuesit u krijojnë nxënësve një klimë shkollore nxitëse dhe motivuese.*

Shkolla që kujdeset për klimë të mirë shkollore karakterizohet nga një ekuilibër midis mbështetjes dhe nxitjes. Mbështetja nënkupton krijimin e një mjedisi të sigurtë brenda dhe jashtë klasave. Mësuesit tregojnë respekt ndaj nxënësve dhe nuk merren me dallimet individuale të nxënësve. Ata kujdesen që nxënësit të kuptojnë vlerën e respektit reciprok dhe i mbështetin duke e vënë theksin në sjelljet pozitive. Po kështu, mësuesit kujdesen që klasat të jenë të rregullta e të pastra dhe në përputhje me rregullat dhe kërkesat e punës së nxënësve si grup.

Mësuesit i nxitin nxënësit të ndërmarrin veprimtari gjatë mësimit dhe të marrin përgjegjësi duke i përfshirë në proceset që ndodhin në klasë.

Inspektoriati e vlerëson cilësinë e klimës së shkollës me këta tregues:
1. Mësuesit sigurojnë një mjedis të nxëni të sigurtë dhe funksional.
2. Me sjelljen e tyre dhe gjuhën që përdorin, mësuesit tregojnë respekt për nxënësit.
3. Mësuesit nxitin respektin reciprok midis nxënësve.
4. Mësuesit mbështetin vetbesimin e nxënësve.
5. Shkolla ka një rregullore të qartë të disiplinës.
6. Mësuesit krijojnë në klasë një mjedis nxitës.
7. Mësuesit i nxitin nxënësit të jenë të pavarur dhe të marrin përgjegjësi.

## A.4 Strategjia e mësimdhënies

**Standardi:** *Mësuesit shpjegojnë në mënyrë efiçiente.*

Në këtë rast, inspektoriati kontrollon shkallën e efektivitetit të veprimeve të mësuesit në klasë. Konkretisht, shihet qartësia dhe struktura e procesit mësimor, referimi tek njohuritë e mëparshme, shpjegimi hap pas hapi i mësimit, verifikimi nëse mësimi është kuptuar nga nxënësit, qartësia e detyrave të shtëpisë, diskutimi dhe kontrolli i tyre, nxitja e nxënësve për pjesëmarrje aktive në mësim, lidhja e mësimit me mjedisin e nxënësve, mbështetja e veprimtarive që ndërmarrin nxënësit. Po kështu, inspektimi vëzhgon përshtatjen e strategjive të mësimdhënies me karakteristikat e nxënësve dhe dhënien e detyrave sipas nivelit të nxënësve. Së fundi, inspektimi shikon mënyrën se si mësuesi menaxhon klasën.

Treguesit që përdoren nga inspektoriati për vlerësimin e cilësisë së strategjisë së mësimdhënies janë ndarë në pesë grupe:

**I Procesi mësimor ështe i qartë dhe me strukturë të mirë:**

1 Mësimet kanë strukturë të qartë.
2 Mësuesit bëjnë shpjegim të qartë të mësimit dhe të detyrave.
3 Mësuesit kontrollojnë rregullisht, nëse nxënësit kanë kuptuar mësimin dhe detyrat.

**II Mësuesit i përfshijnë aktivisht nxënësit në mësim:**

1 Mësuesit i nxitin nxënësit të marrin pjesë aktive në mësim.
2 Gjatë mësimit, mësuesit përdori metoda mësimdhënëse që aktivizojnë nxënësit.
3 Mësuesit kujdesen që nxënësit të punojnë së bashku me efiçiencë dhe mësojnë të mbështetin njëri-tjetrin.
4 Nxënësit tregojnë shkallë të lartë përfshirjeje në mësim.

**III Strategjia mësimdhënëse e mësuesve synon përdorimin e strategjive të ndryshme mësimore:**

1 Mësuesit krijojnë situata dhe përvoja konkrete, të cilat njihen nga nxënësit dhe përdoren në dhënien e detyrave.
2 Mësuesit bëjnë shpjegim të qartë të strategjisë që do të përdoret.
3 Ka shumë bashkëveprim midis strategjive të të nxënit.
4 Mësuesit i nxitin nxënësit të kontrollojnë veprimet e tyre.

**IV Mësuesit i përshtatin metodat e tyre sipas nevojave mësimore të nxënësve:**

1 Strategjitë e mësimdhënies janë përshtatur me nevojat dhe mundësitë e grupit të nxënësve si klasë.
2 Gjatë shpjegimit të mësimit, mësuesit kanë parasysh diferencat në nivelin e nxënësve.
3 Gjatë punës me tekstin mësuesit kanë parasysh diferencat në nivelin e nxënësve.

**V Klasa është organizuar në mënyrë efiçiente:**

1 Procesi i mësimdhënies dhe të nxënit është organizuar me efiçiencë.

## A.5 Sistemi i monitorimit të nxënësve

**Standardi:** *Mësuesit monitorojnë sistematikisht zhvillimin e nxënësve dhe i ndihmojnë ata kur kanë probleme.*

Një sistem i përshtatshëm monitorimi është parakushti për të realizuar një mësimdhënie ta adaptuar. Sistemi duhet të përfshijë monitorimin e zhvillimit dhe të progresit të nxënësve me anë të testeve dhe diskutimeve me nxënësit. Mbi këtë bazë shkolla identifikon nevojat mësimore të nxënësve dhe organizon punën për plotësimin e tyre nëpërmjet planeve që harton. Nevoja të tilla janë ato të nxënësve përsëritës, të nxënësve që vijnë nga shkolla të tjera etj. Shkolla duhet të raportojë rregullisht për këto probleme.

Treguesit e përdorur nga inspektoriatii në këtë rast janë:

1 Mësuesit monitorojnë sistematikisht zhvillimin e nxënësve.
2 Mësuesit përcaktojnë sistematikisht çdo nevojë speciale që mund të kenë nxënësit (diagnoza).
3. Janë hartuar plane pune për nxënësit me nevoja speciale mësimore.
4. Mësuesit monitorojnë sistematikisht zbatimin e planeve të punës.
5. Shkolla ka hartuar procedura për nxënësit me zhvillim të vonuar/shpejtuar.

## B. REZULTATET

Kjo fushë ka vetëm një standard:

**Standardi:** *Rezultatet e nxënësve përputhen me atë që të pritet nga karakteristikat e popullatës shkollore.*

Një nga detyrat kryesore të ciklit fillor është të vendos bazat pë vazhdimin e ciklit të lartë. Pra, shkolla është vendi ku nxënësit mësojnë dhe shkalla e arritjes së këtij objektivi vlerësohet edhe me anë të rezultateve të nxënësve.

Inspektoriati liston rezultatet e nxënësve në fund të periudhës së shkollimit dhe kontrollon nëse këto rezultate kanë të njëjtin nivel me ato të shkollave me popullatë shkollore te ngjashme. Një gjë e tillë kryhet me anë të analizës së të dhënave nga rezultatet përfundimtare të shkollës si dhe të testeve të ndryshme që përdor shkolla gjatë tre viteve të fundit. Në të njëjtën kohë, inspektoriati analizon edhe të dhënat që burojnë nga sistemi i monitorimit të nxënësve. Një tregues tjetër është edhe krahasimi i numrit të nxënësve përsëritës me atë të të shkollave me popullatë shkollore te ngjashme.

Treguesit që përdor inspektoriati për vlerësimin e rezultateve janë:

1 Rezultatet e nxënësve në fund të ciklit fillor përputhen me atë që pritet nga karakteristikat e popullatës shkollore.

2 Rezultatet e nxënësve gjatë çdo viti të ciklit fillor përputhen me atë që pritet nga karakteristikat e popullatës shkollore.

3 Përqindja e nxënësve përsëritës nuk është më e lartë se ajo që pritet nga karakteristikat e popullatës shkollore.

## C. KUSHTET E SHKOLLËS

Kjo fushë ka pesë standarde.

### C.1 Ruajtja e cilësisë

**Standardi:** *Shkolla monitorn sistematikisht cilësinë e shkollimit që ofron dhe merr masat e nevojshme kur kërkohet përmirësim.*

Inspektoriati vlerëson:

- Rrugën me të cilën shkolla përcakton cilësinë e rezultateve të saj dhe të procesit të mësimdhënies dhe të nxënit;
- Lidhjen e rezultateve me objektivat, mbështetjen te karakteristikat e popullatës shkollore, rezultatet e vetvlerësimit, planet e punës afatshkurtëra dhe afatgjata;
- Masat që janë marrë për konsolidimin e sukseseve dhe për përmirësimin e gjendjes.

Inspektoriati e vlerëson ruajtjen e cilësisë me anë të këtyre treguesve:

1 Në planin e punës së shkollës janë pasqyruar objektiva për procesin e mësimdhënies dhe të nxënit dhe për rezultatet.

2 Shkolla përcakton sistematikisht dhe në mënyrë të rregullt cilësinë e shkollimit që ofron cikli fillor.

3 Shkolla ka hartuar një plan përmirësimi të ciklit fillor mbi bazën e inspektimit të ushtruar.

4 Shkolla ka planifikuar një plan veprimtarish mbi bazën e analizave tëvitit shkollor në vazhdim si dhe të analizave të mëparshme.
5 Shkolla ka marrë masa konkrete për të konsoliduar pikat e forta të saj dhe për të përmirësuar problemet që ka.

## C.2 Kualifikimi i stafit

**Standardi:** *Shkolla punon vazhdimisht për përmirësimin e mjeshtërisë së stafit.*

Një shkollë e mirë ka një klimë të kënaqshme për kualifikimin e stafit. Kjo do të thotë se antarët e stafit veprojnë në bazë të diskutimit të ideve lidhur me trajtimin e nxënësve. Ata përdorin përvojën e njëri-tjetrit dhe janë të hapur ndaj kritikës dhe mbështetjes reciproke. Drejtoria e shkollës i mbështet dhe nxit mësuesit për të punuar në grup dhe kujdeset për të ndihmuar mësuesit e rinj.

Inspektoriati e vlerëson cilësinë e kualifikimit të stafit me këta tregues:
1 Stafi i shkollës udhëhiqet nga një mision i përbashkët i shkollës.
2 Stafi i shkollës karakterizohet nga një shkallë e lartë kolegjialiteti.
3 Drejtoria e shkollës nxit stafin të luajë rol aktiv në përmirësimin e cilësisë.
4 Drejtoria e shkollës kujdeset që mësuesit të punojnë në grup për zgjidhjen e problemeve.
5 Drejtoria e shkollës kujdeset për mësuesit e rinj.

## C.3 Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm

**Standardi:** *Shkolla planifikon dhe realizon konsultim funksional të brendshëm dhe të jashtëm.*

Inspektoriati e vlerëson cilësinë e këtij komunikimi me anë të këtyre treguesve:
1 Planit të shkollës që institucionalizon marrëdhëniet e saj me autoritetet arsimore dhe pushtetin vendor në shërbim të cilësisë së shkollimit të nxënësve.
2 Bashkërendimit të punës me kopshtet dhe ciklin e lartë.
3 Bashkërendimit të punës me sektorët e kualifikimit/këshillimit në DAR/ZA.
4 Bashkërendimit të punës me politikën arsimore të pushtetit vendor.

## C.4 Lidhjet me prindërit

**Standardi:** *Shkolla mban lidhje funksionale me prindërit.*

Inspektimi vëzhgon se si janë përfshirë prindërit në veprimtarinë e shkollës, si janë informuar dhe çfarë informacioni ka ofruar shkolla për ta. Po kështu, inspektimi vëzhgon se si shkolla merr informacion nga prindërit lidhur me punën e saj, me veçoritë e nxënësve dhe si e pasqyron në planet e saj të punës.

Inspektoriati e vlerëson cilësinë e lidhjes me prindërit me anë të këtyre treguesve:
1 Shkolla përfshin prindërit në veprimtaritë e saj.
2 Shkolla njeh kërkesat e prindërve për mësimin dhe i merr parasysh në punën që bën.
3 Shkolla i informon prindët për karakteristikat e saj.
4 Shkolla i informon prindët në mënyrë të rregullt lidhur me gjendjen e punëve në të.
5 Mësuesit mbështeten te mendimet e prindërve për punën e fëmijëve të tyre në shkollë dhe shtëpi.

6 Mësuesit i informojnë prindët në mënyrë të rregullt lidhur me rezultatet e fëmijve të tyre.
7 Mësuesit nxitin mbështetjen e prindërve në përgatitjen e fëmijve të tyre në shtëpi.

## C.5 Përdorimi i burimeve

**Standardi:** *Shkolla e përdor stafin dhe bazën materiale në mënyrën e duhur.*

Treguesit që përdor inspektoriati për të vlerësuar cilësinë e përdorimit të burimeve të shkollës janë:

1 Shkolla ka burimet e nevojshme njerëzore dhe materiale për drejtimin e saj.
2 Stafi është i ngarkuar me detyra specifike për procesin e mësimdhënies dhe të nxënit.
3 Stafi është i ngarkuar me detyra specifike sipas planit të punës së shkollës.
4 Shkolla përdor bazën materiale-mësimore në përputhje me kërkesat e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit.

## C.6 Administrimi dhe procedurat e shkollës

**Standardi:** *Shkolla ka një system funksional administrimi me procedura të përshtatshme shkollore.*

Treguesit që përdor inspektoriati për të vlerësuar cilësinë e administrimit dhe të procedurave të shkollës janë:

1 Plani i shkollës përshkruan politikën që ka ndjekur shkolla për cilësinë e shkollimit të ofruar.
2 Plani i shkollës ka evidentuar ato karakteristika të shkollës që janë të rëndësishme për prindët.
3 Shkolla ka një sistem të qartë të regjistrimit dhe të çregjistrimit të nxënësve.
4 Shkolla ka pasqyra të sakta të mungesave të nxënësve.
5 Shkolla ka procedura për zgjidhjen e ankesave.

# 3. SI ORGANIZOHET VIZITA E INSPEKTIMIT TË PLOTË

Inspektimi i plotë presupozon një dialog me shkollën dhe të gjithë palët e interesuara. Shkolla duhet të paraqesë punën që kryen për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë që ofron cikli i saj fillor. Në këtë kontekst, inspektimi i plotë krijon kushtet që shkolla të paraqesë cilësitë e daj, të cilat vlerësohen nga inspektoriate.

Vizita e ciklit fillor të shkollës kryhet nga inspektori i ngarkuar. Në shkolla të mëdha vizita kryhet nga një numër më i madh inspektorësh.

Më poshtë janë përshkruar fazat nëpër të cilat kalon vizita e inspektimit të plotë të ciklit fillor të një shkolle.

## 3.1 Përgatitja e vizitës

***Takimi informues***

Inspektoriati informon shkollën dhe autoritetet arsimore përkatëse për kohën kur do të kryhet inspektimi i plotë. Në këtë fazë diskutohet përmbajtja dhe organizimi i vizitës, bëhen përmirësime të platformës (nëse kjo është e domosdoshme), si dhe caktohet data e vizitës.

***Organizimi i vizitës***

Bashkë me datën e vizitës, shkolla merr edhe pyetsorët që do të përdoren nga inspektoriati gjatë takimit me stafin drejtues, mësuesit dhe me prindët. Pyetsorët grumbullojnë informacion për konkekstin e shkollës, kurrikulën, monitorimin e nxënësve, kushtet e shkollës dhe rezultatet e nxënësve. Ky informacion shërben për hartimin e nje tablloje fillestare të cilësive të shkollës para inspektimit të plotë. Ndërkaq, shkolla përgatit një draft-grafik për realizimin e inspektimit të plotë (Shtojca 1).

***Analiza e dokumentave***

Inspektori/grupi inspektues analizojnë dokumentacionin e grumbulluar si: planin e punës së shkollës, nevojat e saj, statusin e stafit drejtues e mësimor, dosjet e shkollës, raportet e inspektimeve të mëparshme etj. Kjo fazë përfundon me sistemimin e të dhënave të grumbulluara nga dokumentat e mësipërme.

## 3.2 Inspektimi i plotë i shkollës

Inspektimi i plotë i ciklit fillor zakonisht zgjat 2 ditë. Në shkollat e mëdha ose në ato që kanë disa shkolla vartëse vizita mund të zgjasë më shumë dhe inspektimi kryhet nga disa inspektorë. grafiku i inspektimit të plotë është paraqitur në Shtojcën 1. Shtojca 2 paraqet disa këshilla praktike, që duhen pasur parasysh nga drejtoria e shkollës për organizimin e takimeve gjatë procesit të inspektimit të plotë të ciklit fillor.

## Dita 1

***1 Takimi me stafin drejtues të shkollës (1)***

Stafi drejtues ka mundësinë për paraqitjen e shkollës dhe për të dhënë informacion shtesë rreth: kontekstit të shkollës, kurrikulës, kohës mësimore, kualifikimit të mësuesve, lidhjeve me autoritetet arsimore dhe pushtetin vendor, lidhjet me prindët si dhe përdorimin e stafit dhe të burimeve materiale. Kurse inspektori kërkon të dhëna lidhur me problemet që ka identifikuar nga pyetsori përkatës. Shkolla mund t'i paraqesë inspektorit dokumenta të tjerë, të cilët i konsideron të rëndësishëm për punën e saj.

***2 Takimi me antarin e drejtorisë që mbulon ciklin fillor***

Shkolla paraqet sistemin e saj të monitorimit të nxënësve. Rekomandohet që shkolla t'i paraqesë inspektorit plnet e ndërhyrjes për zgjidhjen e problemeve që ka pasur, raportet e analizave si dhe vëzhgimet lidhur me rezultatet e testeve në vite të ndryshme. Problematika e këtij takimi është paraqitur në Shtojcën 2.

***3 Analiza e dokumentacionit shkollor***

Kryhet ditën e parë të vizitës. Inspektori analizon dokumentat që ka paraqitur shkolla. Këto dokumenta përfshijnë:

- Planet e punës dhe analizat e kryera;
- Vëzhgimet për rezultatet e nxënësve;
- Materiale informuese, materialet për prindët;
- Planet e punës të hartuara për probleme specifike;
- Plani i kualifikimit të brendshëm;
- Minutazhi i takimeve të grupeve të punës;

- Dokumenta të tjera të rëndësishëm për cilësinë e shkollës.

Në fund të kësaj dite inspektori duhet të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e shkollës, realizimin e programit mësimor dhe sistemin e monitorimit të nxënësve.

## Dita 2

Kryhen këto veprimtari:

**1 *Vizita në grup dhe takime individuale me mësuesit.***
Inspektorët vëzhgojnë orë mësimi në të gjitha klasat dhe për të gjitha lëndët. Vëzhgimet kryhen sipas një grafiku të hartuar nga shkolla dhe inspektimi. Inspektorët vëzhgojnë regjistrin e klasës, të dhënat për përparimin e nxënësve, analizat e kryera në nivel klase etj. Problemet e evidentuara gjatë vëzhgimeve diskutohen me mësuesit

**2 *Takimi me prindët***
Organizohet takim me një grup të kufizuar prindësh, i cili ndërtohet nga shkolla. Diskutimi përqëndrohet në mënyrën se si shkolla mban lidhjet me prindët.

**3 *Takimi me nxënësit***
Inspektoriati organizon takim me një numër të kufizuar nxënësish, të cilët janë konsumatorë të arsimimit që ofron shkolla. Përbërja e grupit caktohet nga shkolla. Diskutimi trajton problemet e monitorimit të nxënësve, organizimin e mësimit në klasa të ndryshme dhe klimën e shkollës.

**4 *Takimi me mësuesit***
Përqëndrohet në këto tema: kurrikula, vazhdimësia dhe rezultatet e nxënësve në vite dhe bashkërendimi me arsimin parashkollor.

**5 *Takimi me DAR/ZA dhe pushtetin vendor***
Diskutohet përfshirja e tyre në shkollë, mbështetja që i është dhënë shkollës si dhe probleme të tjera.

**6 *Kontrolli i sistemit të administrimit dhe i procedurave të shkollës***
Vëzhgohen:
- Lista emërore e nxënësve 6-vjeçarë sipas gjendjes civile;
- Lista emërore e nxënësve 6-vjeçarë të regjistruar në shkollë;
- Lista emërore dhe dokumentacioni përkatë i nxënësve të ardhur dhe të larguar gjatë vitit shkollor;
- Të dhëna për frekuentimin e nxënësve dhe dokumentacioni përkatës për ndjekjen e këtij problemi;
- Të dhëna për rezultatet e nxënësve;
- Procedurat për zgjidhjen e ankesave.

**7 *Takimi me stafin drejtues të shkollës (2)***
Organizohet në fund të inspektimit të plotë dhe trajtohen problemet e rezultateve të nxënësve në lidhje me karakteristikat e shkollës, të plotësimt tëi nevojave mësimore të

tyre, të veprimtarive të shkollës për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë.

Inspektoriati informon drejtorinë e shkollës për rezultatet e vëzhgimit. Krijohen kushtet që drejtoria e shkollës të diskutojë gjetjet e inspektimit për situatën e vëzhguar. Inspektoriati qartëson çështjet për të cilat ka probleme si dhe rekomandimet e mundëshme.

### 3.3 Përfundimi i inspektimit të plotë

Pas inspektimit të plotë, inspektori harton raportin e inspektimit, i cili përmban vlerësimin e shkollës në përputhje me standardet dhe treguesit. Raporti i dërgohet shkollës.

Inspektori duhet të paraqes vlerësimin cilësor për secilin standard duke përdorur sistemin eme katër nivele:

**Shumë dobët**: kur janë të domosdoshme përmirësime në shumicën e standardeve;

**Mjaftueshëm**: kur shkolla ofron përvoja të suksesshme por ndjehet nevoja e përmirësimeve në aspektet më të rëndësishme të punës së saj;

**Mirë**: kur shkolla ofron më shumë suksese se sa dobësi për secilin aspekt të punës së saj dhe ndjehet nevoja e përmirësimit të disa aspekteve në të ardhmen.

**Shumë mirë**: kur shkolla ka suksese të kënaqshme dhe detyra e saj është të ruajë këtë nivel cilësie.

Vlerësimet e inspektorëve në raport mbështeten në treguesit e trajtuar në kapitullin 3 dhe duhen formuluar për secilin standard. Raporti paraqet profilin e shkollës dhe konkluzione mbi bazën e analizës së të gjitha të dhënave. Pikat kryesoret të raportit diskutohen me shkollën në përfundim të inpektimit.

Raporti me shkrim i dërgohet shkollës, DAR/ZA dhe pushtetit vendor jo më vonë se një muaj pas përfundimit të inspektimit.

Nëse rezulton se shkolla ka dobësi në pajtueshmërinë e veprimtarisë së saj me ligjin, në raport paraqiten detyrat dhe rekomandimet, duke specifikuar edhe institucionin përgjegjës për realizimin e tyre.

## 4. PYETJE RRETH INSPEKTIMIT TË PLOTË TË CIKLIT FILLOR

Gjatë inspektimeve të Drejtorisë së Inspektimit të MASh janë ngritur një sërë pyetjesh lidhur me procesin e inspektimit të plotë në shkolla. Në këtë pjesë të këtij Manuali janë paraqitur shpjegimet e pyetjeve më të shpeshta që janë bërë nga inspektorë, drejtorë dhe mësues shkollash.

1. ***Si janë përcaktuar normat që përdoren për vlerësimin e aspekteve të ndryshme të cilësisë së ciklit fillor?***

   Standardet dhe treguesit për vlerësimin e ciklit fillor janë hartuar në bazë të përvojës shqiptare të inspektimit, trajnimeve për përdorimin e Manualit të Inspektimit si dhe të konsultave me specialistë të arsimit. Ato janë ballafaquar me realitetin e shkollave tona dhe janë të hapura për përmirësime të mëtejshme.

2. ***Sa publik është raporti i inspektimit të plotë të shkollës?***

   Në një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore është theksuar se raporti i inspektimit të plotë të

shkollës bëhet publik nëpërmjet dërgimit të tij në shkollën e inspektuar, DAR/ZA dhe pushteti vendor. Raportet publikohen në gazetën "Mësuesi" dhe mund të lexohen në website-in e MASH.

**3. *A ka një klasifikim të shkollës sipas niveleve të cilësisë pas inspektimit të plotë të saj?***

Inspektoriati nuk synon të përdor inspektimin e plotë të shkollës për të krahasuar shkollat apo për të hartuar një sistem klasifikimi. Kushtet e shkollave ndryshojnë mjaft nga njëra-tjetra dhe inspektoriati e ka parasysh këtë fakt gajtë inspektimeve që kryen.

Inspektoriati informon shkollat në fund të vitit kalendarik lidhur me rezultatet mesatare të të gjitha shkollave që janë inspektuar gjatë atij viti nëkontekstin e inspektimit të plotë. Në këtë mënyrë, shkollat kanë mundësi të gjejnë pozicionin e tyre në këtë tablo të përgjithshme dhe të krahasojnë cilësinë e tyre me atë të shkollave të tjera.

**4. *Cilat janë rrethanat që ka merr parasysh inspektimi i plotë gjatë inspektimit të plotë të shkollës?***

Shkolla ka mundësinë të bashkëpunojë me grupin inspektues për probleme që mund të lindin gjatë procesit të inspektimit. P.sh., mund të diskutohen probleme të sëmundjes së mësuesve, të kushteve të këqia të motit etj. Sidoqoftë, duhet bërë kujdes që shkolla të jetë e informuar në kohë për procesin e inspektimit të plotë.

**5. Çfarë ndodh në shkollë pas inspektimit të plotë të saj?**

Inspektoriati përfundon inspektimin e plotë të shkollës duke hartuar një raport, i cili paraqet jo vetëm profilin e shkollës por edhe drejtimet për përmirësim. Në vaësi të problemeve të gjetura, inspektoriati mund të planifikojë një vizitë tjetër në shkollë. Objektivi i kësaj vizite është të kontrollojë seriozitetin me të cilin është përfshirë shkolla në realizimin e përmirësimit të cilësisë së shërbimit që ajo është duke ofruar. Si rregull, inspektoriati formulon rekomandime dhe detyra për stafin, drejtorinë e shkollës dhe institucionet arsimore.

**6. *Kush është më e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të shkollës: shkolla të ndjek planin e saj të punës apo të përqëndrohet në pikat e dobta që ka gjetur inspektimi?***

Së pari, shkolla ka përgjegjësinë e saj për cilësinë e shërbimit arsimor që ofron pra edhe të përmirësimit të saj. Përvoja tregon se konkluzionet e inspektimit e ndihmojnë shkollën të rishikoj edhe njëherë objektivat që ka vendosur. Inspektimi i plotë i shkollës është një proces, i cili lejon analizën e të gjitha fushave të cilësisë në lidhjen reciproke që kanë me njëra tjetrën. Natyrisht, zgjedhja e veprimtarive për përmirësim të mëtejshëm mbetet përgjegjësi e shkollës.

Shkolla është e detyruar të ndërmarrë veprime, nëse inspektoriati përcakton drejtimet për përmirësim. Inspektoriati përcakton drejtime në rastet e shkeljeve të akteve ligjore e nënligjore, kur shkolla nuk ka plan pune, kur nuk ka plan të kontrollit të brendshëm etj.

**8. *A ka ndonjë procedurë për të diskutuar dallimet midis opinioneve të shkollës dhe inspektoriatit?***

Metoda e punës e inspektoriatit kërkon që shkolla të bëjë një paraqitje të punës së saj në fillim të inspektimit. Po kështu, shkollës i jepet mundësia për të diskutuar raportin e

inspektimit para se ai të marrë formën përfundimtare.

Sidoqoftë, ndodh që dallimet në opinione të jenë të mëdha. Në këto raste, shkollës i krijohen mundësi që gjatë procesit të inspektimit të dialogojë me inspektorët për të arritur në mirëkuptim. Nëse edhe pas kësaj dallimet mbeten të mëdha, inspektoriati e paraqet mendimin e shkollës në raportin përfundimtar. Duhet theksuar se ky proces nuk prek metodën e punës së përdorur nga inspektoriati dhe treguesit e përdorur për vlerësimin e cilësisë.

Nëse edhe pas këtij hapi dallimet mbeten ende të mëdha, atëhere gjetjet e inspektimit diskutohen me autoritetin përkatës nga i cili varet grupi i nspektues dhe mund të rezultohet me një inspektim të dytë të plotë të shkollës.

**8. *A mund të imponohen sanksione pas inspekimit të plotë të shkollës?***

Inspektoriati arsimor nuk ka të drejtë të marrë vendime. Ai ka përgjegjësinë e vlerësimit të fushave të ndryshme të cilësisë së shkollës dhe t'i paraqesë ato në një raport me shkrim. Raporti i inspektimit përfundon me detyrat dhe rekomandimet që bën inspektoriati për përmirësimin e cilësisë së shkollës së inspektuar. Shkolla dhe institucionet arsimore kanë përgjegjësinë e marrjes së masave për realizimin e detyrave dhe rekomandimeve të inspektimit. Përvoja tregon se një praktikë e tillë funksionon. Në përgjithësi, shkollat e inspektuara hartojnë një plan pune për realizimin e detyrave të inspektimit ose përmirësojnë planet e tyre të punës në përputhje me ato detyra. E njëjta gjë vihet re edhe në qëndrimet e DRA/ZA ndaj konkluzioneve të inpektimit.

# SHTOJCA 1

## Grafiku i një dite pune gjatë inspektimit të plotë
### (për shkolla të mëdha 8-vjeçare)

| Koha | Veprimtaria | Detyrimet e shkollës |
|---|---|---|
| **Dita 1** | | |
| 13.00-14.00 | Takim me drejtorinë (1) | Çdo dokument shpjegues |
| 14.15-15.15 | Takim me antarin e drejtorisë që ndjek përparimin e ciklit fillor. | Pasqyra të rezultateve të nxënësve;<br>Testet e fundit të vitit;<br>Raporte të analizave të përparimit;<br>Analiza të klasave për përparimin. |
| 15.15-16.00 | Analiza e dokumentave | Planet e punës;<br>Analizat me mësuesit në drejtori;<br>Analiza të mëparshme. |
| **Dita 2** | | |
| 8.00-12.30 | Vëzhgime në të gjitha klasat | Të jenë gati: regjistri i secilës klasë, ditari i mësuesve, të dhëna për rezultatet e nxënësve, fletoret e detyrave të shtëpisë, hartimeve, punëve praktike, lidhjeve me prindët etj. |
| 12.30-13.10 | Takim me nxënësit | Njoftohen nxënësit pjesëmarrës në takim |
| 13.10-14.10 | Takim me prindët | Njoftohen prindët pjesëmarrës në takim |
| **Dita 3** | | |
| 8.00-12.30 | Vëzhgime në të gjitha klasat | Të jenë gati: regjistri i secilës klasë, ditari i mësuesve, të dhëna për rezultatet e nxënësve, fletoret e detyrave të shtëpisë, hartimeve, punëve praktike etj. |
| 12.30-13.10 | Takim me DAR/ZA | Njoftohen DAR/ZA për takimin |
| 13.10-14.10 | Takim me drejtorinë (2) | Njoftohet stafi drejtues |

Shkolla, në mirëkuptim me inspektorin/grupin e inspektorëve, mund të përfshijë aspekte të tjera të veprimtarisë së saj në këtë grafik.

# SHTOJCA 2

## Këshilla praktike për drejtorinë e shkollës

Më poshtë janë paraqitur disa këshilla që duhen të ketë parasysh drejtoria e shkollës për organizimin e takimeve me grupin e inspektorëve dhe për të raportuar gjatë fazave të ndryshme të inspektimit të plotë.

**Takimi me drejtorinë e shkollës (1)**
***Zgjatja: rreth 1 orë***

Objektivi i takimit është të përftohet një tablo e qartë e ciklit fillor lidhur me problemet e inspektimit. Inspektorati do t'ju krijojë kushte për t'u shprehur lidhur me këto çështje. Gjatë prezantimit tuaj duhet të kini parasysh se inspektimi është njohur me planet tuaja të punës, planin e veprimtarive si dhe me përgjigjet e formateve. Do të ishte mirë të kini dokumenta, të cilët mund të përdoren që gjatë prezantimit të gjendjes së shkollës suaj. Inspektoriati e vlerëson gatishmërinë tuaj për ofrimin e këtyre dokumentave edhe gjatë procesit të inspektimit.

Pas prezantimit tuaj, inspektori mund të kërkojë të dijë më shumë. Këto kërkesa mund dhe duhen trajtuar në takimin tjetër me inspektoriatin.

Më poshtë janë paraqitur disa çështje që duhet të kini parasysh për paraqitjen e aspekte të ndryshme të punës suaj.

1. ***Konteksti i shkollës***
   Cilat janë disa nga rrethanat që ndikojnë pozitivisht dhe negativisht në cilësinë e ciklit fillor të shkollës suaj? (Shembujt mund të jenë nga materialet e stafit, lëvizjet e kuadrit mësimor, të rasteve të sëmundjeve të nxënësve/mësuesve, përbërja e nxënësve, pika të forta etj.) Ç' ka ndodhur në ciklin fillor në shkollë, cilat janë planet e saj për t'i shndërruar rrethanat negative në pozitive?

2. ***Kurrikula***
   Cilat janë masat që kini marrë për zbatimin e programit mësimor së çdo lënde dhe në secilën klasë? Si përshtatet mësimdhënia me karakteristikat e popullatës shkollore? Si bëhet kjo në lëndët e gjuhës shqipe dhe të matematikës? Si punohet për zbatimin e programit mësimor me nxënësit e talentuar, të prapambetur, romë etj.? Si veproni për të mësuar, nëse janë arritur objektivat e planit mësimor në vite?

3. ***Koha mësimore***
   Cilat janë udhëzimet që kini zbatuar për planifikimin e realizimit të programit mësimor? A është ndërtuar orari i mësimit në përputhje me specifikat e lëndëve dhe të klasave? Cilat janë masat që kini marrë për parandalimin e humbjeve të orëve të mësimit? Si e kontrolloni zbatimin e orarit mësimor?

4. ***Kualifikimi i stafit***
   Si e kini realizuar konsensusin e stafit në lidhje me mendimin dhe veprimin pedagogjik që vepron në shkollë? Cili është niveli i punës në grup të mësuesve të ciklit fillor? Si veproni që mësuesit të jenë të hapur dhe të bashkëveprojnë me njërit-tjetrin? A janë të

suksesshme përpjekjet tuaja në këtë drejtim? Si i mbështesni mësuesit në punën e tyre? Si dhe sa është rritur mjeshtëria e mësuesve? Si i përcaktoni nevojat e stafit për kualifikim? Si veproni me mësuesit e rinj (nëse shkolla ka të tillë)?

5. ***Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm***
Si janë organizuar konsultimet brenda shkollës? Sa shpesh organizohen konsultimet, për cilat lëndë dhe në cilën formë? Si janë monitoruar detyrat që kanë rezultuar nga këto konsultime? Cila është shkalla e konsultimeve midis shkollës dhe DAR/ZA? Cila është përmbajtja e konsultimeve dhe shpeshtësia e tyre? Cilat janë institucionet me të cilët bashkëpunoni në nivel lokal dhe kombëtar?

6. ***Lidhjet me prindët***
Cila është rruga e grumbullimi të informacionit për mendimet e prindëve? Si e dini mendimin e prindëve për shkollën tuaj? Si e grumbullojnë mësuesit informacionin për gjendjen familjare të nxënësve dhe për ndihmën që marrin nga prindët? Cilat janë procedurat që ndjek shkolla për kontakte me prindët (shpeshtësia e takimeve, vizitat në shtëpi, etj.)? Si ndikoni për rritjen e influencës së prindëve në shkollë?

7. ***Përdorimi i burimeve njerëzore dhe materiale***
Cilat janë parimet që ju udhëheqin përdorimin e stafit? Cilat janë prioritetet? Si i përdorni këto burime në shërbim të mësimdhënies dhe të nxënit si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të shkollës? Cila është shkalla e vështirësisë së këtij procesi?

**Takimi me antarin e drejtorisë që mbulon ciklin fillor**
***Zgjatja: rreth 1 orë***

Objektivi i takimit është krijimi i një tabloje sa më të qartë për mënyrën e organizimit dhe realizimit në praktikë të monitorimit të nxënësve. Duhet të kini parasysh se inspektori është njohur me dokumentacionin e shkollës dhe formularët e plotësuar dhe këto përbëjnë bazën mbi të cilat ndërtohen pyetjet e tij. Pas këtij takimi, inspektori do të vëzhgojë edhe të dhënat e shkollës për përparimin, për nxënësit, planet e punës, diskutimet me nxënësit etj. Çështjet që mund të trajtoni në këtë takim janë trajtuar më poshtë.

1 ***Sinjalizimi***
Si dhe me çfarë instrumentash vlerësimi e kryen shkolla monitorimin e zhvillimit të nxënësve? Cilat janë lëndët mësimore ku janë zbatuar? Si e monitoroni përdorimin sistematik të këtyre instrumentave? Cilat janë instrumentat që përdor shkolla juaj për nxitjen e zhvillimit social dhe emocional të nxënësve të saj?

2 ***Diagnozimi***
Cilat janë procedurat që përdorni për analizën e kërkesave për ndihmë, nëse vëreni se përparimi i nxënësve është frenuar? Cili është bashkëpunimi brenda shkollës dhe me specialistët jashtë saj për këto raste? A janë protokolluar rezultatet e këtyre analizave?

3 ***Masat përmirësuese***
A ka plane pune për ndryshimin e gjendje për këto raste? Kur janë hartuar dhe kur jo? Cili është modeli i përdorur? A janë përfshirë prindët në zgjidhjen e problemit? Cilat janë

masat për aktivizimin e stafit dhe të burimeve të tjera për zgjidhjen e problemit? Cilat janë format e suksesshme të ndihmës që përdor shkolla?

**4 *Vlerësimi***
Si e kontrolloni efektin e ndihmës së dhënë? Kur është diskutuar cilësia e monitorimit të nxënësve? Cilat janë të dhënat që lejojnë vlerësimin e suksesit të iniciativave që kini ndërmarrë?

**5 *Vendime për gjendjen***
Cilat janë objektivat e shkollës për zhvillimin e fëmijëve në ciklin fillor? Cilat janë kriteret e punës me nxënësit përsëritës? A ka ndonjë plan pune për ta? Cilat janë analizat për këto probleme dhe shkalla e njohjes së prindëve me to?

**6 *Rezultatet e shkollës***
A kini norma për braktisjen shkollore në ciklin fillor në shkollën tuaj? A i analizoni rregullisht rezultatet e testeve? A i krahasoni ato me rezultatet e viteve të mëparshme? A i diskutoni rezultatet vjetore të nxënësve? Çfarë ndryshimesh kanë sjellë këto analiza në procesin mësimdhënës dhe të nxënit?

## Takimi me mësuesit
***Zgjatja: rreth 30 minuta***

Objektivi i këtij takimi është të përftohet një tablo e ideve që keni për një numër çështjesh të ciklit fillor të shkollës. Kjo është një mundësi që të shpreheni lidhur me to. Gjatë takimit duhet të keni parasysh se inspektori ka studjuar planin e punës së shkollës, planin e veprimtarive dhe pyetsorët. Natyrisht, mund të paraqisni të tjera dokumenta për një prezantim sa më të mirë tuajin. Ndërkaq inspektori mund të drejtoj disa pyetje për probleme të tjera. Më poshtë është paraqitur struktura e këtij takimi.

**1 *Kurrikula***
Cilat janë objektivat e lëndëve mësimore dhe të rezultateve në klasën tuaj? A ka tema, pjesë në tekstin e gjuhës shqipe dhe të matematikës që i kapërceni? Cilat janë ato? Si e trajtoni lëndën në përputhje me dallimet midis nxënësve?

**2 *Rezultatet***
A mund të provoni që rezultatet e nxënësve tuaj në fund të vitit janë në përputhje me aftësitë e tyre? Cili është roli i popullatës shkollore në këto rezulatate? Cili është niveli mesatar i nxënësve tuaj? Si kanë ecur nxënësit tuaj në ciklin e lartë? A mbani lidhje me këtë cikël dhe si?

**3 *Lidhjet me prindët***
Si i mbani lidhjet me prindët lidhur me zhvillimin e fëmijëve? Si i përfshini prindët për të ndihmuar fëmijët e tyre në kryerjen e detyrave të shtëpisë, të punojnë në mënyrë të pavarur etj.? A e keni marrë mendimin e prindërve për edukimin e fëmijëve të tyre nga shkolla në përfundim të ciklit fillor?

## Takimi me drejtorinë e shkollës (2)
***Zgjatja: rreth 1 orë***

Objektivi i këtij takimi është për t'u thelluar në veprimtaritë që përdor shkolla për të përcaktuar, monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e saj. Kjo bëhet mbi bazën e diskutimit të rezultateve. Ndërkaq, inspektoriati mund të kërkoj sqarimin e disa problemeve që kanë dalë gjatë inspektimit. Programi i takimit është paraqitur më poshtë.

***1 Rezultatet***

Si i përcaktoni rezultatet mesatare të nxënësve tuaj në fund të ciklit fillor dhe në fund të secilës klasë? A mund të provoni se këto rezultate mesatare përputhen me aftësitë e nxënësve tuaj? Si punoni me nxënësit me rezultatet të ulta? A kini ngelje në klasë? Cilat janë rezultatet e nxënësve tuaj në ciklin e lartë?

***2 Ruajtja e cilësisë***

Ka të bëjë me përcaktimin, monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së shkollimit. Metoda që përdor shkolla është pasqyruar në planin e saj të punës. Si e përcakton shkolla cilësinë e rezultateve dhe të procesit të mësimdhënies e të nxënit dhe si i analizon rezultatet? Cila është shkalla e influencës së popullatës shkollore në këto rezultate? A përputhen rezultatet me objektivat e shkollës? A është përfshirë i gjithë stafi për hartimin e këtyre objektivave? Si e kontrolloni që i gjithë stafi është duke punuar për arritjen e tyre. Si dhe sa shpesh kontrolloni cilësinë e shkolimit që ofroni? Cilat janë instrumentat ose procedurat? Kur është bërë kontrolli i fundit për cilësinë? Cilat janë objektivat afatgjatë që kini planifikuar, si pasojë e këtyre kontrolleve dhe cilat janë veprimtaritë që keni planifikuar për arritjen e tyre? Cilat janë masat që keni marrë për ruajtjen e pikave të forta dhe për përmirësimin e problemeve?

# ZGJEDHJA E INSTRUMENTAVE QË PËRDOREN GJATË INSPEKTIMIT TË PLOTË TË CIKLIT FILLOR

***Në këtë pjesë janë paraqitur disa formate që përdoren nga inspektoriati gjatë vëzhgimeve dhe vlerësimit të cilësisë së ciklit fillor të shkollës suaj.***

***Me mjaft interes është Formati "Udhëzime për vëzhgimin e mësimit". Në të janë paraqitur çështjet që vëzhgon inspektori gjatë inspektimit të plotë të shkollës. Njohja me këto kërkesa ju ndihmon për të orientuar gjithë punën që zhvilloni në ciklin fillor të shkollës suaj.***

***Formati i fundit paraqet të gjitha karakteristikat e cilësisë në ciklin fillor si dhe normat e vlerësimit për secilën karakteristikë dhe ciklin e ulet në tërësi.***

# FORMAT 1

## PËR VËZHGIMIN E MËSIMIT

**KLASA:** **TEMA E MËSIMIT:**
**VITI SHKOLLOR:** **TEKSTI:**
**MËSUESI:** **DATA:**

| A. PROCESI I MËSIMDHËNIES DHE I TË NXËNIT | 1 | 2 | 3 | 4 | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|
| **A.2 KOHA MËSIMORE** | | | | | |
| A.2.4 Mësuesit realizojnë kohën e planifikuar mësimore | | | | | |
| **A.3 KLIMA E SHKOLLËS** | | | | | |
| A.3.1 Mjedis të nxëni i sigurtë dhe funksional. | | | | | |
| A.3.2 Mësuesit tregojnë respekt për nxënësit. | | | | | |
| A.3.3 Mësuesit nitin respektin reciprok midis nxënësve. | | | | | |
| A.3.4 Mësuesit mbështetin vetbesimin e nxënësve. | | | | | |
| A.3.5 Shkolla ka një rregullore të qartë të disiplinës. | | | | | |
| A.3.6 Nxënësit nxiten të jenë të pavarur dhe të marrin përgjegjësi. | | | | | |
| **A.4 STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES** | | | | | |
| I. Strategji e qartë dhe e strukturuar | | | | | |
| 1. Mësimet kanë strukturë të qartë. | | | | | |
| 2. Shpjegim i qartë i mësimit/detyrave. | | | | | |
| 3. Mësuesi kontrollon nëse nxënësit e kanë kuptuar mësimin | | | | | |
| II. Aktivizimi | | | | | |
| 1. Mësuesi realizon përfshirje aktive të nxënësve. | | | | | |
| 2. Mësuesi përdor metoda aktive të mësimdhënies. | | | | | |
| 3. Mësuesi përdor të punuarit me grupe. | | | | | |
| 4. Mësuesi nxit përshirjen e nxënësve. | | | | | |
| III. Përdorimi i strategjive të të nxënit | | | | | |
| 1. Mësuesi përdor situata konkrete dhe të njohura nga nxënësit/përdorim i detyrave zbatuese. | | | | | |
| 2. Mësuesi përdor strategji të të nxënit. | | | | | |
| 3. Mësuesi realizon bashkëveprim të orientuar nga strategjitë. | | | | | |
| 4. Mësuesi nxit nxënësit për të kontrolluar veprimet e tyre. | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| IV. Përshtatja e mësimit sipas: | | | | | |
| 1. Klasës në tërësi. | | | | | |
| 2. Dallimeve individuale në nivelin e nxënësve. | | | | | |
| V. Organizimi i klasës sipas: | | | | | |
| 1. Efiçiencës | | | | | |

*Çështje që kanë dalë nga analiza e pyetsorit të mësuesit:Probleme për diskutim:*

*Probleme për diskutim:*

# FORMAT 2

## UDHËZIME PËR VËZHGIMIN E MËSIMIT

### A. PROCESI I MËSIMDHËNIES DHE I TË NXËNIT

**A.2 KOHA MËSIMORE**

**Standardi**: Nxënësit kanë kohën e mjaftueshme për të zotëruar lëndën mësimore.

*A.2.4 Mësuesit realizojnë kohën e planifikuar mësimore.*

Për këtë:

- Ndiqni orarin e mësimit;
- Ndiqni realizimin e programit të gjuhës shqipe dhe të matematikës;
- Shikoni nëse ka humbje të kohës në menaxhimin e klasës.

**A.3 KLIMA E SHKOLLËS**

**Standardi:** Mësuesit u krijojnë nxënësve një klimë shkollore nxitëse dhe motivuese.

*A.3.1 Mësuesit sigurojnë një mjedis të nxëni të sigurtë dhe funksional.*

Për këtë shikoni nëse:

- Klasat janë të rregullta dhe të pastra;
- Nuk ka pajisje të kota;
- Materialet janë afishuar në mënyrë të organizuar;
- Dekori i klasës është tërheqës;
- Klasa ka ndriçim të mjaftueshëm.

*A.3.2 Me sjelljen e tyre dhe gjuhën që përdorin, mësuesit tregojnë respekt për nxënësit.*

Për këtë shikoni nëse:

- Nxënësit lejohen të shprehin mendimin e tyre;
- Nxënësit dëgjohen me vëmendje;
- Shpërblehen kontributet e nxënësve në mësim;
- Nuk bëhen komente për pamjen e nxënësve;
- Nuk bëhen dallime midis nxënësve;
- Nuk ka shfaqje të simpatisë ose antipatisë;
- Nuk ka shfaqje të sarkazmës ose cinizmit;
- Merret parasysh mendimi i nxënësve për mjedisin e tyre.

*A.3.3 Mësuesit nxitin respektin reciprok midis nxënësve.*

Për këtë shikoni nëse:

- Shihet se për ta respekti reciprok është i rëndësishëm;
- I përgjigjen sjelljes konkuruese;
- Nuk nxitin konkurimin midis nxënësve;
- U përgjigjen komenteve për pamjen e nxënësve;
- U përgjigjen detyrimeve.

*A.3.4 Mësuesit mbështetin vetbesimin e nxënësve.*

Për këtë shikoni nëse:

- Kanë reagim pozitiv për kontributet e nxënësve;
- Nuk bëjnë komente stigmatizuese;
- Vlerësojnë përpjekjet dhe kontributet e nxënësve;
- Shprehen pozitivisht për mundësitë e nxënësve për rezultate më të larta;
- Janë të afruar.

*A.3.5 Shkolla ka një rregullore të qartë të disiplinës.*

Për këtë shikoni nëse:

- Nxënësit i njohin rregullat që duhen zbatuar;
- Mësuesit korigjojnë në kohë sjelljen e nxënësve;
- Kanë kërkesa ndaj nxënësve për sjelljen e tyre;
- Arsyet për masat disiplinore janë të qarta dhe zbatohen njëlloj për të gjithë;
- Nxënësit përgjigjen ndaj masave disiplinore.

*A.3.6 Mësuesit krijojnë një mjedis të nxëni nxitës.*

Për këtë shikoni nëse:

- Nxënësit janë të pajisur me tekste;
- Ka materiale mësimore ndihmëse;
- Klasa është e pajisur;
- Ka libra leximi dhe materiale mësimore;
- Janë punimet e mëparshme të nxënësve.

*A.3.7 Mësuesit i nxitin nxënësit të jenë të pavarur dhe të marrin përgjegjësi.*

Për këtë shikoni nëse:

- Nxënësit ngarkohen me detyra organizative;
- Nxënësit nxiten për pasurimin e bazës materiale të klasës, vizatimin e afisheve, hartimin e rregullores së klasës etj.
- Nxënësit ngarkohen me detyra ditore dhe javore;
- Nxënësit nxiten të punojnë për çështje që i kanë zgjedhur vet.

## A.4 STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES

**Standardi:** Mësuesit shpjegojnë në mënyrë efiçiente.

### *I. Procesi mësimor është i qartë dhe me strukturë të mirë.*

*I.1 Mësimet kanë strukturë të qartë.*

Për këtë shikoni nëse:

- Qëllimi i mësimit është i qartë;
- Komponentët e mësimit janë të qartë;
- Ka një konkluzion të qartë të mësimit.

*I.2 Mësuesit bëjnë shpjegim të qartë të mësimit dhe të detyrave.*

Për këtë shikoni nëse:

- Shpjegohet tema sipas planit mësimor;

- Shpjegohet hap pas hapi;
- Janë kuptuar pyetjet;
- Bëhet përmbledhje e temës së zhvilluar;
- Përdoren shembuj konkret;
- Përdoren materiale ilustrative;
- Jepen detyra të qarta;
- Jepen udhëzime për zgjidhjen e detyrave.

*I.3 Mësuesit kontrollojnë rregullisht nëse nxënësit e kanë kuptuar mësimin dhe detyrat.*

Për këtë shikoni nëse:

- Shpjegimi është kuptuar;
- Kontrollohen nxënësit nëse kanë kuptuar se çfarë duhet të bëjnë;
- Nxënësit ndihmohen përsëri për të kuptuar mësimin.

***II Mësuesit i përfshijnë aktivisht nxënësit në mësim.***

*II.1 Mësuesit i nxitin nxënësit të marrin pjesë aktive në mësim.*

Për këtë shikoni nëse:

- Aktivizojnë shumë nxënës;
- Drejtojnë pyetje të hapura që nxitin nxënësit;
- Drejtojnë pyetje të menduara që ftojnë nxënësit të marrin pjesë aktive në mësim;
- Presin aq sa duhet që nxënësit të mendojnë për t'iu përgjigjur pyetjeve.
- Zhvillojnë idetë dhe sugjerimet që dalin nga puna në grup.
- Nxënësit kontribuojnë me shembuj dhe ide;
- Kërkohet që nxënësit të zhvillojnë idetë e paraqitura nga shokët e tyre.

*II.2 Gjatë mësimit, mësuesit përdorin metoda mësimdhënëse që aktivizojnë nxënësit.*

Për këtë shikoni nëse:

- Punohet me grupe të vogla;
- Përdoren forma të diskutimit;
- Ka diskutime;
- Organizohet punë e pavarur;
- Ka punë dhe lojë me grupe të vegjël;
- Krijohen mundësi për përdorimin e detyrave në situata praktike;
- Kryhen ushtrime, detyra;
- Nxënësit ndihmojnë nëjri-tjetrin;
- Nxënësit përdorin informacion nga librat, intervistat, diskutimet etj.;
- Nxënësit vetkontrollojnë punën e tyre.

*II.3 Mësuesit kujdesen që nxënësit të punojnë së bashku me efiçiencë dhe mësojnë të mbështetin njëri-tjetrin.*

Për këtë shikoni nëse:

- Nxënësve u krijohen mundësi të ndihmojnë njërit-tjetrin;
- I kushtohet vemendje të mësuarit bashkëpunues;
- Besohet në sjelljen e nxënësve;

- Ka metoda të vlerësimit;
- Ka proces verësimi;
- Shmanget rrëmuja në klasë.

*II.4 Nxënësit tregojnë një shkallë të lartë përfshirjeje në mësim.*

Për këtë shikoni nëse ata:

- Dëgjojnë me vëmendje;
- Vazhdojnë të jenë të përqëndruar;
- Bëjnë pyetje lidhur me mësimin;
- Marrin pjesë aktivisht në diskutimet për mësimin;
- Kanë përqëndrim në kryerjen e detyrave.

***III Strategjia mësimdhënëse e mësuesve synon përdorimin e strategjive të ndryshme mësimore:***

*III.1 Mësuesit përdorin situata dhe përvoja konkrete, të cilat njihen nga nxënësit dhe përdoren në dhënien e detyrave.*

Për këtë shikoni nëse:

- Ka situata nga mjedisi ku jetojnë fëmijët;
- Ka situata nga mësimet e mëparshme;
- Ka situata nga lëndët e tjera mësimore;
- Lidhje me realitetin.

*III.2 Mësuesit japin shpjegim të qartë të strategjisë.*

Për këtë shikoni nëse:

- Ka demonstrim të strategjisë në kontekstin e vet të zakonshëm;
- Ka demonstrim të përdorimit të modeleve ose të treguesve;
- Nxënësit përfshihen në strategji të ndryshme;
- Ka përsëritje dhe konkluzione për çështjet e mësuara.

*III.3 Ka shumë bashkëveprim midis strategjive të të nxënit.*

Për këtë shikoni nëse:

- Nxënësve u krijohet mundësi dhe kohë për të gjetur zgjidhjet e detyrave;
- Nxënësve u jepet kohë të propozojnë mënyra zjgidhjeje;
- Nxënësit nxiten të mendojnë për zgjidhjet e tyre;
- Krahasohen zgjidhjet e propozuara nga nxënësit;
- Mësuesi ndërton strukturën për zgjidhjet e propozuara nga nxënësit;
- Nxënësit që nuk propozojnë zgjidhje përfshihen në diskutim.

*III. 4 Mësuesit i nxitin nxënësit të kontrollojnë veprimet e tyre.*

Për këtë shikoni nëse:

- Në përgjithësi nxënësit përcaktojnë zgjidhjet dhe rezultatet;
- Kanë informacion lidhur me kontekstin e mësimit;
- Bashkë me nxënësit kontrollohen metodat e përdorura të punës dhe të sjelljes;
- Bashkë me nxënësit bëhen përpjekje për përmirësimi.

| IV | **Mësuesit i përshtatin metodat e tyre sipas nevojave mësimore të nxënësve.** |
|---|---|

*IV.1 Strategjitë e mësimdhënies janë përshtatur me nevojat dhe mundësitë e grupit të nxënësve si klasë.*

Për këtë shikoni nëse:

- Mësuesit përshtatin:
  - metodat e mësimit (kontrollin e dijes, strukturën);
  - nivelin e mësimit;
  - metodën e mësimit;
  - ritmin e tij.
- Mësuesit i ndërtojnë strategjitë e tyre mbi bazën e analizës së:
  - gabimeve të punës së nxënësve;
  - analizës së grupeve të nxënësve.

*IV. 2. Gjatë shpjegimit mësuesit kanë parasysh diferencat në nivelin e nxënësve.*

Për këtë shikoni nëse ka:

- Përgatitje paraprake të mësimit;
- Kontroll nëse nxënësit e dobët kanë kuptuar mësimin;
- Përdorim të shembujve të tjerë ose riformulim të shpjegimit;
- Përqëndrim të dukshëm tek nxënësit e dobët dhe të mirë;
- Jepen ushtrime për nxënësit që kanë munguar;
- Jepen ushtrime individuale;
- Ndihmë për grupe të vogla nxënësish;
- Ndihmë për nxënësit me nevoja speciale.

*IV.3 Gjatë punës me tekstin mësuesit kanë parasysh diferencat në nivelin e nxënësve.*

Për këtë shikoni nëse nxënësit i kryejnë detyra sipas:

- Nivelit të tyre;
- Sipas mënyrave të përshtatshme për ta;
- Sipas ritmit të tyre.

| V | **Klasa është organizuar në mënyrë efiçiente.** |
|---|---|

*V.1 Procesi i mësimdhënies dhe të nxënit është organizuar me efiçiencë.*

Për këtë shikoni nëse:

- Materialet mësimore janë gati për përdorim;
- Fillimi imësimit është i butë, i shpejtë dhe efficient;
- Për organizimin e klasës harxhohet pak kohë;
- Harxhohet pak kohë për ndihmë/shpjegime individuale;
- Ka një atmosferë të rregult dhe të qetë;
- Ka përdorim të kufizuar të masave disiplinore.

# FORMAT 3

## PASQYRA PËRMBLEDHËSE E MËSIMEVE TË VËZHGUARA VITI MËSIMOR: 2004- 2205

| Klasa | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | Sht | Tet | Nën | Dhj | Jan | Shk | Mar | Pr | Ma | Qer | Shkolla |
| A.2 Koha mësimore | | | | | | | | | | | |
| A2.4 | | | | | | | | | | | |
| A.3 Klima e shkollës | | | | | | | | | | | |
| A.3.1 | | | | | | | | | | | |
| A.3.2 | | | | | | | | | | | |
| A.3.3 | | | | | | | | | | | |
| A.3.4 | | | | | | | | | | | |
| A.3.5 | | | | | | | | | | | |
| A.3.6 | | | | | | | | | | | |
| A.3.7 | | | | | | | | | | | |
| A.4 Strategjia e mësim-dhënies | | | | | | | | | | | |
| I. E qartë dhe e strukturuar | | | | | | | | | | | |
| I.1 | | | | | | | | | | | |
| I.2 | | | | | | | | | | | |
| I.3 | | | | | | | | | | | |
| II. | | | | | | | | | | | |
| II.1 | | | | | | | | | | | |
| II.2 | | | | | | | | | | | |
| II.3 | | | | | | | | | | | |
| II.4 | | | | | | | | | | | |
| III. Përdorim i strategjive të të nxënit | | | | | | | | | | | |
| III.1 | | | | | | | | | | | |
| III.2 | | | | | | | | | | | |
| III.3 | | | | | | | | | | | |
| III.4 | | | | | | | | | | | |
| IV. Përshtatja | | | | | | | | | | | |
| IV. 1 | | | | | | | | | | | |
| IV.2 | | | | | | | | | | | |
| IV.3 | | | | | | | | | | | |
| V. Organizimi i klasës | | | | | | | | | | | |
| V.1 | | | | | | | | | | | |

# FORMAT 4

## PËR DISKUTIMIN ME MËSUESIN E INSPEKTUAR

Qëllimi i diskutimit është për të pyetur mësuesit rreth 4 çështjeve që janë paraqitur në kolonën e majtë të formatit.

Probleme të dala nga pyetsori i drejtorisë së shkollës dhe i mësuesit:
(Probleme, të cilat inspektori ka nevojë t'i diskutojë me mësuesin)

| A. Procesi i mësimdhënies dhe të nxënit | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | **A.1 Kurrikula** | *Ç'masa keni marrë për realizimin e programit mësimor?* |
| | | | | Janë arritur standardet e përmbajtjes | |
| | | | | Janë realizuar objektivat kros-kurrikulare | |
| | | | | Përputhje me nevojat mësimore, aftësitë dhe kulturën e nxënësve | |
| | | | | Diferencat midis nxënësve | |
| | | | | Përputhje me metodat bashkëkohore të mësimdhënies | |
| | | | | **A.5 Sistemi i monitorimit të nxënësve** | |
| | | | | Monitorim sistematik nëpërmjet:<br>- Arritjes së objektivave;<br>- Testimit të rregullt. | *A kanë mësuesit një tabllo të qartë të zhvillimit të nxënësve nga klasa 1 në klasën 4 të ciklit fillor?* |
| | | | | **B. Rezultatet** | *Cili është shpjegimi juaj për rezultatet krahasuar me popullatën shkollore?* |
| | | | | Rezultatet në fund të klasës 2;<br>Rezultatet në fund të klasës 3;<br>Numri i nxënësve përsëritës. | |
| | | | | **C.4 Lidhja me prindët** | *Cila është cilësia e kontakteve tuaja me prindët?* |
| | | | | Përfshirje në veprimtaritë;<br>Informim i rregullt i gjendjes aktuale;<br>Mbështetetje te mendimet e prindërve;<br>Informim për përparimin e nxënësve; | |

# FORMAT 5

## FORMATI I VLERËSIMIT TË PËRGJITHSHËM

**VITI SHKOLLOR: ________________**

| TREGUESIT | FUSHAT | 1 | 2 | 3 | 4 |
|---|---|---|---|---|---|
| A | **Mësimdhënia dhe të nxënit** | | | | |
| A.1 | **Kurrikula**<br>**Standardi:** *Kurrikula është zbatuar në përputhje me aktet ligjore/nënligjore.* | | | | |
| A.1.1 | Janë arritur standardet e përmbajtjes për secilën lëndë mësimore. | 1 | 2 | 3 | 4 |
| A.1.2 | Ka dhe janë realizuar objektivat kros-kurrikulare. | 1 | 2 | 3 | 4 |
| A.1.3 | Kurrikula zbatohet në përputhje me nevojat mësimore, aftësitë dhe kulturën e nxënësve. | 1 | 2 | 3 | 4 |
| A.1.4 | Zbatimi i kurrikulës merr parasysh diferencat midis nxënësve. | - | - | - | - |
| A.1.5 | Zbatimi i kurrikulës bëhet në përputhje me metodat bashkëkohore të mësimdhënies. | - | - | - | - |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesit A.1.1, A.1.2, dhe A.1.3** | 1 | 2 | 3 | 4 |
| | | | | | |
| A.2 | **Koha mësimore**<br>**Standardi:** *Nxënësit kanë kohën e mjaftueshme për të zotëruar lëndën mësimore.* | | | | |
| A.2.1 | Shkolla ka planifikuar realizimin sasior të programit të lëndëve mësimore. | | | | |
| A.2.2 | Shkolla synon të parandalojë humbjet e orëve të mësimit. | | | | |
| A.2.3 | Shkolla kujdeset që realizimi i programit të gjuhës shqipe dhe të matematikës të kryhet në përputhje me nevojat mësimore të popullatës shkollore. | | | | |
| A.2.4 | Mësuesit realizojnë kohën e planifikuar mësimore. | | | | |
| A.2.5 | Mësuesit e përdorin kohën e mësimit në varësi të nevojave mësimore të nxënësve. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesit A.2.1 dhe A.2.4** | | | | |
| | | | | | |
| A.3 | **Klima e shkollës**<br>**Standardi:** *Mësuesit u krijojnë nxënësve një klimë shkollore nxitëse dhe motivuese.* | | | | |
| A.3.1 | Mësuesit sigurojnë një mjedis të nxëni të sigurtë dhe funksional. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **A.3.2** | Me sjelljen e tyre dhe gjuhën që përdorin, mësuesit tregojnë respekt për nxënësit. | | | | |
| **A.3.3** | Mësuesit nxitin respektin reciprok midis nxënësve. | | | | |
| **A.3.4** | Mësuesit mbështetin vetbesimin e nxënësve. | | | | |
| **A.3.5** | Shkolla ka një rregullore të qartë të disiplinës. | | | | |
| **A.3.6** | Mësuesit krijojnë një mjedis nxitës në klasë. | | | | |
| **A.3.7** | Mësuesit i nxitin nxënësit të jenë të pavarur dhe të marrin përgjegjësi. | | | | |
| **Norma** | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesit A.3.1, A.3.2, A.3.3, A.3.4 dhe A.3.6** | | | | |
| | | | | | |
| **A.4** | **Strategjia e mësimdhënies**<br>***Standardi:*** *Mësuesit shpjegojnë në mënyrë efiçiente.* | | | | |
| **A.4.I** | ***Struktura:*** *Procesi mësimor është i qartë dhe me strukturë të mirë.* | | | | |
| **1** | Mësimet kanë strukturë të qartë. | | | | |
| **2** | Mësuesit bëjnë shpjegim të qartë të mësimit dhe të detyrave. | | | | |
| **3** | Mësuesit kontrollojnë rregullisht, nëse nxënësit kanë kuptuar mësimin dhe detyrat. | | | | |
| **Norma** | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesit I.1dhe I.3** | | | | |
| **A.4.II** | ***Aktivitetet e nxënësve:*** *Mësuesit i përfshijnë aktivisht nxënësit në mësim.* | | | | |
| **1** | Mësuesit i nxitin nxënësit të marrin pjesë aktive në mësim. | | | | |
| **2** | Gjatë mësimit, mësuesit përdori metoda mësimdhënëse që aktivizojnë nxënësit. | | | | |
| **3** | Mësuesit kujdesen që nxënësit të punojnë së bashku me efiçiencë dhe mësojnë të mbështetin njëri-tjetrin. | | | | |
| **4** | Nxënësit tregojnë shkallë të lartë përfshirjeje në mësim. | | | | |
| **Norma** | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesit II.4, II.5 dhe II.4** | | | | |
| **III** | ***Strategjitë mësimdhënëse:*** *Strategjia mësimdhënëse e mësuesve synon përdorimin e strategjive të ndryshme mësimore:* | | | | |
| **1** | Mësuesit krijojnë situata dhe përvoja konkrete, të cilat njihen nga nxënësit dhe përdoren në dhënien e detyrave. | | | | |
| **2** | Mësuesit realizojnë shpjegim të qartë të strategjisë. | | | | |
| **3** | Ka shumë bashkëveprim midis strategjive të të nxënit. | | | | |
| **4** | Mësuesit i nxitin nxënësit që të kontrollojnë veprimet e tyre. | | | | |
| **Norma** | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesit III.1dhe III.2** | | | | |
| **IV** | ***Përshtatja****: Mësuesit i përshtatin metodat e tyre sipas nevojave mësimore të nxënësve.* | | | | |
| **1** | Strategjitë e mësimdhënies janë përshtatur me nevojat dhe mundësitë e grupit të nxënësve si klasë. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Gjatë shpjegimit të mësimit, mësuesit kanë parasysh diferencat në nivelin e nxënësve. | | | | |
| 3 | Gjatë punës me tekstin mësuesit kanë parasysh diferencat në nivelin e nxënësve. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesit IV.2 dhe IV.3** | | | | |
| V | ***Organizimi i klasës:*** *Klasa është organizuar në mënyrë efiçiente.* | | | | |
| 1 | Procesi i mësimdhënies dhe të nxënit është organizuar me efiçiencë. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse është vlerësuar me nivelin 3 treguesi V.1** | | | | |
| | | | | | |
| A.5 | **Sistemi i monitorimit të nxënësve**<br>**Standardi:** *Mësuesit monitorojnë sistematikisht zhvillimin e nxënësve dhe i ndihmojnë ata kur kanë probleme.* | | | | |
| 1 | Mësuesit monitorojnë sistematikisht zhvillimin e nxënësve. | | | | |
| 2 | Mësuesit përcaktojnë sistematikisht çdo nevojë speciale që mund të kenë nxënësit (diagnoza). | | | | |
| 3 | Janë hartuar plane pune për nxënësit me nevoja speciale mësimore. | | | | |
| 4 | Mësuesit monitorojnë sistematikisht zbatimin e planeve të punës. | | | | |
| 5 | Shkolla ka hartuar procedura për nxënësit me zhvillim të vonuar/shpejtuar. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesi A.5.1, A.5.2 dhe A.5.3** | | | | |
| | | | | | |
| **B** | **REZULTATET**<br>**Standardi:** *Rezultatet e nxënësve janë në përputhje me atë që pritet nga karakteristikat e popullatës shkollore.* | | | | |
| 1 | Rezultatet e nxënësve në fund të ciklit fillor janë në përputhje me atë që pritet nga karakteristikate popullatës shkollore. | | | | |
| 2 | Rezultatet e nxënësve gjatë çdo viti të ciklit fillorjanë në përputhje me atë që pritet ngakarakteristikat e popullatës shkollore. | | | | |
| 3 | Përqindja e nxënësve përsëritës nuk është më e lartë se ajo që pritet nga karakteristikat e popullatës shkollor. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse është vlerësuar me nivelin 3 treguesi B.1** | | | | |

| C | KUSHTET E SHKOLLËS | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| C.1 | **Ruajtja e cilësisë**<br>**Standardi:** *Shkolla monitoron sistematikisht cilësinë e shkollimit që ofron dhe merr masat e nevojshme kur kërkohet përimrësim.* | | | | |
| 1 | Në planin e punës së shkollës janë pasqyruar objektiva për procesin e mësimdhënies e të nxënit si dhe për rezultatet. | | | | |
| 2 | Shkolla përcakton sistematikisht dhe në mënyrë të rregullt cilësinë e shkollimit që ofron cikli fillor. | | | | |
| 3 | Shkolla ka hartuar një plan përmirësimi të ciklit fillor mbi bazën e inspektimit të ushtruar. | | | | |
| 4 | Shkolla ka planifikuar një plan veprimtarish mbi bazën e analizave të vitit shkollor në vazhdim si dhe të analizave të mëparshme. | | | | |
| 5 | Shkolla ka marrë masa konkrete për të konsoliduar pikat e forta të saj dhe për të përmirësuar problemet që ka. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesi C.1.1 dhe C.1.2** | | | | |
| C.2 | **Kualifikimi i stafit**<br>**Standardi:** *Shkolla punon vazhdimisht për përmirësimin e mjeshtërisë së stafit.* | | | | |
| 1 | Stafi i shkollës udhëhiqet nga një mision i përbashkët i shkollës. | | | | |
| 2 | Stafi i shkollës karakterizohet nga një shkallë e lartë kolegjialiteti. | | | | |
| 3 | Drejtoria e shkollës nxit stafin të luajë rol aktiv në përmirësimin e cilësisë. | | | | |
| 4 | Drejtoria e shkollës kujdeset që mësuesit të punojnë në grup për zgjidhjen e problemeve. | | | | |
| 5 | Drejtoria e shkollës kujdeset për mësuesit e rinj. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesi C.2.4 dhe C.2.5** | | | | |
| C.3 | **Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm**<br>**Standardi:** *Shkolla planifikon dhe realizon konsultime funksionale të brendshme dhe të jashtme.* | | | | |
| 1 | Ka plan të shkollës që institucionalizon marrëdhëniet e saj me autoritetet arsimore dhe pushtetin vendor në shërbim të cilësisë së shkollimit të nxënësve. | | | | |
| 2 | Bashkërendimit të punës me kopshtin dhe ciklin e lartë. | | | | |
| 3 | Bashkërendimit të punës me sektorët e kualifikimit/ këshillimit në DAR/ZA. | | | | |
| 4 | Bashkërendimit të punës me politikën arsimore të pushtetit vendor. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesit C.3.1 dhe C.3.2 dhe C.3.3** | | | | |
| C.4 | **Lidhjet me prindërit**<br>**Standardi:** *Shkolla mban lidhje funksionale me prindërit.* | | | | |
| 1 | Shkolla përfshin prindërit në veprimtaritë e saj. | | | | |
| 2 | Shkolla njeh kërkesat e prindërve për mësimin dhe i merr parasysh në punën që bën. | | | | |
| 3 | Shkolla i informon prindët për karakteristikat e saj. | | | | |
| 4 | Shkolla i informon prindët në mënyrë të rregullt lidhur me gjendjen e punëve në të. | | | | |
| 5 | Mësuesit mbështeten te mendimet e prindërve për punën e fëmijëve të tyre në shkollë dhe shtëpi. | | | | |
| 6 | Mësuesit i informojnë prindët në mënyrë të rregullt lidhur me rezultatet e fëmijve të tyre. | | | | |
| 7 | Mësuesit nxitin mbështetjen e prindërve në përgatitjen e fëmijve të tyre në shtëpi. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesit C.4.3, C.4.4 dhe C.4.6** | | | | |
| C.5 | **Përdorimi i burimeve**<br>**Standardi:** *Shkolla e përdor stafin dhe bazën materiale në mënyrën e duhur.* | | | | |
| 1 | Shkolla ka burimet e nevojshme njerëzore dhe materiale për drejtimin e saj. | | | | |
| 2 | Stafi është i ngarkuar me detyra specifike për procesin e mësimdhënies dhe të nxënit. | | | | |
| 3 | Stafi është i ngarkuar me detyra specifike sipas planit të punës së shkollës. | | | | |
| 4 | Shkolla përdor bazën materiale-mësimore në përputhje me kërkesat e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 treguesi C.5.1 dhe C.5.2** | | | | |
| C.6 | **Administrimi dhe procedurat e shkollës**<br>**Standardi:** *Shkolla ka një system funksional administrimi me procedura të përshtatshme shkollore.* | | | | |
| 1 | Plani i shkollës përshkruan politikën që ka ndjekur shkolla për cilësinë e shkollimit të ofruar. | | | | |
| 2 | Plani i shkollës ka evidentuar ato karakteristika të shkollës që janë të rëndësishme për prindët. | | | | |
| 3 | Shkolla ka një sistem të qartë të regjistrimit dhe të çregjistrimit të nxënësve. | | | | |
| 4 | Shkolla ka pasqyra të sakta të mungesave të nxënësve. | | | | |
| 5 | Shkolla ka procedura për zgjidhjen e ankesave. | | | | |
| Norma | Vlerësimi është **"Mirë" nëse janë vlerësuar me nivelin 3 të gjithë treguesit.** | | | | |

# PJESA 4

# PLANIT VJETOR I PUNËS SË SHKOLLËS

Plani i Shkollës rekomandohet të ketë dy seksione kryesore. Seksioni i parë ka të bëjë me zbatimin e programeve mësimore në shkollë. Seksioni i dytë përshkruan një sërë rregullash dhe praktikash të cilat kanë të bëjnë me aspektet administrative të jetës së shkollës.

Ndërsa në seksionin e tretë janë paraqitur disa sugjerime që duhen pasur parasysh për organizimin e përfshirjes së stafit dhe të interesuarve të tjerë në procesin e hartimit të planit të punës së shkollës.

## Seksioni 1

### FORMATI I PLANIT TË PUNËS SË SHKOLLËS

Plani i punës së shkollës rekomandohet të ketë këtë strukturë:

1. Gjendja bazë e shkollës;
2. Synimi i shkollës;
3. Objektivat e shkollës dhe veprimtaritë për realizimin e tyre;
4. Kualifikimi i stafit;
5. Plani i kontrollit të brendshëm të shkollës;
6. Aspektet administrative të jetës së shkollës;
7. Veprimtaritë e shkollës;
8. Vlerësimi i realizimit të planit vjetor të punës së shkollës.

Më poshtë janë paraqitur disa këshilla për secilin aspekt të planit të punës.

#### *1. Gjendja bazë e shkollës (jo më shumë se një faqe)*

Është e rëndësishme që secila shkollë të jetë e ndërgjegjshme për të gjithë faktorët që ndikojnë në punën e saj. Nga ana tjetër, këta faktorë do të influencojnë në mënyrën se si shkolla do të bëjë planifikimin e saj. Shumë faktorë janë të përbashkët për të gjitha shkollat. Të tillë janë p.sh. dokumentacioni i kurrikulës shtetërore, udhëzimet e ndryshme të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, instituteve të kurrikulës dhe të trajnimit, DAR, ZA, Kodi i Punës, kontrata kolektive etj. Megjithatë, kushtet dhe rrethanat lokale ndryshojnë nga shkolla në shkollë. Kjo është arsyeja përse konteksti specifik në të cilin vepron secila shkollë përbën një faktor të rëndësishëm në procesin e planifikimit. Kjo pjesë rekomandohet të hartohet në përputhje me kërkesat e formateve të inspektimit, duke dalluar mirë pikat e forta dhe të dobta të shkollës. Rekomandohet që në këtë pjesë të vendosen edhe problemet kryesore të identifikuara nga inspektimi i kryer në shkollë.

Disa faktorë të kontekstit të vlefshëm për shumicën e shkollave mund të jenë:

- Mosha dhe dallimet në aftësi të nxënësve, përfshi edhe nxënësit me nevoja speciale;
- Origjina sociale dhe ekonomike e nxënësve;
- Arritjet e nxënësve, trofetë e shkollës;
- Vendndodhja e shkollës;

- Gjendja fizike e shkollës;
- Cilësia e mjedisit shkollor;
- Kushtet e ndërtesës shkollore;
- Niveli i mirëmbajtjes së godinës shkollore;
- Pajisjet e përgjithshme që zotëron shkolla;
- Nivelet e stafit drejtues, stafit mësimor;
- Vlefshmëria e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare;
- Trajnimet, interesat, qëndrimet dhe specializimet e mësuesve.
- Mbështetja e bordit drejtues, këshillat e prindërve, qeveria e nxënësve;
- Vlefshmëria e mbështetjes së prindërve dhe e të tjerëve;
- Dëshirat dhe aspiratat mësimore të prindërve;
- Shkollat vartëse;
- Faktorët e transportit;
- Bashkëpunimi me pushtetin vendor.

### *2. Synimi i shkollës (Jo më shumë se një fjali)*

Secila shkollë është unike. Ajo ka nxënësit dhe mësuesit e saj, grupin e saj të prindërve, bordin e saj drejtues, trashëgiminë e saj, kontekstin dhe mjedisin e saj specifik. Si e tillë, ajo ka synimin e saj për një cilësi sa më të lartë. Pra, synimi, si një një formulim i përgjithshëm, udhëheq objektivat e shkollës për një vit shkollor. Si rregull, synimi buron nga dokumentat e MASh, të ballafaquara me problemin themelor që duhe të zgjidh shkolla gjatë këtij viti shkollor. P.sh. nëse MASh, në Udhëzimin e saj të fillimit të vitit shkollor, nënvizon shqetësimin për zbatimin e kurrikulës së re, atëhere sigurisht që kjo porosi do të shndërrohet në një përparësi vjetore të shkollës.

Synimi është i dukshëm në plan. Por, ai afishohet edhe në vende të ndryshme të shkollës.

Më poshtë janë paraqitur disa rekomandime për formulimin e synimit të shkollës:

- Nxitja për rezultate të larta dhe për barazi shkollimi të të gjithë nxënësve, duke përfshirë edhe ata që kanë dizavantazhe ekonomike, shoqërore, fizike apo mendore;
- Zhvillimi i dijeve, aftësive dhe shprehive, i shpirtit të kërkimit dhe i aftësisë për të analizuar çështjet në mënyrë kritike dhe konstruktive;
- Nxitja e shpirtit krijues, të inisiativës dhe të imagjinatës të nxënësve;
- Edukimi i nxënësve për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit dhe aftësimi i tyre për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore;
- Edukimi i nxënësve si antarë tolerantë, të kujdesshëm dhe të ndërgjegjshëm të shoqërisë;
- Edukimi i brezit të ri të Shqipërisë me ndjenjën e dashurisë dhe respektit për trashëgiminë lokale, kombëtare dhe botërore.

### *3. Objektivat e shkollës dhe veprimtaritë për realizimin e tyre*

Secila shkolle duhet të vendos objektivat e veta sipas problemeve që janë identifikuar kryesisht në fusha të tilla, si: mësimdhënia/të nxënit, rezultatet e nxënësve, kujdesi për nxënësit. Kjo për arsyen se këto fusha janë objekt vlerësimi nga inspektimi i jashtëm, si shumë të rëndësishme për prindërit, nxënësit dhe janë në përputhje me prioritetet e MASH. Duhet pasur parasysh se objektivat i shërbejnë realizimit të synimit të shkollës. **Natyrisht, shkollat, në përputhje me kushtet e tyre mund dhe duhet të vendosin objektiva edhe për punën edukative.** Po kështu, në konsultim me autoritetet lokale, mund të vendosin objektiva edhe për fusha të tjera.

***Rekomandohet që shkolla të vetvlerësojë të gjitha fushat e cilësisë së shkollimit që ofron brenda tre viteve shkollore. Një gjë e tillë krijon kushtet që numri i përgjithshëm i objektivave të një viti shkollor të mos jetë më shumë se 2-3. Shkollat e mëdha mund të kenë më shumë.***

Parimet kryesore që duhen pasur parasysh gjatë vendosjes së objektivave janë:

- Objektivat duhet të jenë të tilla që të vlejnë për të gjithë komunitetin e shkollës;
- Objektivat duhet të jenë të kufizuara në numër dhe të fokusuara në prioritetet kryesore të shkollës;
- Objektivat duhet të jenë reale, të realizueshëm dhe të matshëm, në përputhje me arritjet e momentit të shkollës dhe, kur është e përshtatshme, në përputhje me arritjet e shkollave të krahasueshme;
- Objektivat duhet të vendosen, vlerësohen dhe raportohen nga shkollat para stafit, nxënësve, prindërve, autoriteteve arsimore dhe pushtetit vendor;
- Objektivat duhet të vendosen në përputhje me afatet në planin e punës. Për të zbutur efektet e ndryshimeve vjetore, objektivat duhet të mbështeten në mesataren e arritjetjeve të 3 viteve të fundit dhe duhet të monitorohen mbi të njëjtën bazë. Ky parim përputhet edhe me kërkesat e inspektimit për vkerësimin e rezultateve të nxënësve.

Shkollat duhet të vendosin objektiva në fushat prioritare të tilla, si: leximi, gjuha shqipe, matematika etj. në përputhje me numrin e nxënësve që plotësojnë apo tejkalojnë nivelet e rezultateve për klasa/cikle. Pra, për vendosjen e objektivave në këto fusha kërkohet që shkollat të mbledhin të dhëna plotësuese për rezultatet e nxënësve në testimet e kryera nga vetë shkolla, autoritetet arsimore apo nga provimet e lirimit/pjekurisë.

Më poshtë janë paraqitur dy modele objektivash:

1) Nëse nëpërmjet testimeve-sondazheve, është vërejtur se nxënësit e klasës së katërt (CF) kanë shpejtësi leximi të ulët dhe përqindje të lartë të fjalëve të lexuara gabim, atëhere një objektiv mund të ishte: "*Në fund të vitit shkollor, nxënësi i klasës së katërt të lexojë të paktën 80 fjalë në minutë dhe të gabojë jo më shumë se në 8% të fjalëve*". Gjetja e rrugëve për realizimin e këtij objektivi kërkon një analizë të gjithanshme që kërkon të zbulojë shkaqet e kësaj gjendje.
2) Nëse një shkollë e mesme ka një numër shumë të madh mungesash, atëherë një objektiv i planit të saj të punës mund të ishte: "*Gjatë këtij viti shkollor do të zvogëlojmë numrin e mungesave të nxënësve në mësim me 15 mungesa për nxënës* ".

Çdo objektiv duhet të shoqërohet me veprimtaritë për realizimin e tij, të cilat vendosen në një tabelë.

Për plotësimin e tabelës për secilin objektiv duhet punuar me kujdes duke përfshirë antarët e stafit mësimor, atij ndihmës dhe aktorëve të tjerë. Nëse plani i një shkolle ka për objektiv rritjen 10-20% të numrit të nxënësve që vazhdojnë shkollën e lartë, atëherë analiza për vendosjen e objektivit duhet të trajtojë përbërjen e popullatës shkollore, nivelin profesional të mësuesve, metodat e mësimdhënies dhe të nxënit, punën pa nivel të mësuesve etj. Nëse nga analizat rezulton se hallka më e dobët janë mësuesit, atëhere duhet të planifikohet si do të përmirësohen ata profesionalisht nëpërmjet veprimtarive kualifikuese brenda dhe jashtë shkollës, qëmtimi në literaturën profesionale etj.

Pra, për **secilin objektiv** hartohet tabela e mëposhtme:

| **Objektivi 1:** | | |
|---|---|---|
| **1. Veprimtaritë për arritjen e objektivit** | **Personi përgjegjës** | **Afati** |
| a. | | |
| b. | | |
| c. | | |
| d. | | |
| | | |
| **2. Mundësitë dhe burimet njerëzore, materiale, financiare etj. që do të përdoren** | | |
| a. | | |
| b. | | |
| c. | | |
| | | |
| **3. Vështirësitë/pengesat që ndeshen** | | |
| a. Vështirësitë/pengesat për arritjen e objektivit janë: | | |
| b. Ne mund t'i kapërcejmë këto pengesa nëpërmjet: | | |
| **4. Vlerësimi i realizimit të objektivit:** *Ky vlerësim kryhet në fund të vitit shkollor dhe shërben si material bazë për raportin e analizës vjetore.* | | |

Gjatë plotësimit të tabelës duhet pasur parasysh:

1) Nëse, p.sh. një shkollë ka përzgjedhur për objektiv "Të ulet numri i mungesave me 15 mungesa për nxënës në krahasim me vitin e kaluar", atëherë në kollonën e veprimtarive duhen parashikuar disa veprimtari të tilla, si: verifikim i përditshëm i paraqitjes së nxënësve në mësim; kontakte të menjëhershme me prindërit, raportim i përjavshëm i mësuesve kujdestarë për nxënësit që mungojnë, mbledhje javore/dyjavore/mujore e drejtorisë për të analizuar situatën e braktisjes së shkollës, mbledhje tremujore e këshillit pedagogjik përsëri për të analizuar gjendjen dhe vlerësuar punën e kryer, etj.
2) Në tabelat e secilit objektiv përfshihen edhe analizat e ndryshme të drejtorisë dhe të këshillit të mësuesve që analizojnë faza të ndryshme të procesit të realizimit të objektivave. Ato duhet të jenë të formuluara qartë në tabelë.
3) Po kështu, në tabelat e secilit objektiv duhet të pasqyrohen edhe orët e kontrollit të brendshëm që do të ushtrohen për të monitoruar ecuninë e procesit të realizimit të tij. Edhe këto orë duhe të jenë të dalluara qartë në tabelë.

### *1. Kualifikimi i stafit*

Në këtë pjesë duhet të përfshihen inisiativa dhe veprime që duhet të ndërmerren për zhvillimin profesional të stafit. Ato duhet të plotësojnë nevojat profesionale të mësuesve në shërbim të realizimit të planit të punës së shkollës dhe të rritjes individuale profesionale. Si të tilla, ato identifikohen nëpërmjet pyetsorëve, veprimtarive, diskutimeve të ndryshme që organizohen me mësuesit. Më poshtë janë paraqitur disa rekomandime për kualifikimin e stafit:
- Hartimi i një programi të brendshëm kualifikues;
- Organizimi i ditëve shkollore me bazë kurrikule;
- Sjellja e lektorëve të njohur në shkollë për të folur me mësuesit;
- Veprimtari ku mësuesit raportojnë/prezantojnë individualisht para të gjithë stafit lidhur me sukseset apo aspektet më të suksesshme të punës së tyre;
- Ngritja dhe pasurimi i bibliotekës pedagogjike.

### *2. Plani i kontrollit të brendshëm të shkollës*

Drejtoria e shkollës duhet të ndërtojë një plan të qartë të kontrollit të brendshëm, bazuar në një tabllo të plotë të testimeve dhe detyrave me shkrim të parashikuar në planet mësimore të lëndëve të ndryshme. Këtu duhet të dallohet qartë pjesa e normës së kontrollit të planifikuar për monitorimin e realizimit të objektivave, pjesa e planifikuar për testime dhe pjesa tjetër për aspekte të ndryshme të jetës së shkollës. Pra, krahas analizave për realizimin e objektivave, drejtoria e shkollës organizon edhe analiza që burojnë nga procesi i monitorimit të brendshëm.

## Seksioni 2

### *3. Aspektet administrative të jetës së shkollës*

Ky është seksioni i planit të shkollës që prek aspekte dhe rutinën e administrimit të jetës së përditshme të shkollës. Si i tillë, ai duhet hartuar me kujdesin më të madh duke siguruar konsultimin dhe konsensusin midis të gjithë të interesuarve për zbatimin e planit të punës. Natyrisht, edhe për këto aspekte planifikohen kontrolle dhe analiza, të cilat duhet të dallohen qartë në formatin e plani të punës së shkollës. **Për lehtësi pune, rekomandohet që të gjitha analizat e parashikuara në pjesë të ndryshme të këtij plani të përmblidhen në një tabelë.**

Në këtë pjesë të planit të shkollës mund të trajtohen këto çështje:

- Ndarja e detyrave në stafin drejtues të shkollës;
- Procedura të regjistrimit të nxënësve në shkollë;
- Rregullorja e sjelljes dhe i disiplines;
- Masa për nxënësit me nevoja speciale;
- Masa për barazinë e mundësive midis djemve dhe vajzave;
- Mbajtja dhe shpërndarja e informacionit për progresin e nxënësve;
- Grafiku i takimeve me stafin;
- Përfshirja e punonjësit social/mjekut/dentistit në jetën e shkollës;
- Lidhjet dhe bashkëpunimi shkollë – familje;
- Procedura të sigurisë brenda shkollës;
- Masa të ndërgjegjësimit dhe të kujdesit për mjedisin;

- Përdorimi i bibliotekës së shkollës;
- Roli dhe përdorimi i teknologjisë së informimit dhe të komunikimit;
- Procesverbale të gjendjes së bazës materiale dhe të mirëmbajtjes së saj.

### *4. Veprimtaritë e shkollës*

Nuk mund të pretendohet që të gjitha veprimtaritë e shkollës të inkuadrohen në një objektiv të caktuar, prandaj është mirë që në planin vjetor të jetë një rubrikë e veçantë nën titullin e mësipërm. Në këtë pjesë të planit grumbullohen veprimtaritë ekstrakurrikulare që organizon shkolla gjatë gjithë vitit shkollor.

### *5. Vlerësimi i realizimit të planit vjetor të punës së shkollës*

Vlerësimi jep konkluzionet përfundimtare vjetore dhe realizohet në analizat e planifikuara dhe në analizën e fundit të vitit shkollor. Në të përshkruhen se sa janë arritur objektivat e planit vjetor. Më pas, analizohet gjendja e shkollës sipas nivelit të karakteristikave të vlerësuara të cilësisë me anë të treguesve përkatës.

Për këtë pjesë të planit të punës duhet pasur parasysh fakti që vlerësimi i punës për arritjen e objektivave të planit të shkollës përbën një pjesë integrale të procesit të planifikimit. Ky vlerësim analizon shkallën e realizimit të objektivave të vendosur. Ai merr parasysh përvojën e atyre që kryejnë detyra për arritjen e këtyre objektivave.

Kur pranohet se disa objektiva janë arritur, atëhere është mirë të identifikohen prioritete të tjera me anë të analizave të tjera duke siguruar kështu një dimension ciklik të procesit.

Kur objektivat nuk janë realizuar plotësisht, kryhet procesi i identifikimit të vështirësive dhe të pengesave, gjë që është shumë e rëndësishme për zbatimin e mëtejshëm të planit të shkollës.

Kur objektivat nuk janë plotësuar, hapi tjetër i planifikimit synon gjenerimin e objektivave apo të strategjive të përmirësuara.

Duhet pasur mirë parasysh që stadi i vlerësimit kërkon elemente të fortë të besimit reciprok dhe të të qenit i hapur midis të gjithë partnerëve.

## Seksioni 3

### Këshilla praktike për organizimin e procesit të hartimit të planit të punës së shkollës

#### 1) Partnerët në planifikim

- Bordi i shkollës;
- Drejtoria e shkollës bashkë me mësuesët inicojnë, hartojnë dhe formulojnë Planin e Shkollës;
- Prindërit;
- Të gjithë partnerët e tjerë.

#### 2) Hapat fillestare

- Megjithëse shkollat ndryshojnë nga njera tjetra në shumë aspekte të rëndësishëm, procesi i hartimit të Planit të Shkollës ka disa tipare të cilat janë të përbashkëta për të gjitha shkollat. Strategjitë dhe detyrat e planifikimit për hartimin e Planit te Shkollës, në përgjithësi, do të ndjekin të njëjtën rrugë në të gjitha shkollat, ndonëse afatet dhe

formalitetet do të varen nga madhësia dhe kushtet e shkollës. Ky proces përfundon jo më vonë se java e tretë e muajit shtator.

**3) Strategjitë për fillimin e procesit**

Lëvizjet e para që mund të ndërmerren për hartimin e Planit të Shkollës janë:

- Ndahet stafi në grupe pune që do të punojnë për aspekte të veçanta të Planit;
- Përfshirja e drejtorisë në kryerjen e detyrave për segmente specifike të Planit;
- Inkurajimi i mësuesve me aftësi të spikatura për kryerjen e detyrave specifike sipas fushave ku ata janë të spikatur;
- Inkurajimi i mësuesve të një cikli p.sh. që të planifikojnë punën e tyre si një hap fillestar drejt koordinimit të punës së gjithë shkollës;
- Përfshirja e mësuesve në studime për fusha që afektojnë jetën e përditëshme të shkollës dhe në prezantimin e tyre në shkollë;
- Organizimi i takimeve të veçanta të stafit për të diskutuar çështjet e Planit;
- Përdorim i pyetësorëve të hartuar specifikisht për kurrikulën për të identifikuar problemet që egzistojnë;
- Përdorimi i grupeve të gjëra të punës me përfshirjen e stafit, bordit drejtues dhe përfaqësuesve të prindërve për të hartuar aspekte të Planit të Shkollës.

## Bibliografia

1. Government of Ireland (1999)
   *School Planning: Developing a School Plan Guidelines for Primary Schools.*
2. MacDonald, D. Pearsom, M. University of Strathclyde, Glasgoë (1999)
   *Draft Report of Meeting Held in Tirana*
3. MASH & ISP (2003)
   *Draft: Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar në Shqipëri (2003-2013).*
4. Memushi, L. (2003)
   *Reformimi i Shkollës, Proces dhe Strategji.*
5. Musaj Bardhi (1999)
   *Psikologjia e edukimit*
6. OECD (2001)
   *Education at a glance.*
7. Open Society Institute (Hungary) & The World Bamk Group (1998)
   *Improving Education Systems.*
8. Pasku, V. Revisa Pedagogjike Nr. 1, 2003
   *Zhvillimet bashkëkohore në fushën e inspektoriatitarsimor dhe ristrukturimi i inspektimit shqiptar.*
9. SICI NewsLetter, Number 25, April / May 2003
   *ESSE Project.*
10. Standards in Scotland's Schools etc.
    *Act 2000.*
11. Stringfield. S. (1995)
    *Attempting to enhance pupils' learning through innovative programs.*
12. Shoqata Ndëkombëtare Hapa pas hapi (2002)
    *Standardet për mësuesit dhe Programin Hap pas Hapi.*
13. The General Inspectorate of Education. Portugal (2003)
    *The Integral Evaluation of Schools.*
14. The Jenisson Public Schools (1997)
    *School Improvement Plan.*
15. The Scottish Office (2000). Përkthim.
    *Hoë good is our school?: Self-evaluation using performance indicators.*
16. The Scottish Office (1998)
    *Managing Change in Small Primary Schools.*

17. The Scottish Qualification for Headship (1997)
*The Standard for Headship in Scotland.*

18. The Scottish for Reaserch in Education (1998-9)
*The Evaluation of Higher Still: Cohort Studies.*

19. The World Bank (2000)
*Project Appraisal Document on a Proposed Credit to the Republic of Albania for an Education Reform Project.*

20. Thomas J. Sergiovanni, Martin Burlingame, Fred S. Coombs, Paul W. Thurston (2000)
*Educational Governance and Administration.*

21. University of Strathclyde, Glasgoë. (2000)
*Draft Report of Meeting Held in Tirana.*

22. Van Bruggen C. J. (2000)
*SICI Report: Inspection of Schools as an Engine for Sustainable Change.*

23. Van Bruggen C. J. (2003)
*Some Diaries of Inspectors of Education from Various Countries.*

24. Vermunt. J. & Verloop. N. (1995)
*Congruence and friction betëeen learning and teaching.*

25. Werf. M van der (1995)
*The educational policy in the Netherlands: content, implementation and outcomes.*

26. William G. Cunningham, Paula A. Cordeiro (2000)
*Educational Administration - a problem-based approach.*

27. Zgara, P. International Conference “Ways Toëards Quality in Education”, Slovenia (2000)
*Educational Policy and Quality in Education.*

28. Zimmerman. B.J. (1990)
*Self regulated learning and academic achievement. Educational Psychologist 25.*

Save the Children

Republika e Shqipërisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

# Manual
# Inspektimi i plotë i shkollës

Bashkëpunim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe organizatës "Save the Children", Programi për Shqipërinë.

Përgatitur në kuadrin e projektit "Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin bazë 9-vjeçar"

*Autorë*
**Vladimir PASKU**, Ministria e Arsimit dhe Shkencës
**Mira PESHKATARI**, Drejtoria Arsimore e qytetit Tiranë
**Shemsi MUÇA**, Ministria e Arsimit dhe Shkencës

*Udhëhoqi grupin:*
**Refik ÇELA**, "Save the Children", Programi për Shqipërinë.

*Redaktoi materialin:*
**Tatjana CENKO**

**Ky libër nuk mund të shitet ose të përdoret për qëllime përfitimi.**

**Tiranë, 2005**